



**KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**

**REVISTË SHKENCORE  
PERIODIKE**

**Nr. 6**

**Dhjetor 2018**



Redaksia e Revistës Shkencore Periodike “Wisdom”, me ISSN 2410-8472, botim i Kolegjit Universitar “Wisdom”, në mbledhjen e datës 06.04.2017, pasi diskutoj dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga redaktore shkencore e revistës, Dr. Edit Bregu, vendosi të miratoi për botim në Nr. 6 të Revistës, artikujt e mëposhtëm:

**1. GJENDJA POLITIKE E BALLKANIT PAS KONGRESIT TË BERLINIT** (Dr. Edit Bregu, Autore).

Mbyllet me numrin rendor 15.

**2. METODOLOGJIA E STUDIMIT DHE TEORITË MBI INSTITUCIONET POLITIKE TË SHQIPËRISË** (Dr. Elmaz Sherifi, Autor).

Mbyllet me numrin rendor 29.

**3. BASHKËPUNIMI PROFESIONAL “PSIKOLOG SHKOLLOR - MËSUES” NË FUNKSION TË NXËNIES EFEKTIVE** (Prof. Asoc. Dr. Pëllumb Karameta, Autor).

Mbyllet me numrin rendor 50.

**4. PËRGJIMI SIPAS LEGJISLACIONIT AKTUAL SHQIPTAR EFEKTIVE** (Prof. Asoc. Dr. Naim Meçalla, Autor).

Mbyllet me numrin rendor 61.

**5. KOMPETENCA JURIDIKSIONALE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE** (Msc. Flutura Shabani, Autore).

Mbyllet me numrin rendor 73.

**6. PROGRAMI I GJUHËS ANGLEZE NË FOKUSIN  
E INTERESIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETET  
PUBLIKE** (Dr. Valbona Softa, Autore).

Mbyllet me numrin rendor 82.

**7. PSE SHQIPTARËT SHPËTUAN HEBRENJT**  
(Dokt. Meri Kraja, Autore, Msc. Flavia Kolleshi Autore).

Mbyllet me numrin rendor 93.

**8. IMPAKTI I KONKURENCËS MBI  
PROJEKTIMIN ORGANIZATIV**

(Dr. Ludmilla Shkurti, Autore).

Mbyllet me numrin rendor 82.

**9. QEVERISJA VENDORE NË PËRQASJE ME  
STANDARDET EVROPIANE** (Dr. Arjana Llano,  
Autore, Dr. Stela Meçaj Autore).

Mbyllet me numrin rendor 127.

**10. KOSTOT DHE PËRFITIMET E SHQIPËRISË  
ME ANËTARËSIMIN NË NATO** (Phd.Cand. Gerta  
Gjeta, Autore).

Mbyllet me numrin rendor 147.

**11. BURIMËSITË ETIKE TË TË MENDUARIT  
PSIKOLOGJIK** (Dr. Jetmira Fekolli, Autore, Ma. Diana  
Fekolli Autore).

Mbyllet me numrin rendor 156.

**Kryeredaktori**

Prof. Asoc. Dr. Naim MËÇALLA



# KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”

Rruga “Medar Shtylla”, (Komuna e Parisit), Tiranë,  
www.wisdom.al. tel: 042200063; cel: 0676022736

Kolegji Universitar “Wisdom”, ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” është krijuar nga shoqëria “Wisdom” sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006. Ndërsa me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të Ministrit të MASH është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të Ministrit të MAS është bërë Akreditimi Institucional i saj.

Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017 vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” u kthye në Kolegj Universitar, me emërtimin **KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**, miratuar me Urdhër Nr.145, date 31.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga dy njësi kryesore. Njësitë përbërëse të Kolegjit Universitar “Wisdom” janë strukturuar sipas nenit 22, të Ligjit Nr.80/2015, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me njësitë bazë. Struktura akademike e Kolegjit Universitar “Wisdom”, është:

- a) Senati Akademik
- b) Rektori
- c) Rektorati
- d) Këshilli i Etikës
- e) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- f) Komisioni për garantimin e standartëve të cilësisë
- g) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën

- h) Komisioni për marëdhëniet me studentët, publikun dhe kordinimin.
3. Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë,
- a) Departamenti i të Drejtës Publike
  - b) Departamenti i të Drejtës Private
  - c) Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.
4. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, me tre njësi bazë,
- a. Departamenti i Ekonomisë
  - b. Departamenti i Psikologjisë
  - c. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.

Kolegji Universitar "Wisdom" ofron programe të akredituara konform legjislacionit në fuqi si dhe standarteve të përcaktuara nga institucionet e sigurimit dhe garantimit të cilësisë së arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Gjatë vitit akademik 2016-2017, ky institucion, i`u nënshtrua procesit të akreditimit institucional nga agjencia britanike "Quality Assurance Agency" në bashkëpunim me Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, proces ky i cili u finalizua me akreditimin me sukses, Vendimi i BA Nr.103 Dt. 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Wisdom".

Kjo IAL, synon të shndërrohet në një qendër për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve juridike, shoqërore dhe ekonomike, si dhe njëqendër ekselence për kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar.

Vlen të theksohet se Shoqëria "Wisdom" sh.p.k. ka më shumë se 17 vjet që operon në fushën e mësimdhënies dhe në atë të aftësimin profesional nëpërmjet organizimit të kurseve të gjuhëve të huaja. Në këtë kuadër, Qendra e Kurseve të Gjuhëve "Wisdom", zotëron të drejtën dhe organizon rregullisht provimin ndërkombëtar të TOEFL. Që prej vitit 2016 është e licencuar për dhënie e provimit ndërkombëtar të TOEFL-it BT (Internet Based) në Shqipëri.

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>Gjendja politike e Ballkanit pas Kongresit të Berlinit.</b> <i>Dr. Edit Bregu</i> .....	9
<b>Çështja e Shkodrës në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe në synimet e shteteve fqinje.</b> <i>Dr. Elmaz Sherifi</i> .....	27
<b>Bashkëpunimi profesional “Psikolog shkollor - Mësues” në funksion të nxënies efektive.</b> <i>Prof. Asoc. Dr. Pëllumb Karameta</i> .....	49
<b>Përgjimi sipas legjislacionit aktual shqiptar.</b> <i>Prof. Asoc. Dr. Naim Meçalla</i> .....	71
<b>Kompetenca juridiksionale në të drejtën ndërkombëtare private.</b> <i>M.Sc. Flutura Shabani</i> .....	87
<b>Programi i gjuhës angleze në fokusin e interesit të studentëve në universitetet publike.</b> <i>Dr. Valbona Softa</i> .....	105
<b>Pse shqiptarët shpëtuan hebrenjtë?</b> <i>Dokt. Meri Kraja</i> <i>M.Sc. Flavia Kolleshi</i> .....	117
<b>Impakti i konkurrencës mbi projektimin organizativ.</b> <i>Dr. Ludmilla Shkurti</i> .....	133

**Qeverisja vendore në përjasje me standardet Evropiane.**

*Dr. Arjana Llano*

*Dr. Stela Meçaj* ..... 155

**Kostot dhe përfitimet e Shqipërisë me anëtarësimin në NATO.**

*PhD. Cand. Gerta Gjeta* ..... 167

**Burimësitë etike të të menduarit psikologjik.**

*Dr. Jetmira Fekolli*

*MA. Diana Fekolli* ..... 193





***Dr. Edit BREGU***


*Zv. Dekane Fakulteti i Drejtësisë, Pedagoge*

*Kryetare NjSBC*

*Kolegji Universitar “Wisdom”*

*e-mail: edit.bregu@wisdom.edu.al*

*edit\_kane@yahoo.com*



## **GJENDJA POLITIKE E BALLKANIT PAS KONGRESIT TË BERLINIT**

## **Abstrakt**

Koncepti i nacionalizmit, i cili gjeti zanafillën në Francë dhe vendet gjermane, në fillim të Shek. XIX filloi të përhapej edhe në Ballkan. Ndikimi fillestar ishte kryesisht i natyrës kulturore. Intelektualët ballkanas bënë përpjekje të mëdha për të standardizuar dhe popullarizuar traditat e popujve të Ballkanit shpesh herë edhe duke rikujtuar deri në mitizim të shkuarën, me shtetet që kishin ekzistuar në Ballkan para pushtimit Osman. Kësisoj, shumë shpejt theksi i nacionalizmit u bë politik. Një dëshirë e madhe për të arritur bashkimin nacional i motivoi shtetet e pavarur të Ballkanit për t'u përballur me pushtuesit e tyre të dikurshëm, osmanët. Udhëheqësit e Ballkanit supozonin se, vetëm mbas arritjes së unitetit kombëtar shtetet e tyre mund të shkonin drejt zhvillimit dhe prosperitetit. Në këtë aspekt popujt e Ballkanit u përpoqën të ndiqnin shembullin e suksesit politik dhe ekonomik të Evropës Perëndimore, veçanërisht Gjermanisë, duke përshtatur konceptin perëndimor të nacionalizmit si model për zhvillimin e tyre kombëtar.

***Fjalë kyçe:** Nacionalizëm, kongres, ballkan, traktati, osmanët, Bismark etj..*

## **Abstract**

The concept of nationalism, which its origin was in France and Germany, at the beginning of the twentieth century, began to spread even in the Balkans. The initial impact was mainly of cultural nature. Balkan intellectuals made great efforts to standardize and popularize the traditions of the Balkan peoples often by recalling to the myth of the past, with the states that existed in the Balkans before the Ottoman conquest. Thus, very soon the emphasis of nationalism became political. A great desire to achieve national unity motivated the independent Balkan states to confront their former invaders, the Ottomans. Balkan leaders assumed

that only after reaching national unity their states could go towards development and prosperity. In this aspect, Balkan peoples tried to follow the example of Western political and economic success, especially the example of Germany, in adapting the Western concept of nationalism as a model for their national development.

**Key words:** *Nationalism, congress, Balkans, treaty, Ottomans, Bismarck etc,*

Popujt e Ballkanit e perceptonin nacionalizmin si një justifikim për krijimin e njësisve të veçanta gjeopolitike. Kështu, Vasil Levski, një aktivist revolucionar bullgar i Shek. XIX, thoshte: *“Ne jemi një popull që duam të jetojmë në liri të plotë në trojet tona, aty ku jetojnë bullgarët, në Bullgari, Trakë e Maqedoni”*.<sup>1)</sup> Koncepti mbi nacionalizmin e Evropës Perendimore e zhvendosi sistemin e vjetër osman të “miletit” në Ballkan, i cili faktikisht i kishte lejuar çdo grupi të madh fetar autonomi në menaxhimin e administratës. Sistemi i “miletit” i lejonte myslimanët, ortodoksët, katolikët dhe çifutët të bashkëjetonin pa futur hundët në punët e njeri-tjetrit, gjë që u dha popujve të Ballkanit një shkallë të kufizuar autonomie kulturore. Për rrjedhojë serbët, më 1803 dhe grekët më 1821, nisën revoltën kundër sundimtarëve të tyre osmanë, pjesërisht të shtyrë nga karakteri euro-perëndimor i nacionalizmit. Për rrjedhojë, në vitin 1830 një shtet i pavarur grek u shfaq dhe, në të njëjtën kohë, lindi edhe një shtet autonom serb. Otomanët e kishin pranuar autonominë e Malit të Zi që prej shekullit të tetëmbëdhjetë, megjithatë, kjo ishte më shumë një përgjigje

1 Konstantin Pandev, Z. Noneva, ed. “Borbite vo Makedonia i Odrinsko 1878-1912 Spomeni”, (Betejat në Maqedoni dhe Andrinopojë 1878-1912), *Kujtime*, (Sofia: 1981), 5. Cituar në Richard. C. Hall, *The Balcan Wars 1912-1913, Prelude to the First World War*, (London: Routledge, 2000), 2.

ndaj armiqësisë dhe largësisë të Malit të Zi sesa një nxitje e dukshme nacionaliste. Sukseset e italianëve më 1861 dhe gjermanëve në vitin 1871, në arritjen e bashkimit kombëtar, frymëzuan më tej popujt e Ballkanit. Ndërkohë uniteti ushtarak i gjermanëve dhe italianëve shërbeu si një shembull për t’u ndjekur prej ballkanasve. Duhet thënë se çdo popull i Ballkanit imagjinonte rikthimin e perandorive mesjetare, ku ata i bazonin idetë e tyre me përmbajtje kombëtare. Bullgarët kërkuan kufijtë e perandorisë së parë ose të dytë bullgare, grekët ringjalljen e Perandorisë Bizantine, kurse malazetët dhe serbët kërkonin të shtriheshin në territorin e perandorisë së Stefan Dushanit. Në vitin 1876, Serbia dhe Mali i Zi filluan luftën kundër Perandorisë Osmane për të krijuar shtete të mëdha kombëtare në Gadishullin Ballkanik perëndimor. Në të njëjtin vit një revoltë antiosmane shpërtheu në Bullgari. Një vit më pas Rusia ndërhyri në Ballkan si aleate e nacionalistëve bullgarë dhe pas nëntë muajsh luftime të vështira, rusët mbizotëruan. Sipas studiuesit të njohur Lord Kinross<sup>2)</sup>, i cili në veprën e tij “Ottoman Centuries” (Shekujt Osmanë), ndër të tjera ka shkruajtur ndër të tjerash edhe për Traktatin e Shën Stefanit<sup>3)</sup>: *“Më 3 Mars, 1878, një traktat bilateral u nënshkrua midis Rusisë dhe Turqisë në Shën Stefan. Në bazë të kushteve të tij të cilat nuk ju shpalosën qysh në fillim të Fuqive të Mëdha, rusët kishin planifikuar copëtimin virtual të Perandorisë*

---

2) John Patrick Douglas Balfour, Baron i 3-të Kinross ka qenë një historian dhe shkrimtar skocez. Është mjaft i njohur dhe i dashur për publikun sidomos për and biografinë e themeluesit të shtetit modern turk: Mustafa Kemal Atatürk por dhe shumë vepra dhe punime të tjera mbi historinë osmane.

3) Shën-Stefani,- vendbanim i vogël (fshat) mbi detin Marmara, në perëndim të Konstandinopojës (Stambollit), [https://en.wikipedia.org/wiki/Treaty\\_of\\_San\\_Stefano](https://en.wikipedia.org/wiki/Treaty_of_San_Stefano)

*Osmane në Evropë*"<sup>4</sup>). Po sipas Lordit Kinross ky Traktat, mbi çdo gjë tjetër: "...ai ishte një plan i konceptuar ekskluzivisht në interes të popullsisë sllave dhe kundër popullsisë të tjera, të krishtera apo myslimane..."<sup>5</sup>). Traktati i nënshkruar në Shën-Stefan, në mars të vitit 1878, i dha fund luftës ruso-turke, duke krijuar një shtet të madh, të pavarur bullgar i cili shtrihej nga Kanalet deri në Adriatik dhe nga Danubi në Egje, që mund të shërbente si një bazë e vërtetë për Rusinë në Ballkan. Sipas diplomatëve rusë "...përfitimet kryesore duhej ti akordoheshin fqinjët të saj sllav, Bullgarisë. Kjo do të thoshte për bullgarët të zgjeroheshin në një shkallë të tillë që do të sillte rivendosjen në fuqi të Perandorisë Bullgare të e Mesjetës"<sup>6</sup>). Traktati i Shën Stefanit përmbushi aspiratat maksimale territoriale të nacionalistëve bullgarë. Bullgaria e ripërfshinte pjesën më të madhe të territorit në Gadishullin Ballkanik lindor, midis lumit Danub dhe Detit Egje, gjithashtu, përfshinte Maqedoninë. Në këtë mënyrë, për herë të parë dhe të vetme në historinë moderne, një popull i Ballkanit i kishte arritur të gjitha qëllimet e tij kombëtare. Ndërkaq, ky Traktat i dha hapësirë, duke e zgjeruar Serbinë dhe Malin e Zi, "*sipërfaqja e këtij të fundit u trefishua dhe popullsia u dyfishua në kurriz të fqinjëve*"<sup>7</sup>). "*Bosnje-Hercegovina vazhdonte të mbetej nën Sulltanin por me disa institucione autonome, për Rumaninë u konfirmua pavarësia, por humbte Besarabinë dhe shkëmbim të disa territoreve në*

---

4 Lord Kinross, *The Ottoman Centuries, The rise and the fall of the Turkish Empire*, ( New York 10022: Perennial, An Imprint of Harper Collins Publishers, 2002), 524.

5 Po aty.

6 Po aty.

7 Po aty.

*avantazh të Ruisë*<sup>8)</sup>. Por, megjithë përfundimet e mësipërme, Traktati i Shën Stefanit u përball me një përgjigje negative nga vendet kryesore të Evropës të cilat, për dyqind vitet e fundit, kishin privilegjin e arbitrimit të çështjeve ndërkombëtare. Sipas Lord Kinross: "*Traktati i Shën Stefanit u pa në Europë dhe ndërmjet ballkanasve si një shkëlqje flagrante e parimeve themelore etnologjike, ashtu siç bëri edhe me pretendimet e drejta historike, dallimet fetare dhe ndjenjat kombëtare në rritje ndërmjet popujve të kombësive të ndryshme jo-sllave*"<sup>9)</sup>. Lord Beaconsfield<sup>10)</sup> (Lordi Bikonsfilld) ka thënë mbi këtë Traktat: *Sulltanati i Turqisë, u reduktua në një shtet me një varësi absolute nga Rusia... për këtë arsye ne kemi protestuar kundër një marrëveshjeje e cila praktikisht do të bëhet në komandën e Ruisë...dhe do të përfitojë edhe resurset që fuqitë evropiane i kishin vendosur nën administrimin e Portës së Lartë*"<sup>11)</sup>. Me këto fjalë ai nënkuptonte se Rusia duhet ti bënte me dije apo ti shpaloste pikat e këtij Traktati me Turqinë dhe ato ti nënshtroheshin edhe gjykimit të Fuqive të Mëdha Evropiane. Qeveria britanike, insistonte se ky Traktat duhet të ngrihej për diskutim. Kur Rusia e refuzoi këtë, Lordi Bikonsfilld kalon në veprime konkrete duke thirrur rezervat ushtarake dhe duke urdhëruar një force të trupave britanike në Indi, të vazhdonte kalimin përmes kanalit të Suezit në Maltë. Ky demonstrim force u shoqërua edhe me vënien në lëvizje dhe mbrojtjen e interesave të saj në Ballkan. "*Austro-*

8 Lord Kinross, *The Ottoman Centuries, The rise and the fall of the Turkish Empire*, ( New York 10022: Perennial, An Imprint of Harper Collins Publishers, 2002), 524.

9 Po aty, 524.

10 Lord Beaconsfield, fillimisht Earl i Beaconsfield, ishte një titull i krijuar në vitin 1876 për kryeministrin Benjamin Disraeli, ndër politikanët më të preferuar të mbretëreshës Viktoria, në Mbretërisë së Bashkuar.

11 Kinross, *Vep. përm.*, 525.

hungarezët, rumunët dhe grekët kërkuan që të mbahej një konferencë. Popullsia muslimane e rajonit të Ballkanit apeloj për drejtësi tek Mbretëresha Viktoria...Shqiptarët formuan një lidhje që "do të rezistonte deri në vdekje" për çdo cënim që do tu bëhej trojeve të tyre"<sup>12)</sup>. Në këtë atmosferë Cari detyrohet të ndryshojë qëndrim dhe në një marrëveshje të fshehtë, që u zbulua shumë shpejt ndërmjet qeverive ruse dhe britanike, ambasadori i tij në Londër modifikoi planin e tij original për "Bullgarinë e Madhe". Një dëshirë për të kufizuar ambiciet e Perandorisë Ruse në Ballkan dhe për të vendosur rregull në kushtet kaotike në Evropën Osmane, sidomos nga ana e Austro-Hungarisë dhe Britanisë së Madhe, bëri që Fuqitë e Mëdha të pranonin ofertën e Oto fon Bismarkut (Otto von Bismarck) për të organizuar një konferencë që do të zgjidhte çështjet e Ballkanit. Bismarku premtoi se kjo do të shërbente me një "...ndërmjetësi të ndershme, që me të vërtetë dëshironte të bënte biznes".<sup>13)</sup> Rusët pranuan pa dëshirë, pasi e dinin se nëse do të refuzonin pjesëmarrjen në këtë kongres, situatë do të agravonte drejt një krize më të rëndë dhe ndoshta edhe drejt luftës. Në këtë moment Britania i kërkon Sulltanit ta lejonte të qeveriste Qipron, me justifikimin e mbrojtjes së Anadollit lindor në rast të ndonjë sulmi të mundshëm rus. "Britanikët kërcënojnë me tërheqje nga Kongresi në qoftë se, sulltani nuk do të pranonte këtë kërkesë të tyre. Në këtë mënyrë, sulltani u detyrua të jepte këtë koncesion, në Traktatin e Qipros që u nënshkrua më 4 Qershor të vitit 1878...Nga ana e saj, Britania premtoi se do t'i jepte Devletit të gjithë ndihmën e e nevojshme për

---

12 Po aty.

13 TW. N. Medlicott, *The congress of Berlin and after* (London: 1938), 22. (Kongresi i Berlinit dhe situata pas vendimeve të tij), Cituar në Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913, Prelude to the First World War*, ( New York: Routledge, 2000), 2.

*mbrojtjen e Anadollit lindor, në rast sulmi nga Rusia*"<sup>14</sup>). Në vijim, Bismarku ftoi përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha të takoheshin në kryeqytetin gjerman. Kongresi i Berlinit, që u mbajt në muajin qershor të vitit 1878 nën drejtimin e vetë Bismarkut, më pas, u ndoq nga diplomatët kryesorë të kohës, duke përfshirë Lordin Salisbëri (Salisbury) të Britanisë së Madhe dhe Konti Andrasi (Andrassy) i Austro-Hungarisë. Konferenca anulloi disa prej vendimeve të Shën-Stefanit, duke çuar kështu në një zvogëlim të konsiderueshëm të përmasave territoriale dhe pavarësisë së shtetit të ri bullgar. Sipas Kongresit të Berlinit, Bullgaria u nda në dy pjesë. Në vend të një Bullgarie të madhe të pavarur, Kongresi i Berlinit krijoi një principatë autonome bullgare nën sovranitetin otoman, një Rumeli Lindore gjysëm autonome, nën autoritetin e Sulltanit dhe e riktheu Maqedoninë nën sundimin e drejtpërdrejtë të sulltanit. Sipas Lord Kinross, *"Për këto vendime rusët fillimisht kundërshtuan...por si përfundim u dorëzuan, si rezultat i këmbënguljeve të Lordit Bikosfilld dhe siç vërente Bismarku: "Ka sërish një Turqi në Europë"*<sup>15</sup>). Nga ana tjetër këto vendime ishin katastrofike për nacionalizmin bullgar. Për rrjedhojë, Kongresi arriti të balanconte ndikimet e Rusisë, duke i dhënë shumë kufizime territoriale në këmbim të premtimeve dhe kompesimeve të natyrës diplomatike. Ivan E. Geshov, i cili udhëhoqi Bullgarinë në Luftën e Parë Ballkanike në vitin 1912, shkroi: *"Kur ne në Plovdiv lexuam në Times në muajin ogurzi të korrikut të vitit 1878, të botuar tekstin e marrëveshjes, në të cilën diplomacia ditëshkurtër e Berlinit ndau atdheun tonë, mbetëm të shtangur. A ishte e mundur një padrejtësi e tillë? A mundej një padrejtësi t'u*

14 Stanford J. Shaw, and Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey, Vol.II. Reform, Revolution and Republic-The rise of the Modern Turkey 1808-1975*, (Cambridge: Cambridge University Press, 1977), 190.

15 Kinross, *Vep. për.*, 525.



*rikthehej*".<sup>16)</sup> Kongresi i Berlinit, gjithashtu, njohu pavarësinë e plotë të një Serbie pak më të vogël dhe privoi Malin e Zi nga përfitimet e sanksionuara në Shën Stefan kundrejt Hercegovinës, sanxhakut të Novi Pazarit dhe Shqipërisë së Veriut. Austro-Hungaria përparoi në Ballkanin perëndimor duke pushtuar Bosnje-Hercegovinën dhe sanxhakun e Novi Pazarit. Austro-Hungaria i vendosi garnizonet e veta ushtarake midis Serbisë dhe hapësirës së Malit të Zi, që i mundësonte daljen në detin Adriatik. Këto territore mbetën "de juro" pjesë e Perandorisë Osmane. Ndërkohë, Maqedonia i`u hoq Bullgarisë, që i`a kishte dhënë Traktati i Shën-Stefanit, dhe i`u rikthye Perandorisë Osmane. Këto, gjithashtu mbetën aspiratat kombëtare të Malit të Zi dhe Serbisë. Sipas studiuesit Eugene Rogan: "*Në bazë të kushteve të Traktatit të Berlinit, Perandoria Osmane humbi rreth 2/5 e territorit dhe 1/5 e popullsisë në Ballkan dhe Anadollin Lindor*"<sup>17)</sup>. Pra është një humbje shumë e konsiderueshme. Më tej E. Rogan vazhdon: "*Këto humbje të thella e bindën Sulltan Abdyl Hamitin e II-të që të qveriste me dorë të fortë Perandorinë në mënyrë që ta mbronte atë nga çdo pretendim që mund të vinte nga ndonjëra prej Fuqive të Mëdha europiane*"<sup>18)</sup>. Ndërkaq, pretendimet e vazhdueshme greke çuan drejt një ndërhyrjeje në vendimet e Berlinit. Në vitin 1881, Fuqitë e Mëdha sanksionuan aneksimin grek të Thesalisë dhe një pjesë të Epirit Jugor. Bullgarët shumë shpejt e morën veten nga shoku i humbjeve të tyre. Geshov i shkruante një miku: "*Bullgaria nuk është vetëm e cunuar, por me thikë në zemër. Operacioni, ose më mirë të them kjo seri e operacioneve mbi Bullgarinë shkaktoi dhimbje të tmerrshme që do të na dëmtojë për një kohë të*

16 Ivan Evstratiev Geshov, *Spomeni iz godini na borbi i pobedi* (kujtimet e viteve të betejave dhe fitoreve), (Sofia: Gutenberg, 1916), 94.

17 Eugene Rogan, *The Fall of the Ottomans: The Great War in the Middle East*, (New York: Basic Books Publisher, 2015), 4.

18 Rogan, *Vep. për.*, 4.

*gjatë, por nuk do të jetë fatale për ne*”.<sup>19)</sup> Lord Salisbëri (Salisbury), avokati britanik i Rosisë dhe i Bullgarisë së vogël, thoshte se një Bullgari e madhe ishte thjesht çështje kohe. Bullgarët nuk ishin të vetmit që ndiheshin të frustruar nga vendimet e Berlinit. Grekët, malazezët, dhe serbët, po ashtu, e perceptonin Traktatin e Berlinit si një pengesë për aspiratat e tyre kombëtare. Pas vitit 1878 të gjitha shtetet e Ballkanit u përpoqën për të kapërcyer vendimet e Berlinit dhe të ecnin drejt bashkimit kombëtar. Disa studiues, kryesisht bullgarë etj., kanë pohuar se, lufta Ruso - Turke e vitit 1877-1878 çoi në kurorëzimin dhe nënshkrimin e Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit, vendime që, sipas tyre *“i`u përgjigjën realisht interesave të popujve të Ballkanit”*<sup>20)</sup>. Dihet se, në Shën-Stefan, turqit u detyruan të nënshkruajnë një traktat që i jepte Rosisë, kryesisht nëpërmjet krijimit të një shteti të ri të madh bullgar, pozita mbizotëruese strategjike në Ballkan. Megjithatë, mund të thuhet se Rusia nuk mbeti plotësisht e kënaqur sepse nuk i realizoi dot plotësisht synimet fillestare të saj, sepse, pas njohjes së pavarësisë Bullgaria zgjodhi një princ gjerman për ti shpëtuar influencës ruse. Plani rus për një shtet ruso-bullgar dështoi, por Rusia vazhdoi punën e saj pa ndërprerje dhe me aq durim sa fitoi edhe adhurimin e armiqve të saj. Me tërë këto, ajo hasi në vështirësi të mëdha. Bullgaria, pasi doli e lirë dhe u njoh nga Evropa, duke dashur që të jetë e pavarur zgjodhi në krye një princ nga Gjermania. *“Shpëtimi i saj kombëtar u përpunua nga Stambolovi”*<sup>21)</sup>, njeriu më i shquar që ka nxjerrë

19 Ivan Evstratiev Geshov, *Lichna korespondentsiya, no. 7 letter of 30 June 1878 o.s. to Hristo N.Puliev*, ed. Radoslav Popov, Vasilka Tankova, ( Sofia: 1994), 29.

20 *Revue Internationale d’Histoire Militaire*, Nr. 74, Edition Bulgare, L’Institut D’ Histoire Militaire, (Sofia: 1992), 10.

21 Stefan Nikolov Stambolov (në gjuhën bullgare: Стефан Николов Стамболов) (12 shkurt 1854 - 18 korrik 1895) ishte një politikan bullgar, i cili shërbeu si kryeministër dhe regjent. Ai është konsideruar si një nga njerëzit më të rëndësishëm dhe popullor. I njohur edhe si “Themeluesi i Bullgarisë Moderne”, disa i referohen edhe si “Bismarcku bullgar”. [https://en.wikipedia.org/wiki/Stefan\\_Stambolov](https://en.wikipedia.org/wiki/Stefan_Stambolov).

*Bullgaria*". Ai u mundua jo vetëm për të shpëtuar nga *influenca ruse, por dhe për të ngritur një Bullgari të Madhe, siç qe parashikuar në Traktatin e Shën Stefanit*<sup>22)</sup>. Në këtë Traktat, i cili u nënshkrua nga dy perandoritë, ruse dhe turke, pas luftës së zhvilluar ndërmjet tyre, ku Rusia kishte dalë fitimtare, u ra dakort për lindjen e Bullgarisë. Asaj i'u dhanë territore të gjera që shtriheshin nga Danubi në Trakë (me përjashtim të Adrianopojës) dhe Maqedoni, deri në Ohër, me një dalje në detin Egje, midis lumit Marica dhe Selanikut, i cili mbetej osman. Rusia po realizonte kështu një kontroll të tërthortë, të paprecedent, mbi të gjithë hapësirën ballkanike dhe ky fakt shkaktoi një reagim të fortë politik të Britanisë së Madhe, nga njëra anë, e interesuar për rrugët detare dhe barazpeshën midis fuqive, si dhe të Austro Hungarisë, nga ana tjetër, që kërkoi si shkëmbim, të drejtën për të pushtuar Bosnje-Hercegovinën. Sipas disa studuesve bullgarë, fillimi i luftës, që mund të pritej eventualisht me ndarjen që u bë në Shën-Stefan, nuk u shkonte për shtat interesave të qarqeve drejtuese të Evropës Perëndimore, që i trembeshin forcimit të pozicionit të Rusisë në Gadishullin Ballkanik dhe forcimit të ndikimit të saj në Lindjen e Afërme. Për këto arsye ato rishikuan Traktatin e Shën Stefanit dhe përvijuan vendimet e Kongresit të Berlinit, duke konfiguar hartën e Gadishullit Ballkanik në kundërshtim me interesat e popujve të Ballkanit. Në marrëdhëniet midis këtyre shteteve ato krijuan atmosferën e një tensioni artificial dhe armiqësie pothuajse të përjetshme. Përveç të tjerave, në vitet '70 të Shek. XIX u dëshmuar edhe një zhvillim tjetër shumë i rrezikshëm në qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj këtij rajoni. Franca, Britania dhe Rusia vepronin në pajtim me njëra tjetrën në politikën e tyre kundrejt Greqisë në vitet 30-të, për të mbrojtur interesat e tyre strategjike. Kjo, në fakt, do të bëhej e dukshme në

---

22 Edit Durham, *Brenga e Ballkanasve*, (Tiranë: Argeta-LMG, 2000), 73.

vendimet që erdhën si rezultat i ndikimeve të tyre në Kongresin e Berlinit. Me hyrjen e verës së vitit 1878, Gjermania kishte filluar të prishte ekuilibrin e Evropës. Prodhimi industrial i saj po rritej me shpejtësi, duke arritur nivelet e ekonomive të fuqive të tjera evropiane. Simboli më i dukshëm dhe epiqendra e këtij përparimi ishte padiskutim Berlini i cili, pak vite më parë, kishte qenë një qytet i rëndomtë, ndërsa tani kishte arritur popullsi që mund të kalonte të njëmilionët dhe zotëronte hekurudha të cilat, në atë kohë, ishin çelësi i suksesit në shkëmbimet ekonomike. Vendimi për të thirrur Kongresin pikërisht në Berlin nuk ishte i rastësishëm, por pasqyronte fuqinë ekonomike dhe ushtarake gjermane të kohës. Madje, vetë Bismarku e quante Gjermaninë edhe si “ndërmjetësin e paanshëm”. Sipas tij, Gjermania mund të kishte asnjësi në “çështjet ballkanike”, duke shërbyer si arbitër për palët pjesëmarrëse. Gjatë punimeve të Kongresit, i cili zgjati një muaj, nga 13 Qershori deri në 13 Korrik, Kancelari Bismark u bë ndërmjetës midis palëve dhe organizoi në kryeqytetin gjerman, më saktë në rezidencën zyrtare të Bismarkut, në Pallatin Radziëll, kongresin e fuqive, që ishin Britania e Madhe, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria, Perandoria Osmane, Franca dhe Italia, me motivin për të rishikuar Traktatin e Shën Stefanit. Në Kongres u ftuan të merrnin pjesë gjithashtu, por pa një rol zyrtar, delegacioni rumun, ai serb, malazet dhe grek. Me shkathtësinë diplomatike të Fuqive të Mëdha, në Berlin iu vunë “prita” ekspansionizmit fanatik rus dhe u përvijua një rregullim i ri për Evropën Juglindore, por pa ndëshkuar në mënyrë të tepruar Perandorinë Osmane, një rregullim ky që do të zgjaste deri në vitin 1912. U njoh si shtet i pavarur Rumania, me dalje detare në Dobrukhën Veriore, por duke i hequr Besarabinë Jugore. Sipas studiuesit Lord

Kinross: "Në Berlin ashtiu si dhe në Shën-Stefan, viktima kryesore ishte Rumania, e cila doli nga Kongresi si viktima e fundit e padrejtësisë ruse"<sup>23)</sup>. U njohën gjithashtu Serbia, e cila siguroi marrjen e Nishit, Pirotit dhe Vranjës, si dhe Mali i Zi, që përfitoi dalje në Adriatik, në Tivar. Këto shtete i shtoheshin Greqisë, që kishte shpallur pavarësinë që në vitin 1830. Për pasojë, Bullgaria e Madhe e Shën Stefanit tani u nda, siç shkruan M.Gleni (M.Glenny), në tri pjesë: "Mbretëria e Bullgarisë (tokat midis Danubit e Stara Planinës dhe rrethin e Sofjes), Rumelinë Lindore (Bullgarinë Jugore), që ishte rreth autonom në kufijtë e Perandorisë Osmane, Maqedonia dhe Traka e Adrianopojës mbetën provinca të Perandorisë Osmane".<sup>24)</sup> Ndërkaq, Rusia mori Besarabinë Jugore, në deltën e Danubit, më parë pjesë e principatës rumune të Moldavisë. Sipas Bullgarëve, pjesa me e madhe e popullsisë së Maqedonisë dhe Trakës së Adrianopojës ishte Bullgare. Ky ishte në fakt thelbi apo pjesa themelore e të gjithë grindjeve dhe kontradiktave me vendet fqinjë. Dhe, si paradoks ballkanik, të njëjtat pretendime shfaqën dhe grekët, serbët etj. Kështu, sipas presidentit të Komitetit Helenik të Historisë ushtarake Greke, gjeneralarmate Joanis Bitos (Joanes Bitos), "Thesaloniki (Selaniku) nuk simbolizon vetëm çlirimin e Maqedonisë më 1912 nga thundra shekullore turke, por përfshin gjithashtu gjithë luftën e kombit helenik, kryesisht në shekullin aktual për Maqedoninë".<sup>25)</sup> Të tëra këto pretendime, do të bëheshin shkak për konflikte dhe pretendime shpesh herë dhe

23 Kinross, *Vep. për m.*, 526.

24 Glenny, *Vep. për m.*, 134.

25 *Revue Internationale d'Historie Militaire*, Nr. 74, Edition Bulgare, L'Institut d'Histore Militaires (Sofia:1992). E cituar në, *La Premiere Guerre Balkanique a traverse les pages d'illustration*, (Thesalonique:1992), 5.

arbitrare dhe të paqëna, midis popujve ballkanas. Është kjo arsyeja që, më pas këto çështje, janë bërë edhe objekt përplasjesh midis studiuesve të këtyre vendeve, të cilët shpалosin argumentet e tyre, ndonjëherë edhe duke speculuar rëndë në kurriz të historisë me anën e këtyre argumenteve. *"Kongresi i Berlinit pasi shmangu një luftë të madhe nëpërmjet diplomacisë, u brohorit nga Lordi Bikonsfilld si "Paqja me nder" ... Tani e tutje, vërtetë mund të jetë rritur shkalla e ndikimit rus në Ballkan, por në fund të fundit nuk u vendosën rregullat e diplomacisë ruse. Ajo çfarë erdhi në rritje të vazhdueshme ishte më tepër fuqia e nacionalizmit ballkanik sesa fuqia e imperializmit rus"*<sup>26)</sup>. Gjithsesi, Kongresi i Berlinit, i thirrur nga Fuqitë e Mëdha, më tepër plotësoi interesat e këtyre të fundit, duke kufizuar ndikimin rus, sesa u kujdes për të zgjidhur çështjet e diskutueshme për kombet dhe etnitë e Ballkanit. Psh në lidhje me pasojat që pati ky Kongres për trojet shqiptare italianit Paolo Muner shprehet: *"Asgjë nuk u vendos në favor të kombit shqiptar; asgjë në kuptimin e mirë, sepse teksa vendosi në favor të "kundërshtarëve", i dëmtoi atij lindjen e unitetit kombëtar, duke futur brenda kufijve të "tjerë", territore të gjera të banuara në pjesën më të madhe prej popullsisive me etni shqiptare"*<sup>27)</sup>. Pra, e parë në rrjedhën e ngjarjeve në të vërtetë, diplomatët europianë, kishin mbjellë mes ballkanasve frymën e konfliktit, që do ti ndiqte nga pas si fantazëm deri në kohët moderne. *"Fuqitë e mbledhura në Berlin, jo vetëm që lanë nën sundimin osman një pjesë të mirë të popujve të Ballkanit, por një pjesë tjetër,-atë të Bosnjës dhe Hercegovinës,-ia kaluan Austro Hungarisë, duke e bërë kështu monarkinë e Habsburgëve një faktor me peshë në Gadishull"*.<sup>28)</sup> Kështu do të shkruante studiuesi i

26 Kinross, *Vep. përm.*, 526.

27 Paolo Muner, *Shpresa e Shqypëriis*, ( Durrës: Jozef, 2015), 149.

28 Glenny, *Vep. përm.*, 367.

njohur i çështjeve të Ballkanit, historiani Xhorxh Kastellan (Georges Castellan) në librin e tij kushtuar historisë së Ballkanit. Për rrjedhojë, Austro-Hungaria, si rezultat i manipulimit të interesave të Fuqive të Mëdha, arriti një fitore të shkëlqyer, ajo kishte fituar të drejtën për të pushtuar Bosnje-Hercegovinën, edhe pse nuk kishte marrë pjesë vetë ushtarakisht në krizën e viteve 1875-1878! Kështu, krahina kishte mbetur vetëm formalisht provincë osmane, sepse Austro-Hungari, veç kësaj, dërgoi atje forca ushtarake, një garnizon në sanxhakun e Novi Pazarit, që ishte një degëzim osman i futur midis Malit të Zi dhe Serbisë. E parë në plan strategjik, Sanxhaku kishte rëndësi të veçantë në sistemin e komunikacionit osman, sepse atje kalonin rrugët që, nga Sarajeva, të çonin në Maqedoni dhe më tej në Selanik, një rrip ky që i jepte Bosnjës myslimane përshtypjen se nuk qe braktisur ende nga Stambolli. Me këtë veprim, ambicja serbe për të marrë një dalje detare në portin malazez të Tivarit (Barit, siç e quajnë malazezët) ishte shuar. Por jo vetëm kaq, depërtimi Austro-Hungarez në Ballkan nuk do të ishte i vetmi dhe i fundit. Do të ishte pikërisht Vjena ajo që do të nxiste Serbinë që të drejtohej dhe të kthente sytë nga Maqedonia. Historianët e njohur Francezë, E. Lavis dhe A. Rambo do të shkruanin kështu lidhur me këto ndodhi dhe përfundonin se: *“Rrallë ndeshen në histori situata kaq të çuditshme dhe kaq të padrejta. Ekuilibri në Ballkan u prish”*.<sup>29)</sup> Austria tani dukej më pranë Detit Mesdhe dhe Carigradit (Kostandnopoljës), se sa Rusia. Populli serb, duke shpresuar në ringritjen e tërësisë kombëtare, kundër dëshirës së tij dhe vullnetit të shprehur qartë, në Korrik të vitit 1876 e gjeti veten të ndarë në tri pjesë. Ndërkohë, Austria mundahej me çdo kusht të vendoste çdo lloj

29 Glenny, *Vep. përm.*, 256.

lidhjeje me të. Po kështu, kundër dëshirës së popullit të vet, edhe Bullgaria u nda në tri pjesë. Duke e lënë Maqedoninë nën pushtetin e Sulltanit, e shtyrë nga Anglia dhe Austria, Evropa kishte bërë një krim kundër popullsisë së kësaj treve dhe vetë rajonit! Në fakt, qysh në Shën-Stefan, Rusia ishte kujdesur për sigurimin e të drejtave të barabarta për të gjithë kristianët; në Berlin nuk i'u kushtua vëmendje as të vertetës, as vullnetit të popujve, as konkluzioneve të arësyes së shëndoshë dhe as interesave të përbashkëta. Sipas përfundimeve të studiuesve bullgarë, akti përfundimtar, "*... s' ishte gjë tjetër, veçse monument i egoizmit, lakmive, urrëjtjes personale, pandershmëri dhe poshtërsi, sepse, në vend që të sillte paqen me garancitë e shpresuara, ai krijoi pretekste të panumurta për konflikte dhe luftëra të mëtejshme*".<sup>30)</sup> Dhe në të vërtetë rrjedha e ngjarjeve vërtetuan vërtetësinë e kësaj teze, shumë shpejt rajoni do të përfshihej nga dallgët e dy luftërave rajonale dhe do ta turbullonte edhe më tepër gjendjen e gadishullit të Ballkanit.

---

30 Cituar sipas, *Revue Internationale d' Histoire Militaire*, Nr. 74, Edition Bulgare, L'Institut D' Histoire Militaire, (Sofia:1992), 12.



## BIBLIOGRAFIA

- Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999*. Tiranë: Toena dhe IDK, 2007. *Revue Internationale d' Histoire Militaire*, Nr. 74, Edition Bulgare, L'Institut D'Histoire Militaire, (Sofia:1992).
- Paolo Muner, *Shpresa e Shqypëriis*. Durrës: Jozef, 2015.
- Lord Kinross, *The Ottoman Centuries, The rise and the fall of the Turkish Empire*. New York 10022: Perennial, An Imprint of Harper Collins Publishers, 2002.
- Edit Durham, *Brenga e Ballkanasve*, (Tiranë: Argeta-LMG, 2000).
- Eugene Rogan, *The Fall of the Ottomans: The Great War in the Middle East*, (New York: Basic Books Publisher, 2015).
- Ivan Evstratiev Geshov, *Lichna korespondentsiya, no. 7 letter of 30 June 1878 o.s. to Hristo N.Puliev*, ed. Radoslav Popov, Vasilka Tankova, ( Sofia: 1994).
- Stanford J. Shaw, and Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey, Vol.II. Reform, Revolution and Republic-The rise of the Modern Turkey 1808-1975*, (Cambridge: Cambridge University Press, 1977).
- Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913, Prelude to the First World War*, (New York: Routledge, 2000).
- Konstantin Pandev, Z. Noneva, ed. "Borbite vo Makedonia i Odrinsko 1878-1912 Spomeni", (Betejat në Maqedoni dhe Andrinopojë 1878-1912), Kujtime, (Sofia: 1981).






**Dr. Elmaz SHERIFI**

*Përgjegjës i Departamentit E drejtë Private, Pedagog*

*Fakulteti i Drejtësisë*

*Kolegji Universitar "Wisdom"*

e-mail: [elmaz.sherifi@wisdom.edu.al](mailto:elmaz.sherifi@wisdom.edu.al)



**ÇËSHJTA E SHKODRËS  
NË KONFERENCËN E  
AMBASADORËVE NË LONDËR  
DHE NË SYNIMET E SHTETEVE  
FQINJE**

## **Abstrakt**

Studimi i institucioneve politike të Shqipërisë, nuk mund të bëhet pa përdorur metodologji bashkëkohore studimi, pa njohur traditën historike institucionale të kohës, dhe as pa njohur interesat që kishin perandoritë lakmitare për Shqipërinë. Sepse perandoritë shpesh e penguan elitën politike shqiptare t'i shfaqte aftësitë shtetformuese për të themeluar institucionet e shtetit, duke u bazuar në filozofinë e shtetit të së drejtës. Një ndër kundërshtarët kryesorë për shpalljen e mëvetësisë dhe krijimin e institucioneve politike, ishte edhe Perandoria Osmane. Ajo, edhe kur po jepte shpirt, nuk e njohu Aktin e Pavarësisë dhe qeverinë e përkohshme të Vlorës dhe në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës më 17 dhjetor 1912, ashtu si Rusia e Franca, u bë pengesë për përcaktimin e statusit të Shqipërisë. Kur Perandoria Osmane pushoi së ekzistuar, rivaliteti dhe lakmia politike e fuqive europiane dhe i vendeve fqinjëu bë motivi shtytës për ta coptuar Shqipërinë. Rivalitetin e stimulonte gjeopolitika dhe lakmia për të kontrolluar "Vijën Egnatia", detin Adriatik, detin Jon dhe pozicionin e favorshëm gjeopolitikë të Shqipërisë. Sllavët e kanë patur synim strategjik dhe ëndërr shekullore zotërimin e një porti në detin Adriatik ku ndërthureshin interesat e shteteve sllave të Ballkanit, të cilat Rusia i përdori si instrument politik dhe ushtarak, kundër Perandorisë Osmane dhe më vonë edhe kundër Shqipërisë. Kurse, politika e bashkëpunimit të Fuqive të Mëdha bëhej për të ruajtur balancat politike dhe ushtarake në Ballkan, prishja e të cilave mund të cënonte, siç i cënoi raportet politike e ushtarake, të cilat nuk mund të zgjidheshin më me mjete politike e diplomatike.

**Fjalë kyçe:** Institucionet politike, popull, Shqipëri, elitë, kushtetutë etj.

## **Abstract**

The study of the Albania's political institutions can not be done without using contemporary study methodology, without knowing the historical institutional tradition of the time, and without even knowing the interests of the greedy empires for the Albanian territories. Because empires often prevented the Albanian political elite from displaying state-building skills to establish state institutions, based on the rule of law philosophy. One of the main opponents for declaring independence and establishing political institutions was also the Ottoman Empire. She, even when she was breathing, did not recognize the Independence Act and the provisional government of Vlora and the Conference of Ambassadors of London on December 17, 1912, just as Russia and France became an obstacle to the determination of Albania's status. When the Ottoman Empire ceased to exist, the rivalry and political greed of the European and neighboring countries became the driving force for breaking Albania. Rivalry was stimulated by geopolitics and greed to control the "Egnatia line", the Adriatic Sea, the Ionian Sea and the favorable geopolitical position of Albania. The Slavs have had a strategic goal and a century-long dream of possessing a port on the Adriatic Sea where the interests of the Balkan Slavic States were intertwined, which Russia used as a political and military instrument against the Ottoman Empire and later against Albania. But the policy of co-operation between the Great Powers was to maintain the political and military balances in the Balkans, the destruction of which could affect, as it affected political and military relations, which could no longer be resolved by political and diplomatic means.

**Key words:** Political institutions, people, Albania, elite, constitution etc.

## Hyrje

Në vitet 1912-1920, rol të veçantë për krijimin e institucioneve të shtetit të ri, kanë patur, Perandoria Austro-Hungareze e Italia, por edhe SHBA e Britania. ***Duke u mbështetur në dokumente arkivore, del se bashkëpunimi dhe rivaliteti, midis Austro-Hungarisë, për dominimin politik të Shqipërisë, përmban fatin e ekzistencës, por edhe atë të shkatërrimit të institucioneve të Shqipërisë. Këto dy fuqi kishin synime politike të njëjta, për ta dominuar Shqipërinë, ndërsa mënyrat dhe mjetet për arritjen e qëllimit, i kishin të ndryshme.*** Austro-Hungaria e dëshironte një shtet shqiptar në Ballkan, pasi dëshironte që ta përdorte si balancë antisllave. Ndërsa Italia dëshironte një Shqipëri me institucione të dobëta, për ta dominuar më me lehtësi. Ky synim politik u vërtetua, kur Austro-Hungaria e braktisi principatën, sapo hyri në luftë me Serbinë më 1914 dhe Italia e pushtoi Vlorën e bashkëpunoi me Antantën, për ndarjen e Shqipërisë, sipas marrëveshjes së fshehtë të 26 prillit 1915.

Metoda e pasqyrimin të vërtetës pa u ndikuar nga interesa ideologjike, na mundëson të kuptojmë politikën diplomatike të Rosisë e cila i përdorte shtetet sllave të Ballkanit kundër Perandorisë Osmane dhe Shqipëria në projektet e saj shikohej gjithmonë si “pre” për t’iu aneksuar Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë. Këtë politikë e vërteton projekti i miratuar edhe nga Perandoria Osmane me Traktatin e Shën Stefanit më 5 mars 1878. Analiza realiste na “ndriçon” mendimin për të kuptuar edhe synimet e Austro-Hungarisë, e cila pasi mori Bosnjë-Hercegovinën, i shikonte trojet shqiptare si mundësinë e vetme për të ndikuar në Ballkan, me qëllim që Rusia të mos dilte në detin Adriatik.

Rusia dhe Austro-Hungaria ishin në rivalitet, por edhe aleat kur ua donin interesat politike e kryesisht interesat diplomatike. Vetëm në këto raste dilte në skenë edhe “çështja shqiptare”, dhe u nënëshkrua mes tyre njëakt diplomatik ndërkombëtar që pranontekrijimin e “*Shqipërisë autonome*”,

*krahas Bullgarisë e Rumelisë, por pa status dhe territor të caktuar.<sup>1)</sup>*

## **Metodologjia e studimit të**

### **Institucioneve politike e juridike.**

Studimi i institucioneve politike të Shqipërisë lidhet ngushtësisht me veprimtarinë e protagonistëve politik dhe njohjen qëkishte elita politike shqiptare për teorinë e shtetit të së drejtës. Elita politike shqiptare u organizua për mëvetësinë e Shqipërisë, kur e "sëmura e Bosforit" po jepte shpirt, dhe kur vendet ballkanike krijuan lidhjen politike e ushtarake kundër saj. Shqipëtarët nuk morën pjesë në Luftën e Parë Ballkanike dhe elita politike shqiptare, nuk i parapriu zhvillimit të situatave nëpërmjet një projekti politik e organizativ për themelimin e të gjitha institucioneve të shtetit shqiptar, i cili do të mbante "vulën" e protagonistëve real politik. Për rrjedhojë mund të bëjmë pyetjen: *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, ishte një rastësi e rrethanave të krijuara nga venitja graduale e të "sëmurës së Bosforit", që u mund papritur nga shtetet ballkanike, apo ishte finalizim i një programi të elitës politike, që me imagjinatën e vet, i parashikoi zhvillimet dhe gjeti momentin historik për ta shpallur Shqipërinë, më vete, të lirë dhe e mosvarme ?* Pyetja nuk ka aspak sens dyshues e mosbesues, por, shërben për t'u qasur te e vërteta historike institucionale, përmes fakteve historike arkivore dhe interpretimit të institucioneve të krijuara nga elita politike shqiptare, mbi kriteret shkencore të metodologjisë realiste.

*Studimi i institucioneve kërkonnjohjen e historisë politike e institucionale, duke u mbështetur në metodologji shkencore studimi.* Metodologjia e studimit duhet të respektoj parimin e historicizmit, dhe filozofinë politike të shtetit të së drejtës. Kjo

---

1 Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2003, f.13.

metodë u ka dhënë studiuesve kurajë për të mos u trembur nga e vërteta, dhe autoritet e dinjitet shkencor për interpretimin e proceseve politike e institucionale. Trajtimi i momenteve më kulmore të themelimit të institucioneve politike të Shqipërisë ka qasje edhe të karakterit kronologjik, dhe përshkrimi i veprimtarisë së personaliteteve që vendosën “gurin miljar” në historinë e institucioneve politike, është i formës narrative.

Studimi i institucioneve politike të Shqipërisë vërteton hipotezën, se kuvendet dhe kongreset kombëtare në Shqipëri kanë qenë legjitime, por, institucionet politike nuk janë krijuar mbi norma juridike kushtetuese. Në themelimin e tyre vepruan normat e së drejtës zakonore kushtetuese, nga operatorët historik me ndikim politik. Historia e institucioneve politike të Shqipërisë njihet përmes dokumenteve të shumta arkivore. Ajo duhet të shkruhet me objektivitet shkencor, sipas maksimës latine “*historia e magistra vitea*”/ historia është mësuesja e jetës, dhe duhet t’i referohet metodës së Lajbnicit “*le present est plaint du passé et charge de l’avenir*”/“*e tashmja është përplot me të kaluarën dhe e ngarkuar me të ardhmen*” [Gotfreid Vilhem Leibnic, 1646-1760].<sup>2)</sup> Sipas Lajbnicit, ngjarjet e shkuara na ofrojnë rregulla të dobishme për jetën dhe e shpjegojnë të tashmen me të shkuarën, për të parashikuar të ardhmen.

Hipoteza e studimit vërtetohet edhe përmes analizës së variableve historikë që mundësohen nga burimet arkivore dhe botimet e memoareve të autorëve serioz, si të brendshëm dhe të huaj, e sidomos, sipas *metodës historike krahasuese* të sociologëve dhe politologëve të mirënjohur, Max Weber, David Eatson, Norberto Bobbio, Nicola Matteucci dhe Gianfranco Pasquino, të cilët sistemin politik e shikojnë si tërësi institucionesh dhe procesesh politike, në një ndërvarësi reciproke. Metodologjia krahasuese është e legjitimuar, sepse, mëvetësia e Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe themelimi

2 H. Ismaili & F. Sejdia, *Historia e institucioneve...*, f. 19; Giakoumis Georgios, *Historia, e nesërmeja e një shkence të së djeshmes*, përkthyer nga Elvis Bramo e Marie Hysko Ed. Meyer, Tiranë: Emal, 2011, f. 17.



i institucioneve politike u realizuan në shek. XX. Në rastin e Shqipërisë metoda krahasueseshërben për të kuptuar shkaqet e vonesës së krijimit të shtetit të pavarur shqiptar dhe krijimin e institucioneve pa norma kushtetuese. Prapambetja institucionale, duhet të mos shikohet vetëm si politikë antishqiptare e faktorit ndërkombëtar, por edhe si paaftësi e elitës politike shqiptare. Tradita e keqe konstitucionale e institucionale u krijua si precedent në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 1912 dhe vazhdoi. Metodologjia realiste e studimit nxjerr në pah zik zaket, nga 1920 deri më dhjetor 1923 kur u zhvilluan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese e cila do miratonte kushtetutën e shtetit dhe formën e qeverisjes sipas vendimit të Kongresit të Lushnjës. Ardhja e Nolit në pushtet më qershor 1924 u dha fund kushtetutshmërisë dhe institucioneve të shtetit të së drejtës.

*Në studimin e institucioneve politike duhet përfshirë edhe metoda e Gabriel Almond dhe David Bingham Powell. Metoda e tyre na mundëson të arsyetojmë, përse qeveritë e krijuara prej dhjetorit 1912, e në vazhdimësi, nuk mund të pasqyronin interesa klasore, ashtu si është trajtuar në historinë politike të institucioneve të Shqipërisë, madje edhe në tekste akademike. Qeveritë e Shqipërisë fillimisht duhej të udhëhiqeshin nga interesat e mëdhaja kombëtare, për t'i themeluar institucionet e munguara të shtetit sapo formuar, me synim që Shqipëria të bëhej shtet, më parë se të merej me reforma, si është pretenduar. Trajtimi klasor i politikave, nuk ka qenë aspak realist. Kjo metodë na mundëson të kuptojmë, se Qeveria e Përkohshme e Vlorës, nuk mund të pretendonte pasqyrimin e interesave klasore, dhe qeveria e Ismail Qemalit nuk mund të pretendonte kryerjen e reformave me karakter social, sepse nuk kishte parlament dhe institucionet që do të impononin fuqinë e ligjitende nuk ishin formësuar. Shqipëria më parë duhej që të bëhej shtet me institucionet e shtetit të së drejtës, si premisa themelore për realizimin e reformave. Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve me sens dilematik, shkrimi i historisë së institucioneve politike kërkon objektivitet*

shkencor, pasi historiografia jonë për shkak të rrethanave historike dhe të sistemit politik të shtetit të diktaturës së proletariatit, ka qenë e ndikuar nga shkolla lindore e sidomos nga ajo e Serbisë e shek.XIX, ku konkurruan dy shkolla me metoda e qasje të ndryshme historiografike. Arkimandri Ilarijon Ruvarac me pasuesit e tij, ofronin metodë dhe qasje realiste, ndërsa, Pantelija Sreçkoviç dhe anëtarët e Shoqatës të "Serbëve të Mësuar", i mitizonin heronjtë jashtë të vërtetës historike.Realiteti shqiptar na mundëson të kuptojmë historiografia e frymëzuar nga studiuesi Ilarijon Ruvarac, u përdor për t'u shërbyer qarqeve akademike. Ndërsa qasja e Pantelija Sreçkoviçit, u përdor për edukimin e brezave të rinj. Akademikët, ndonëse i dinin shumë të vërteta, i deformonin faktet, për interesa politike. Provë e ekzistencës së dy metodave është elaborati "*Dëbimi i arnautëve*" i politikanit dhe historianit Vaso Çubrilloviç.<sup>3)</sup> Çubrilloviçi e pranonte, se pas Traktatit të Shën Stefanit, mbreti Millan Obrenoviç ua mori tokat shqiptarëve, ndërsa në tekstet shkollore, edhe sot, tokat e shqiptarëve vazhdojnë të konsiderohen tokat e serbëve! Metoda e dyzimit të fakteve ka ndikuar në shkrimin e historisë së institucioneve politike të Shqipërisë. Studiuesit e historisë së institucioneve i njohin faktet historike të organizimit të kuvendeve kombëtare dhe rolin e aktorëve politik në këtë proces institucional. Por, duke menduar se thënia e disa të vërtetave mund të dëmtojë imazhin e protagonistëve ose historinë tonë institucionale, rishkrimin e ngjarjeve e konsiderojnë të panevojshëm. Amerikani, Glen Tinder mendonte, se dija mbi mendimin politik e institucional, nuk të jep kënaqësinë e një konkluzioni përfundimtar, por, duke ngritur sa më shumë pyetje, nxitet mendimi për të shkruar atë pjesëz institucionale, që askush më parë nuk ka treguar interes shkencor.Prandaj Institucionet e krijuara prej 1912, deri më 1946, janë analizuar edhe në fokusin e koncepteve politike evolutive të Karl Popperit.Nga metoda e analizës së Karl Popperit *vetëçlirohesh nëpërmjet dijës*, për të

kuptuar sensin e historisë institucionale dhe dramën e fshehur të historisë së institucioneve të Shqipërisë. Prej këtej buron guximi shkencor për të shprehur, sipas meje, disa të vërteta jo ezauruese për institucionet politike të Shqipërisë, dhe të mos i mbulojmë sjelljet jointucionale të aktorëve politik, në emër të patriotizmit anakronik.

*Historicizmi pozitivist solli metodë të re studimi, nëpërmjet kërkimit të burimeve, kontrollit e vërtetimit të dokumentit, duke e ballafaquar me origjinalin. Historicizmi i dha shkencës së historisë autoritet, metodologji studimi e dinjitet shkencor. Në këtë periudhë filloi studimi i dukurive ekonomike e shoqërore dhe njohja e institucioneve politike.*

### **Teoritë politike për formimin e institucioneve politike.**

Interesi për studimin e institucioneve politike po rritet dhe po ridimensionohet kudo në botë. Ne shqiptarët e kemi akoma më të nevojshme studimin e historisë së institucioneve politike, pasi studime të shumta kanë qenë të ndikuara nga ideologjia politike e shtetit të Diktaturës së Proletariatit. Në teoritë politike institucionet politike konsiderohen autoritete të legjitimuara, të cilat duhet të garantojnë të drejtat dhe liritë themelore, liritë politike e sociale, të administrojnë pasuritë publike, të nxisin zhvillimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe të shpërndajnë e rishpërndajnë resurset e pamjaftueshme për pjesën e shoqërisë në nevojë, vetëm me akte ligjore e nënligjore. Për këtë arsye institucionet konsiderohen si **“arena e konfliktit”**, por edhe e bashkëpunimit për zgjidhjen institucionale të nevojave të shoqërisë. Në epokën e sotme globaliste, institucionet politike kombëtare dhe ato ndërkombëtare, janë në një vartësi e bashkëpunim reciprok. Prirja apo tendenca e sotme institucionale është rritja e peshës së institucioneve politike ndërkombëtare, mbi vendimmarrjet e institucioneve politike të shteteve anëtare, deri në kufijtë e “humbjes” së sovranitetit të institucioneve politike përfaqësuese.

Institucionet politike nuk mund të trajtohen shkencërisht pa njohur teoritë politike për to. Historia e institucioneve politike nuk mund të trajtohet as si një e vërtetë koleksionuese e fakteve të mbledhura. *Në këtë sens shteti duhet kuptuar si vazhdimësi e institucioneve të krijuara në breza, dhe historia politike, si historia e institucioneve politike të krijuara në vazhdimësinë historike, pavarësisht regjimeve politike që kanë ekzistuar.* Këtë teori e gjejmë që nga pionierët e historiografisë, Ionikët; Herodoti, Helanikos e Tukiditi. Helanikos ishte pararendësi i rrëfimit historik dhe shkruesi i monografisë historike. Herodoti është cilësuar si historiografi i parë që dha modelin studimor, se si mund të kalohet, nga gojëdhëna popullore, te shkrimi i ngjarjes reale. Ndërsa Tukiditi vlerësohet si “konsulli i historiografisë”, që me “artin e rrëfimit” të Luftës së Peloponezit, krijoi historinë politike dhe ushtarake. Ndërsa Sokrati, Platoni, Aristoteli trajtuan teorinë e së drejtës natyrore dhe format e qeverisjes.<sup>4)</sup>Më vonë historianët e filozofët romakë, Alimentus/Alimenti, Caesar/Çezari, Titus Livius/ Tit Livi, Plinius/Plini, Apianus/Apiani e Polybius/ Polibi, Ciceroni, Seneka, me shkrimet e tyre e “sollën të gjallë” historinë politike dhe institucionale të Perandorisë Romake dhe në Mesjetë juristi Italian Alcijat/Alciatius dhe francezët Kyzha, Dono e Boden përdorën metodën historike të studimit të së drejtës.<sup>5)</sup>Plini e Apiani kanë shkruar edhe për vendndodhjen e ilirëve, si një etnitet i dallueshëm nga popujt e tjerë të Ballkanit. Ndërsa greku Polibi, duke njohur mirë teorinë politike të Aristotelit, shkroi historinë politike të Romës të “fshehur” deri atëherë në malin e harresës. Në Bizant historia politike ishte e orientuar më shumë nga ngjarjet luftarake, se sa nga historia e institucioneve politike. Këtë e mësojmë nga trashëgimia historike e Prokopios, Ana Komnenas, Honiatis etj. Prokopios luftërat e perandorëve të dinastisë ilire Justiniane, i bëri në shumë vëllime, kurse

---

4 H. Ismaili & F. Sejdia, *Historia e institucioneve...*, f. 69, 78.

5 Liljana Ikononi, *Filozofia e së Drejtës*, Tiranë: Ekspres, 2006, f. 25, 29; H. Ismaili & F. Sejdia, *Historia e institucioneve...* f.15.

institucionet politike dhe të drejtën e perandorit ilir, Justiniani I e përshkroi shumë përciptas. Kjo sipas meje mund të jetë një nga tezat studimore, pasi përmban trashëgimi të vyer institucionale të një prej perandorëve më të famshëm ilir.

Pas shembjes së Perandorisë Romake nga dyndjet barbare në shek. V, konkretisht më 476, deri në shek. XIV, historiografia u zbeh dhe sundoi trajtimi teologjik me rrëfime për lindjen e botës. Në këtë periudhë historike perëndimi mesjetar me murgjit e ditur të manastireve dhe fisnikët e shkolluar, ishte në kontrast me kulturën e Perandorisë Bizantine, ku mbijetoi tradita e lashtësisë greke me arsimin gjithëpërfshirës. Pikërisht në vitet 1259-1268 shquhet Aquinas Shën Thomas/ Tomas Akuini, teologu e filozofi politik katolik, që ndodhej në oborrin e Papës në Itali. Ai la gjurmë në mendimin politik me "Tomizmin" e tij, dhe me komentet për politikën e Aristotelit, mbi sundimin e mbretërve/ *De Regimine principum*. *Edhe Tomas Akuini shtetin e konsideroi një institucion të natyrshëm, jo konvencional, dhe të nevojshëm për një shoqëri të përsosur, duke e përdorur si instrument për plotësimin e dëshirave të të qeverisurve dhe për sovranitetin e monarkisë, që sipas tij vinte nga Perëndia dhe realizohej nëpërmjet popullit të qeverisur.* Tomas Akuini besonte se shteti nuk është i varur nga kisha, por, dhe kisha nuk i nënshtrohej shtetit. Marrëdhëniet e kishës me shtetin i konsideronte si marrëdhëniet e trupit me shpirtin. Rolin e shpirtit, sipas tij, e kryente kisha, ndërsa, trupi simbolizonte ligjet e dekretet e shtetit, të cilat nëse ishin kundër ligjeve të natyrës e moralit shoqëror, duhej të shpallehin të pavlefshëm. Mund të formulojmë se koncepti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lindi në Angli, kur mbreti i Anglisë Johani Pa Tokë nënëshkroi më 1215, Magna Carta Libertatum/Karta e Madhe e Lirive, si afirmim i përfaqësimit të popullit në organin shtetëror, i cili fillimisht u emërtua "Magnum Concilium"/Këshilli i Madh dhe më 1265 u emërtua parlament. Më 1322 u formua Dhoma e Lordëve , më 1344 Dhoma e Komuneve më 1430 u përcaktua mënyra

e zgjedhjes së deputetëve.<sup>6)</sup> Mbreti Charles I/Karli I më 1625 e shpërndau parlamentin sepse e konsideronte pengesë në ushtrimin e autoritetit të tij. Më 1628 kur ishte në luftë me Francën, u detyrua ta thërrasë parlamentin në seancë dhe i ndodhur nën presionin parlamentar firmosi “Petition fo Rights”, aktin madhor të formuluar nga Lordi Edward Coke, që atëhere kryesonte Departamentin e Drejtësisë në Angli. Akti ndau kompetencat shtetërore, midis pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit legjislativ.<sup>7)</sup> Nga 1629 deri më 1640 Karli I, u mundua ta trajtojë parlamentin si një instrument personal që e mbledhte dhe shpërndante sipas humorit politik. Më 1640 e mbajti parlamentin vetëm tre javë dhe e shpërndau, prandaj edhe në historinë parlamentare konsiderohet “Parlamenti i shkurtër”. Më 13 prill 1640 Karli I bëri zgjedhje për parlamentin e ri që pati mandat trembëdhjet vjet, deri 1653 dhe u emërtua “Parlamenti i gjatë”. Në nëntor 1641 parlamenti miratoi “Grand Remonstrance” /Akuza e Madhe, që i dha kompetencë të kontrollonte veprimtarinë e zyrtarëve që emëronte mbreti. Karta e Madhe e Lirive dhe kompetencat e parlamentit me kërkesat e tij për mbretin inicuan luftën qytetare kundër mbretit më 22 gusht 1642, ndarjen e parlamentit, dhe marjen e drejtimit të ushtrisë së parlamentit nga Oliver Cromwellit më 1645, i cili formoi Gjykatën e Lartë me 135 vetë që dënoi me vdekje Karli I më 27 janar 1649 dhe eliminoi Dhomën e Lordëve, duke shpallur Republikën e Anglisë.<sup>8)</sup> Më korrik 1653 Kromuelli e shpërndau parlamentin dhe krijoi një parlament që i bindej atij, i cili miratoi kushtetutën e parë që ishte edhe kushtetuta e fundit e shkruar në Angli. *Akti juridik u emërtua “The Instrument of Government”/*

6 Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve*, Tiranë, 1998, f.249 250; Hilmi Ismail, Fatmir Sejdiu, *Historia e Institucioneve Juridike ...*, f.267.

7 Hilmi Ismail, Fatmir Sejdiu, *Historia e Institucioneve Juridike...*, f.272.

8 Norman Davies, “Europe a History, A panorama of Europe, east and west, from the ice age to the cold war, from theurals to Gibraltar”, New York, 1998, referuar nga Hilmi Ismail, Fatmir Sejdiu, *Historia e Institucioneve Juridike...*, f.276

*Instrumenti i qeverisjes, i cili sipas studiuesit francez André Maurois ishte një dokument që për nga idetë krahasohet me kushtetutën e SHBA.<sup>9)</sup>Sipas nenit 1, pushteti legjislativ mbahej te një person dhe te populli me përfaqësuesit e tij në parlament. Pushtetin ekzekutiv do e kryente Lordi Protektor, me këshillin/qeverinë me 13 deri 21 anëtarë. Për here të parë u promovua ideja e shoqërisë liberale sipas parimit të sovranitetit, kushtetutëshmërisë, ligjëshmërisë dhe i ndarjes së pushteteve. Më 26 maj 1679 parlamenti anglez miratoi aktin me fuqinë më të lartë kushtetuese në Angli i emërtuar “Habeas Corpus Amendament Act”, që legjitimoi pushtetin gjyqësor, si një nga pushtetet shtetëtorë, që mbron të drejtat e njeriut përmes dhënies së drejtësisë nga një gjykatë. Sipas “Habeas Corpus Amendament Act” pushteti ekzekutiv nuk mund ta mbante në burg një individ, më shumë se 24 orë, dhe ishte i detyruar që të ndaluarin ta dërgonte në gjykatë, vendimi së cilës ishte i detyruar për tu zbatuar. Në Angli ka lindur edhe termi / nocioni kushtetutë, nga Revolucioni i Lavdishëm më 1688, kur mbreti Jakob u shfronësua dhe u fajsua, se kishte shkelur Kushtetutën Themelore të Mbretërisë. Në 1689 u vendos sovraniteti i parlamentit përmes Glorius Revolution / Revolucioni i Lavdishëm, apo revolucioni paqësor. Parlamentit i dha fund sundimit të Monarkisë Absolute, duke krijuar Monarkinë Kushtetuese. Vilhem Oranzh që ishte sundimtari i Hollandës, mori drejtimin e Anglisë së bashku me bashkëshorten Mary / Meri, dhe hartoi “Deklaratën e të Drejtave”/Bill of Right.<sup>10)</sup> Deklarata e të Drejtave i dha fuqi parlamentit të abrogonte aktet e mbretit. Anglia është “filiza dhe modeli institucional” i ndarjes së pushteteve të shtetit, dhe vendi i ndarjes së pushtetit ekzekutiv, midis kryetarit të shtetit dhe kryeministrit. Kjo ndodhi më 1717, kur Anglia qeverisjej nga George I/Xhorxh I, trashëgimtar i familja princërore të Hanoverit të Gjermanisë, Ernest Augustus. Ndarja u realizua*

9 André Maurois, *Histori e Anglisë*, Shtëpia Botuese “Çabej” Tiranë, 1996, f. 47, përkthyer nga Pjetër Arbnori.

10 Hilmi Ismail, Fatmir Sejdiu, *Historia e Institucioneve Juridike...*, f.289.

sipas maksimës "*The king reigns but does not govern*", mbreti sundon por nuk qeveris. Pas këtij moment pushteti ekzekutiv drejtohej nga ministri i parë / kryeministri, dhe këtë funksion e kreu njëzetë e një vjet Lordi i parë i Thesarit Sër Robert Uollpol. Ndërsa, koncepti mbi sovranitetin si përfaqësim politik i popullit u formulua te Kontrata Sociale e Zhan Zhak Ruso, që fuqinë politike të përfaqësimit ia dha një asambleje kombëtare si bashkim i vullneteve individuale, të cilët me vullnetin e lirë ilenëdisatëdrejta, për t'i kaluar te një institucioni, që u garanton jetën dhe të drejtat.<sup>11)</sup>

*Nëpërmjet analizës së kushtetutshmërisë angleze, Montesquieu / Monteskie i dha historisë së institucioneve politike vlerë shkencore dhe shkollës historike të së drejtës orientimin praktik.* Montesquieu, formuloi tezën teorike, se *ligji në përgjithësi është arsyeja e njeriut, në qoftë se arsyeja i drejton të gjithë njerëzit e botës. Ndërsa ligjet politike dhe ligjet civile, duhet të jenë raste të aplikimit të arsyes.* Montesquieu/Monteskie mendonte se edhe institucionet politike angleze u krijuan nga fryma e lirisë gjermane që e ushtroi demokracinë e drejtpërdrejtë në pyje, dhe pasi emigruan në Angli, u ndikuan nga filozofia e Thomas Hobbes/ Tomas Hobs me veprën Leviathan / Leviantani për shkaqet e lindjes së shtetit dhe detyrimin e tij për të siguruar lirinë, sipas parimit "*t'u bësh të tjerëve atë ç'ka do të doje që të tjerët të të bëjnë ty*".<sup>12)</sup> Monteskie u ndikua edhe nga Traktati i Dytë për Qeverisjen / Second treatise on Government, të Xhon Lokut, nga mori parimin e përfaqësimit të popullit në sistemin monarkik, duke kombinuar, parimin e demokracisë direkte me atë të monarkisë kushtetuese aristokratike.<sup>13)</sup>

Ndikimi i filozofisë politike të Hobsit, Lokut dhe Montesquieu, mbërriti në kontinentin Amerikan, kur teoricieni Tomas Peini, i ardhur nga Anglia më 1774, botoi pamfletin

11 Zhan Zhak Ruso, *Kontrata sociale*, botim Luarasi University Press, Tiranë 2007, f.31.

12 Th. Hobbes, *Leviantani*, Tiranë: Dita 2000, f.106.

13 L. Ikonimi, *Filozofia e së Drejtës...*, f.36.



"*Mendimi Praktik*"/*Common sense*, në janar 1776, dhe kërkoi zëvendësimin e monarkisë së trashëgueshme me republikën. Te ky mendim filozofik u mbështet elita politike e SHBA, kur më 4 korrik 1776, Tomas Xhefersoni shpalli Deklaratën e Pavarësisë/Declaration of Independence të SHBA.<sup>14</sup>"Fryma e ligjeve" e Montesquieu, u shërbeu themeluesve të shoqërisë demokratike amerikane, që pas 16 javë diskutimesh nën drejtimin e Benjamin Franklin, më 17 shtator 1787, miratuan Kushtetutën e SHBA me institucione politike të ndara, të pavarura dhe të balancuara. Deklaratën e firmosën 39 nga 42 delegatë të pranishëm, pothuajse aq delegatë sa firmosën themelimin e shtetit shqiptar më 1912. Kushtetuta do të hynte në fuqi pas ratifikimit të Konventës prej 9 shteteve, nga 13 prej tyre. Debatet për mënyrën e organizimit të qeverisë qendrore dhe lirinë e shteteve, ndikuan për lindjen e dy partive, të federalistëve dhe antifederalistëve. Kushtetuta e SHBA, e miratuar që më 1787, është më e vjetra në botë.

Një event kulmor në aspektin kushtetues e institucional ishte "La Declaration des droits de l'homme et du citoyen"/Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit në Francë më gusht 1789, me shtatëmbëdhjetë nene që frymëzohej nga idetë e Xhon Lokut, Monteskjësë, Ruso e Lafajet, ky i fundit pjesëmarrës në Revolucionin e Amerikës dhe hartues i deklaratës. Deklarata sanksiononte të drejtat e individit dhe të drejtat e kombit.<sup>15</sup> Mbi parimet e shtetit të së drejtës u hartua Kushtetuta e Francës më 3 shtator 1791 e cila shndërroi formën e regjimit nga Monarki Absolute në Monarki Kushtetuese. Idetë për institucionet politike, janë të lidhura me mendimin teorik për kombin. Në vitet e Revolucionit Borgjez Francez, kombi trajtohej si bashkim mekanik i individëve të vendosur brenda disa kufijve gjeografikë, ku *secili komb kishte të drejtë që ta zgjidhte vetë qeverinë e vet*. Fihte në vitin 1807 në Universitetin e Berlinit, mbajti ligjëratën "Fjalime mbi kombin" dhe e trajtoi atë si organizëm i gjallë, i cili nuk

14 L. Ikononi, *Filozofia e së Drejtës...*, f.43.

15 Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve*, Tiranë, 1998, f.355.

krijohet nga individët, përkundrazi i bashkon ata, me gjuhën, kulturën, territorin, traditën dhe lidhjet psikologjike. Mbi këtë realitet politik, F.K.Von Savigny/Savinji, në mesin e viteve 1800, përpunoi fazat e së drejtës, të cilat i klasifikoi, në të drejtë zakonore, në të drejtë shkencore dhe në të drejtën e kodifikuar.

Nga këto teori u frymëzua mendja më e shquar konstitucionale e Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri, i cili në veprën e famshme, “Shqipëria ç’ka qenë ç’është e çdo të bëhetë”?, që e përgatiti më 1899, hodhi idenë e krijimit të shtetit komb. Sipas tij, “shqiptarët janë afër 2 milion banorë, janë trima e të fortë, më të zgjuar se çdo komb tjetër...me gjithë ndryshimet e besëve, janë të bashkuar dhe kanë gjith’ato që i duhen një kombi për t’i vajtur punët mbarë”.<sup>16)</sup> Por, teza e Sami Frashërit mbeti në “kufij të harresës”, pasi, prej vitit 1882 deri më 1905, me përjashtim të vitit 1899, Lëvizja Kombëtare Shqiptare ishte mjaft e zbehur.

### **Konceptet shkencore mbi historinë e institucioneve politike dhe institucionit “njeri”.**

Studimi i institucioneve politike realizohet përmes koncepteve shkencore për “historinë”, “historinë politike” dhe “historinë e institucioneve politike”. Kuptimi për këto nocione gjatë rrjedhave të historisë ka evoluar. Etimologjia e fjalës *histori*, vjen nga greqishtja e lashtë e antikitetit “*οἶσα*”/ *oisa/rrënjë*”.<sup>17)</sup> *Nocioni “histori” në fillim mori kuptimin e njohjes, të lajmit e të idesë së njeriut, që nëpërmjet dijes kërkonte të dhëna. Në kulturën helene nocioni mori kuptimin e dijes së njeriut mbi të kaluarën, nëpërmjet vëzhgimit vetjak. Latinët më vonë i dhanë kuptimin e studimit e të kërkimit të së vërtetës dhe përfitim të dijes, nëpërmjet studimit dhe kërkimit shkencor të historisë. Romakët e quajtën “*storia*”, mandej në frëngjisht “*histoire*” dhe “*story*” anglisht.*

16 S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë...*, f.52.

17 G. Giakoumis, *Historia e nesërmja e një shkence...*, f.17.

Historia studion në mënyrë analitike të kaluarën dhe procesin zhvillues të jetës njerëzore, duke përjashtuar procesin ku njeriu nuk është subjekt. Në këtë kuptim historia përshkruan ngjarjet ose realitete që i përkasin së shkuarës, por që na mundëson dije rreth fakteve, ngjarjeve politike dhe personaliteteve me ndikim në rrjedhën historike të themelimit të institucioneve politike e juridike të shtetit. Institucioni njeri është vendimtar në zhvillimin e historisë së shkurtër institucionale. Njeriu pasi u "arratis" prej vartësisë despotike të natyrës, përballoi me shumë sakrifica ndryshimet kozmogonike të kohës dhe në këtë proces kaloi, nga gjendja natyrore e "krijimit", në gjendjen shpirtërore të "krijuesit". Nevoja i imponoi kalimin nga veprimi spontan, te veprimi i vetëdijshëm, duke "krijuar" njeriun "homo sapiens". "Njeriu krijesë" u shndërrua gradualisht në "Homo faber"/ose njeriun veprues, që me gjykimin, arsyetimin dhe aftësinë parashikuese krijoi gjuhën, fenë, artin, shkencën dhe institucionet politike e juridike. Edhe mitologjia e lidhte lindjen e historisë me Prometeun, si dëshmitari i lirisë, që pasi përftoi prej zjarrit të Ifestit/Ηφαίστη flakën, dhe prej Athinasë urtësinë, i dhuroi njeriut mendjemprehtësinë dhe parashikueshmërinë, për të ndërtuar institucionet politike e juridike.

Mendimi filozofik, politik dhe institucional i antikitetit, me demokracinë e zhvilluar institucionale, duket sikur e "qesëndis" sjelljen antiinstitucionale të politikanëve të "botës moderne". Prandaj vjen si një nevojë studimi i thelluar i trashëgimisë sonë institucionale, me qëllim që Ilirët, të mos futen te popujt barbarë, si i kanë cilësuar disa studiues. Sepse, ka fakte të shumta historike për kulturën institucionale të ilirëve në Antikitet, dhe Mesjetën e Hershme. Mbretërit ilir dhe dinastitë ilire, kanë bërë histori, sepse janë ballafaquar me perandoritë më të mëdha të Antikitetit, ashtu si perandorët ilirë drejtuan në Antikitet Perandorinë Romake dhe Perandorinë Bizantine. *Në këtë rrafsh mendoj se shqiptarët duhet ta pretendojnë trashëgiminë institucionale të perandorëve ilir, si në Perandorinë Romake dhe në Perandorinë Bizantine.*

Shqiptarët kanë qenë aktorë të rëndësishëm politik e ushtarak edhe në Perandorinë Osmane. Kryevezirët me origjinë shqiptare e drejtuan atë perandori rreth 150 vjet. Sami Frashëri i vlerësonte vezirët dhe kryevezirët me origjinë shqiptare, si më të mëdhenjtë e Perandorisë Osmane, dhe që i zgjeruan kufijtë e saj. Sipas tij, Sinan Pasha e ngriti flamurin në Jemen dhe në Indi.<sup>18)</sup> Kara Murat Pasha, ishte dy herë kryevezir i Perandorisë Osmane, në vitin 1649 dhe 1655. Më vonë u shqua Dinastia e Qypërlinjëve, kryeveziri që rrethoi edhe Vjenën.<sup>19)</sup> Gjatë sundimit Osman kanë qenë 96 sadrazemë/kryevezirë. Sipas studiuesit Hysamedin Feraj 42 ishin me origjinë shqiptare.<sup>20)</sup> Kryevezirët me origjinë shqiptare vazhduan edhe në shek. XX. Në prag të rikthimit të Hyrjetit/Kushtetutës Osmane më 1908, Vezir i Madh i Perandorisë Osmane ishte vlonjati Ferit Pasha, vëllai i Syrja Vlorës e kushëri i Ismail Qemalit. Në vigjilje të themelimit të shtetit shqiptar Ferit Pasha ishte Kryetar i Senatit Osman.<sup>21)</sup>

Institucionet politike njihen edhe nëpërmjet historisë politike, *si historia e themelimit e modernizimit dhe e rënies së institucioneve politike të shtetit, por edhe e “aktorëve politik” që e bëjnë historinë politike. Në këtë kuptim historia politike mund të shërbejë si kornizë brenda së cilës shpjegohet dhe kuptohet historia e institucioneve politike.* Etimologjia e konceptit institucion buron nga latinishtja “institutio”, që nënkuptonte normën aktin, ligjin a dekretin.<sup>22)</sup> Më vonë u kuptua si e drejtë dhe si tërësi normash të krijuara nga një institucion përfaqësues sovran e legjitim, që sipas të drejtës kushtetuese nominohet, kuvend, asamble ose kongres

18 Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, Prishtinë: Dija 2007, f.39.

19 Po aty, f.39.

20 Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, ribotim, Shkup: SH.B “Logos A”, 1999, f.52.

21 Ilir Konomi, *Pavarësia - Udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, Tiranë: UET Press 2012, f.171.

22 Aurela Anastasi, *Historia e Institucioneve*, Ribotim, Tiranë: Pegi 2006, f. 11.

kombëtar. Historinë dhe institucionet Georgios Giakoumis i quan "*e nesërmja e një shkence të së djeshmes*".<sup>23)</sup> Historia e institucioneve politike nuk mund të jetë e plotë pa përdorur edhe instrumentet e kronologjisë, paleografisë, diplomatikës, heraldikës, numizmatikës, gjenealogjisë e hartografisë, si elementë shkencor që mundësojnë studimin e historisë së institucioneve politike.<sup>24)</sup> Mbi këto kritere u studiu humanizmi i "perëndimit të përgjumur" në shek. XV-XVIII, nga Makiaveli, Guiciardini e disa të tjerë, kur filluan të shkruajnë histori politike për dinastitë, betejat dhe biografite e gjeneralëve, duke u mbështetur në burimet e pakta arkivore dhe nëpërmjet zhbirimit të ngjarjeve. Më vonë romantizmi pozitivist ndikoi edhe te Volteri, i cili guxoi të shkruajë për historinë e qytetërimit.

Montesquieu/Monteskie, në veprën e tij "*Mbi madhësinë dhe rënien e Romës*" / *De la Grandeur et de la decadence des Romës, konsideroi si shkak kryesor të rënies së institucioneve politike të Republikës të Romës, votimin e fshehtë për vendimmarrjet e rëndësishme nga përfaqësuesit e korrumpuar, qëndrimin e gjatë në pushtet, humbjen e virtytit dhe rritjen e smirës që nxiti korrupsionin dhe krijoi psikologjinë shoqërore të frikës nga prirjet despotike të qeverisjes*.<sup>25)</sup> Duke analizuar qeverisjen republikane, qeverisjen monarkike dhe atë despotike, Montesquieu krijoi më 1748, veprën *Mbi frymën e ligjeve* / *De l'esprit des lois*. Me këtë veper ai përpunoi teorinë e ndarjes së pushteteve të shtetit, në pushtet ligjvënës, në pushtet ekzekutiv dhe atë gjyqësor.<sup>26)</sup> Monteskie mendonte se, nëse një njeri, ose një pushtet, do i ushtronte të gjitha pushtetet e shtetit, demokracia institucionale do të humbte vlerat e së drejtës. Me këtë formulim ai kundërshtonte

23 G. Giakoumis, *Historia është e nesërmja...*, f.17.

24 H. Ismaili & F. Sejdiu, *Historia e Institucioneve ...*, f. 5.

25 Charles-Louis Montesquieu, *Mbi frymën e ligjeve*, Fondacioni Soros, Tiranë: Luarasi 2000, f. 18-42.

26 Charles-Louis Montesquieu, *Mbi frymën e ligjeve*, .. f.188.

Ulpinianin e Romës së Lashtë që sundimtarit i jepte fuqinë e ligjit, *Quod principi placuit, legis habet vigorem*. Sipas Ulpinianit sundimtari ishte i liruar nga ligji/*Princeps legibus solutus est*.<sup>27)</sup>

---

27 H. Ismaili & F. Sejdiu, *Historia e Institucioneve ...*, f.16; G. Giakoumis, *Historia është e nesërmja ...*, f.20.

## BIBLIOGRAFIA


- Anastasi Aurela, *Historia e Institucioneve*, Ribotim, Tiranë: Pegi 2006.
- Giakoumis Georgios, *Historia, e nesërmja e një shkence të së djeshmes*, përkthyer nga Elvis Bramo e Marie Hysko Ed. Meyer, Tiranë: Emal, 2011.
- Frashëri Sami, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, Prishtinë: Dija 2007.
- Feraj Hysamedin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, ribotim, Shkup: SH.B "Logos A", 1999.
- Hobbes Thomas., *Leviantani*, Tiranë: Dita 2000, f.106.
- Norman Davies, "Europe a History, A panorama of Europe, east and west, from the ice age to the cold war, from theurals to Gibraltar", New York, 1998, referuar nga Hilmi Ismail, Fatmir Sejdiu, *Historia e Institucioneve Juridike*.
- Puto Arben, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, botimi Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2003.
- Ismaili Hilmi & F. Sejdia, *Historia e institucioneve dhe shteterore*, Prishtine 2009.
- Ikonomi Liljana, *Filozofia e së Drejtës*, Tiranë: Ekspres, 2006.
- Montesquieu Charles-Louis, *Mbifrymën e ligjeve*, Fondacioni Soros, Tiranë: Luarasi 2000.
- Maurois André, *Histori e Anglisë*, Shtëpia Botuese "Çabej" Tiranë, 1996, përkthim Pjetër Arbnori.
- Ruso Zhak Zhan, *Kontratasociale*, botim Luarasi University Press, Tiranë 2007.
- Konomi Ilir, *Pavarësia - Udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, Tiranë: UET Press 2012.
- <http://www.noa.al/artikull/367521/367521.html>







*Prof. Asoc. Dr. Pëllumb KARAMETA*  
*Dekan, Pedagog*  
*Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore*  
*Koleji Universitar “Wisdom”*  
e-mail: [pellumb.karameta@wisdom.edu.al](mailto:pellumb.karameta@wisdom.edu.al)



**BASHKËPUNIMI PROFESIONAL**  
**“PSIKOLOG SHKOLLOR - MËSUES”**  
**NË FUNKSION TË NXËNIES**  
**EFEKTIVE**

## **Abstrakti**

Studimi synoi të hetojë disa aspekte të formimit universitar psiko-pedagogjik të psikologëve dhe të mësuesve, si dhe të bashkëpunimit profesional mes tyre, për përmirësimin e cilësisë së nxënies. Në studim u përfshinë psikologët e shkollave 9 vjeçare të qytetit të Tiranës dhe mësues të disa shkollave të këtij qyteti. Bazuar në raportimet e subjekteve, u vlerësuan aspekte të ndërveprimeve profesionale mes dy target grupeve. Për secilin prej tyre, janë konsideruar informacionet lidhur me diplomimin, gjininë, kohën në detyrë dhe shkollat ku kontribuojnë. Është supozuar se efektiviteti dhe cilësia e punës për nxënie efektive te secili grup ndikohen nga cilësia e formimit fillestar universitar, nga përpjekjet për vetëkualifikim, nga cilësia e ndihmës dhe e kërkesave të drejtuesve. Nga studimi konstatuam se: 1) formimi fillestar i mësuesit dhe i psikologut, në fakultetet respektive, mund dhe duhet të përmirësohet; 2) raportet profesionale midis dy profesionistëve të arsimit në funksion të nxënies efektive, cenohen nga kufizimet në formimin psikologjik të mësuesit dhe në formimin pedagogjik të psikologut. Përgjigjet e përftuara sugjerojnë implikime për psikologët e shkollave, mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe stafet akademike të fakulteteve që formojnë psikologë dhe mësues.

***Terma kyçe:** Psikologu shkollor, mësuesi, formimi fillestar akademik, formimi pedagogjik, formimi psikologjik.*

## **Abstract**

The study aimed to investigate some aspects of the psycho-pedagogical university education of psychologists and teachers, as well as their professional cooperation between them, to improve the quality of learning. The study included 9-year-old school psychologists in Tirana and teachers of several schools in the city. Based on subject reporting,

aspects of professional interactions between the two target groups were evaluated. For each of them, information on graduation, gender, and time in office and the schools where they contributed are considered. It is assumed that the effectiveness and quality of work for effective learning in each group is influenced by the quality of initial university education, self-employment efforts, quality of support, and leadership requirements. From the study we found that: 1) the initial training of the teacher and the psychologist in the respective faculties can and should be improved; 2) the professional relationships between the two education professionals in the function of effective learning are violated by the limitations in the psychological formation of the teacher and the pedagogical formation of the psychologist. The answers received suggest implications for school psychologists, teachers, school directors, and academic staffs of faculties that form psychologists and teachers.

**Key words:** *School psychologist, teacher, initial academic education, pedagogical training, psychological training.*

## **HYRJE**

Përkufizimet e hershme mbi psikologjinë shkollore janë të larmishme, por thelbi i tyre është i njëjtë: *“Psikologjia shkollore është disiplinë që rrjedh nga trangu i psikologjisë së përgjithshme dhe zbaton në edukim të gjithë gjetjet dhe njohuritë teorike”*(cit: Varoshi, 2013). Suzan Grey (1963) deklaronte se *“psikologët shkollorë kanë dy role kryesore: a) si zgjedhës të problemeve të orientuar mbi të dhënat në shkollë dhe b) si transmetues të njohurive dhe aftësive psikologjike”* (Theksimet, këtu e në vijim, janë tonat).

Në krahasim me përkufizimet e viteve 1960-70, ato aktuale përpiqen të jenë më të drejtpërdrejta dhe theksojnë përcaktimin e karakteristikave thelbësore të psikologut shkollor. Kështu,

sipas Shoqërisë Kombëtare të Psikologjisë Shkolllore (NASP): *“Psikologu shkollor ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses në shkollë, në shoqëri, në zgjidhjen e problemeve emocionale dhe të sjelljes. Ata **bashkëpunojnë me mësuesit, prindërit dhe profesionistë të tjerë** për të krijuar mjedise të sigurta, në mbështetje të procesit të nxënies, duke ndikuar gjithashtu dhe në forcimin e lidhjes: shtëpi-shkollë-komunitet për të gjithë nxënësit”* (cit: Varoshi, 2013). Sipas Shoqatës Kombëtare të Psikologëve Shkollor (NASP)<sup>1</sup> *“psikologët e shkollave janë të trajnuar **në psikologji dhe edukim**, për të ndihmuar fëmijët të jenë të suksesshëm në aspektin akademik, social dhe emocional”*. Në kontekstin tonë arsimor, sipas Abdurrahmanit (2016), *“**bashkëpunimin mes mësuesve, drejtuesve të institucioneve arsimore (IA) parauniversitare dhe psikologëve shkollorë është tejet me vlerë**. Kjo siguron që nxënësit të familjarizohen me rolin edukues, konsultues dhe informues të psikologëve shkollorë, duke rritur në këtë mënyrë efektivitetin e shërbimit që ata ofrojnë”*. Qëllimi kyç i shërbimit tonë psikologjik shkollor është **promovimi i mirëqenies mendore dhe fizike të nxënësve**, si dhe **lehtësimi i procesit të nxënies**. Për plotësimin e qëllimit, psikologu shkollor **në bashkëpunim me personelin pedagogjik dhe drejtuesit e institucionit** planifikon dhe realizon shërbime që mundësojnë zhvillimin akademik, profesional, shoqëror dhe vetjak të nxënësve. Për këtë, sipas Dispozitave Normative (2013), ai realizon këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- a) **“Në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit**, identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese.

---

1 Shoqata Kombëtare e Psikologëve Shkollor (NASP) është shoqatë profesionale që përfaqëson më shumë se 25.000 psikologë shkollorë, studentë të diplomuar dhe profesionistë të lidhur në ShBA dhe 25 vende të tjera. Organizata më e madhe në botë e psikologëve të shkollave, NASP, punon për të çuar përpara praktikat efektive për të përmirësuar të nxënëit, sjelljen dhe shëndetin mendor.

- b) **Ndihmon punonjësit arsimorë**, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj.
- c) **Informon, nëpërmjet bisedave e leksioneve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet tipike që nxënësit hasin gjatë të mësuarit dhe të nxënësit.**
- ç) **Ndihmon mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë** për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e institucioneve arsimore të zakonshme.
- d) Këshillon nxënësit për karrierën e tyre.
- dh) Administron dhe interpreton teste psikologjike (nga psikologu).
- e) Plotëson dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfutur nga shërbimi psiko-social.
- ë) Raporton me shkrim tek drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe prindër të nxënësit.
- f) Merr pjesë në kërkime të parashikuara në planin vjetor të njësisë”.

Po sipas këtij dokumenti (DN), **mësuesi** duhet:

- a) “të trajtojë këdo, në mjediset e IA-së, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësira, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë;
- b) të përkujdeset për **mbarëvajtjen e çdo nxënësi** të tij;
- c) të japë ndihmesën e tij për **mbarëvajtjen e institucionit** ku punon;
- d) të kërkojë të shqyrtohen në drejtorinë e institucionit, këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve të institucionit dhe bordin e institucionit **çështje që shqetësojnë cilësinë e shërbimit arsimor** në institucion”.

Ndërkaq, ne konsiderojmë se:

- sistemi arsimor i sotëm është shumë kompleks;
- nuk ka një qasje për nxënien që funksionon njëlloj për të gjithë subjektet;
- nxënia është përpjekje e përjetshme, rezultat i ndërveprimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm;
- njerëzit nxënë jo vetëm në shkollë, ata nxënë në punë, në situata sociale, madje, nxënë dhe kur bëjnë punë të thjeshta si punët e shtëpisë apo kryerja e detyrave.

Kjo janë disa nga arsyt pse psikologët shkollor dhe mësuesit po fokusohen në identifikimin dhe studimin e metodave të nxënies, për të kuptuar më mirë se si njerëzit ndërtojnë, ruajnë dhe përdorin informacion të ri. Në këtë kontekst, psikologët shkollorë, si njohës të teorive psikologjike të zhvillimit njerëzor, po përpiqen të kuptojnë nxëniet individuale dhe të informojnë mësuesit për ndërtimin efikas të procesit të nxënies. Dy grupet, përmes bashkëpunimit të ndërsjellë, mund të thellojnë njohjet se si realizohet nxënia nga subjektet në mjedise të ndryshme, për të identifikuar qasjet dhe strategjitë që e bëjnë atë më efektive. Në këtë kuptim, bashkëveprimi në mjediset e shkollës, në dobi të përmirësimit të cilësisë së nxënies, bëhet pjesë e rëndësishme e punës së tyre dhe objekt i studimit tonë, realizuar në Shkurt - Qershor 2018.

## KOMPOZIMI I STUDIMIT

### I. QËLLIMI, PYETJET KËRKIMORE (P) DHE HIPOTEZAT (H)

Të hetohen disa aspekte të formimit universitar psiko-pedagogjik të psikologëve dhe të mësuesve dhe të bashkëpunimit profesional mes tyre, për përmirësimin e cilësisë së nxënies.

Pyetjet e mëposhtme kërkimore ndihmuan në realizimin e studimit:

**P<sub>1</sub>**: A mund të përmirësohen formimet fillestare të mësuesve dhe psikologëve në fakultete?

**H<sub>1</sub>**: Ne supozuam se formimi fillestar profesional i psikologut dhe i mësuesit është faktor themelor që ndikon cilësinë e shërbimeve që ofrojnë në funksion të nxënies efektive.

**P<sub>2</sub>**: A e ndikon bashkëpunimin me mësuesit, formimi pedagogjik i psikologut?

**H<sub>2</sub>**: Ne supozuam se formimi pedagogjik i psikologut mund të ndikojnë bashkëpunimin me mësuesit.

**P<sub>3</sub>**: A e ndikon bashkëpunimin me psikologun, formimi psikologjik i mësuesit?

**H<sub>3</sub>**: Ne supozuam se formimi psikologjik i mësuesit, mund të ndikojnë bashkëpunimin me psikologun.

## II. METODA

Kompozimi i studimit u orientua si qasje empirike e cila, siguron të dhëna cilësore dhe sasiore, që mundësojnë të identifikohen disa dallime apo ngjashmëri: a) në dokumentacionin universitar për formimin e psikologut shkollor dhe mësuesit; b) në nivelin e bashkëpunimit profesional ndërmjet tyre.

Megjithëse është e vështirë të përcaktohet në terma specifike, studiuesit kanë rënë dakord që, një qasje e metodës së përzier është qasje pragmatike për përshkrimin e pikëpamjeve të një subjekti specifik (Johnson, Onwuegbuzie, & Turner, 2007). Informacioni i mbledhur nga planet mësimore të disa fakulteteve që formojnë psikologë shkollorë dhe mësues dhe nga një sondazh me psikologë e mësues, u analizua për të kuptuar dallimet dhe afritë rreth bashkëpunimit të psikologëve të shkollave me mësuesit.

### III. PJESËMARRËSIT

Për qëllimet e këtij studimi, baza e të dhënave u ndërtua me informacione nga:

- 30 psikologet e shkollave të qytetit të Tiranës.
- 54 mësues të shkollave “De Rada”, “Pjetër Budi”, “Kongresi i Lushnjës” dhe “Fan Noli”.

### IV. INSTRUMENTET E PËRDORURA

- 2 pyetësorë me nga tri rubrika. Rubrika e parë u kushtohet të dhënave lidhur me diplomimin, gjininë, kohën në detyrë dhe shkollat ku kontribuojnë. Kërkesat e rubrikës së dytë ishin të njëjta, përgjigjet e të cilave mundësojnë të reflektohet rreth kuptimeve që kanë subjektet për tema kyçe të pedagogjisë. Rubrika e tretë përbëhet nga një seri pyetjesh, përgjigjet ndaj të cilave mund të zgjidhnin një nga 4 nivelet (*S’jam aspak dakord / Nuk jam dakord / Jam dakord / Plotësisht dakord*).

- Planet mësimore të Departamenteve të Psikologjisë dhe të Mësuesisë së disa Fakulteteve.

### V. TË DHËNAT DHE DISKUTIMI

Të dhënat u përfatuan përmes: a) shqyrtimit të planeve mësimore të departamenteve universitare dhe b) përpunimit të të dhënave nga pyetësorët me psikologet dhe mësuesit.

#### V. A. TË DHËNAT NGA DOKUMENTACIONI QË LIDHET ME FORMIMIN FILLESTAR PROFESIONAL

##### V. A.1. Për formimin pedagogjik të psikologut

a) *Plani mësimor / Master shkencor, Psikologji shkolllore / FSHS / UT / Tiranë*



NR	DISIPLINA	KREDITET
1	Psikologji zhvillimi e avancuar	6
2	Patologjitë e zhvillimit	6
3	Organizimi i shkollës dhe i shërbimit psikologjik	6
4	<b>Kurrikula shkollore</b>	<b>6</b>
5	Metodat e kërkimit në psikologji	6
6	Praktikum në metodat e kërkimit në psikologji	6
7	<b>Teoritë e të nxënit dhe modelet e mësimdhënies</b>	<b>7</b>
8	Psikologji shkollore 2	7
9	Krizat shkollore dhe ndërhyrja	6
10	Lëndë me zgjedhje: Terapi arti dhe loje / Ndërtimi dhe zhvillimi i karrierës. Trajnimi në shkollë.	4
	-Seminar special (SPSS)	
11	Praktikum në këshillim	6
12	Vështirësitë në të nxënë	5
13	Vlerësimi në kontekstin shkollore	5
14	Çështje të etikës shkollore	5
15	Praktikë në institucione dhe agjenci arsimore	9
	1. Menaxhim Rasti	3
	2. Praktikë Profesionale	6
16	Provë finale	30

**b) “Master i Shkencës” në Psikologji Edukimi / Universiteti “Aleksandër Xhuvani” – Elbasan**

Nr	DISIPLINA	KREDITET
<b>1</b>	<b>VITI 1 - SEMESTRI:1Kr</b>	
2	Moduli: Aftësim Gjuhësor dhe Plani Personal i Studimit	3
3	Kërkimi Shkencor ne Psikologjinë e Edukimit / Moduli: Kërkimi Cilësor ne Psikologji Edukimit	7

Nr	DISIPLINA	KREDIDTE
4	Konjicioni dhe Metakonjicioni ne te Nxënë	0
5	Metodat e Kërkimit te Avancuar ne Shkencën e Psikologjise se Edukimit	7
6	Teori dhe Praktike ne Psikologji Edukimi / Moduli: Psikologji Edukim	5
7	Psikologji Komuniteti dhe Familjes	5
8	Psikologji Shëndeti & Cilësi e Jetës / Moduli: Psikologji Shëndeti e Rehabilitimi	3
9	<b>VITI 1 - SEMESTRI:2</b>	
10	Aftësim Gjuhësor dhe Plani Personal i Studimit	0
11	Psikologji Shëndeti & Cilësi e Jetës / Moduli: Ergonomi	3
12	Moduli: Formimi i Lidërshipt dhe Praktikant e Komunikimit	3
13	Konjicioni dhe Metakonjicioni ne te Nxënë	7
14	Moduli: Praktike ne Institucion Arsimor	0
15	Teori dhe Praktike ne Psikologji Edukimi / Moduli: Psikologji Sociale e Aplikuar	5
16	Testet Psikologjike te Matjes dhe Vlerësimit Konjitiv, Gjuhësor-Social dhe Emocional	8
17	<b>VITI 2 - SEMESTRI:1</b>	
18	Vlerësimi dhe Ndërhyrjet Edukative	7
19	Aftësim Gjuhësor dhe Plani Personal i Studimit	0
20	Çrregullimet ne te Folur dhe Ndërhyrjet Therapeutike	3
21	Orientim ne Studim & Aftësim Komunikativ dhe Etik / Moduli: Etika Profesionale	3
22	Praktike ne Institucion Arsimor / Moduli: Praktike ne Institucion	0

c) *Plani mësimor / Master shkencor, Psikolog shkollor / KU "Wisdom"- Tiranë*

NR	DISIPLINA	KREDITET
<b>Viti I</b>		
1	Vlerësim psikologjik shkollor.	8
2	Psikologjia shkollore e zbatuar.	8
3	Metodologjitë dhe analizat e të dhënave (e avancuar)	8
4	Defiçencat intelektuale tek nxënësit dhe diagnostikimi.	8

NR	DISIPLINA	KREDITET
5	Psikologji zhvillimi social e afektiv i fëmijëve e adoleshentëve.	8
6	Psikologjia e fëmijëve me nevoja speciale.	8
7	<b>Kurrikula shkollore.</b>	<b>8</b>
	Lëndë me zgjedhje: 1. Psikologjia botërore dhe kombëtare. 2. Çrregullimet autistike dhe trajtimi	4
<b>Gjithsej: Viti I</b>		<b>60</b>
8	Psikologji këshillimi shkollore.	5
9	<b>Pedagogji e thelluar.</b>	<b>5</b>
10	Psikologjia e sjelljeve devijante tek fëmijët dhe adoleshentët.	5
11	<b>Lëndë me zgjedhje</b> 1. Psikologji e komunikimit klinik me fëmijët dhe adoleshentët. 2. Psikologji motivacioni (e avancuar).	4
12	Praktikë mësimore	11
	TEZË DIPLOME	30
<b>Totali</b>		<b>120</b>

## **V. A.2. Për formimin psikologjik të mësuesit**

*a) Plani mësimor "Master shkencor në mësuesi" /  
Departamenti i gjuhës gjermane / FGjH / UT*

NR	DISIPLINA	KREDITET
<b>Formim bazë</b>		
1	1. Metoda të mësimdhënies dhe mendimi kritik 1a. Metoda të mësimdhënies 1b. Mendimi kritik	8
2	<b>Psikologji zhvillimi</b>	<b>5</b>
3	3. Të nxënit dhe Menaxhimi i klasës	8
4	4. Zhvillim kurrikule	4
5	5. Vlerësim	5
	Formim i specializuar si mësues lënde	
	<i>Formim didaktik lëndor</i>	
6	<b>1. Psikolinguistikë dhe metodologji e mësimit të gjuhës së huaj</b>	<b>6</b>

NR	DISIPLINA	KREDITET
7	2. Gjuhësi e zbatuar dhe komunikim ndërkulturor	6
8	3. Burime të informacionit në mësimin e gjuhës së huaj	6
9	4. Gjuhë e huaj për qëllime specifike	6
	<i>Lëndë plotësuese në formimin e specializuar</i>	
10	1. Gjuhë e huaj C (niveli i avancuar)	6
11	2. Gjuhë e huaj C (niveli i avancuar)	6
<b>Totali</b>		12
	Përvojë praktike	12
	Formim kërkimor	
	o <i>Lëndë të formimit kërkimor</i>	
12	1. Metodologji e kërkimit shkencor dhe kërkim në kontekstin pedagogjik të gjuhës së huaj	6
13	2. Laborator teorik dhe praktik për shkrimin e temës së provës finale	6
	<i>Prova finale</i>	30
	<b>Totali</b>	30
	<b>Totali 2 vite</b>	120

*b) Plani mësimor "Master Shkencor Mësues i Matematikës për Arsimin e Mesëm të Lartë" / FShN / UT*

NR	DISIPLINA	KREDITE
<b>Viti I</b>		
1	<b>Psikologjia e zhvillimit</b>	<b>6</b>
2	Metodika e mësimdhënies dhe mendimi kritik	8
3	Zhvillim kurikule	4
4	Vlerësim	6
5	Të nxënit dhe menaxhimi i klasës	6
6	Didaktike e matematikës	8
7	Modelim dhe teknika e zgjidhjes të problemit	10
8	Njohuri të informatikës	4
9	Historia e mendimit matematik dhe probleme të sotme	5
10	Praktike profesionale I	3
<b>Viti II</b>		
11	Gjeometria e lartë	4
12	Calculus dhe plotësime në analizë	6

13	Çështje speciale në matematike	4
14	Gjuhe e huaj	6
15	Informatika ne mësimdhënie	4
16	Praktike profesionale II	6
17	Provim Diplome	30
	Lëndët me zgjedhje	
18	Çështje speciale në analizë numerike	3
19	Çështje speciale në algjebër	3
20	Çështje speciale në analizë funksionale	3
21	Çështje speciale në probabilitet	3

*c) Plani mësimor “Master i shkencave në matematikë” në AMU Universiteti “A. Xhuvani” – Elbasan*

Nr.	DISIPLINA	KREDITE
1	Edukimi Gjithëpërfshirës	3
2	Moduli: Filozofi Edukimi	3
3	<b>Hyrje ne Psikologji</b>	<b>3</b>
4	Metodat e Kërkimit ne Edukim	3
5	Moduli: Metodologjia e Mësimdhënies	3
6	Moduli: Modelime dhe Teknika te zgjidhjes se problemeve ne Matematike	4
7	Moduli: Planifikimi dhe Zhvillim i Kurrikulave	3
8	Moduli: Sistemet Operative	3
9	<b>Moduli: Psikologji Edukimi</b>	<b>4</b>
10	<b>Moduli: Psikologji Zhvillimi</b>	<b>3</b>
11	Moduli: Software Aplikative	3
12	Moduli: Sociologji Edukimi	3
13	Moduli: Studime statistikore ne kërkimin ne Edukim	4
14	Moduli: Didaktika e Fizikes dhe Vlerësimi	8
15	Moduli: Didaktika e Matematikes dhe Vlerësimi	8

16	Moduli: Histori e mendimit te fizikes	3
17	Moduli: Histori e mendimit te matematikes	3
18	<b>Moduli: Menaxhimi i Sjelljeve ne Klase</b>	<b>2</b>
19	Moduli: Teknika te laboratorit ne mesimdhënien e Fizikes	3

### **V. A.3. Të dhënat nga anketimi i psikologeve shkollore** **Informacioni i përgjithshëm**

Gjinia		Moshë			Ku punon		Arsimi i marrë			Vite në detyrë		
F	M	- 30	31-40	41+	9 vjeçare	Mes-me	MP	MScSh	Dr.	1 vit	2-4	5+
30	-	6	23	1	25	5	7	21	2	4	5	21

### **Renditja e saktë e aspekteve sipas rëndësisë që kanë për suksesin e nxënies**

RENDITJE E SAKTË	RENDITJE E PASAKTË
14 subjekte	16 subjekte
48%	52%

Mësuesit me njohuri të mira për zhvillimin kognitiv zgjedhin për nxënësit detyrat e duhura.	<b>(B) 19 ose 63%</b>
Mësuesit me njohuri të thella për proceset e të nxënësve zhvillojnë më mirë mësimin.	<b>(A) 20 ose 66%</b>
Mësuesit me njohuri të mira për vlerësimin vlerësojnë më mirë arritjet e nxënësit.	<b>(C) 19 ose 63%</b>

***Perceptimi i psikologes për bashkëpunimin me mësuesit***

	VLERËSIM NEGATIV			VLERËSIM POZITIV		
	Aspak dakord	S'jam dakord	SHUMA	Dakord	Plotësisht dakord	SHUMA
Jam e kënaqur nga ndërveprimi me mësuesit		2	2	23	5	28
Mësuesit më kanë ndihmuar për të kuptuar sjelljet e nxënësve		1	1	23	6	29
Këshillat e mësueses më lehtësojnë komunikimin me nxënësit		6	6	19	5	24
Drejtuesit më kanë mbështetur në punën time si psikologe		2	2	8	20	28
<b>Formimi im akademik nuk është i plotë në aspektin arsimor</b>	10	14	24	4	2	6
<b>Kultura psikologjike e mësuesve nuk është e plotë</b>	17	12	29		1	
Zhvillohen veprimtari ku diskutohen probleme arsimore	1		1	18	11	29
Si psikologe, kam kryer vëzhgime në mjedise të nxëni				14	16	30
<b>Në bibliotekën e shkollës ka literaturë psikologjike që më ndihmon për zhvillimin tim profesional</b>	10	12	22	6	2	8
Në shkollë ka mjedis / kabinet pune për psikologjen e shkollës	1	4	5	12	13	25

**V. A.4. Të dhëna nga anketimi i mësuesve*****Informacioni i përgjithshëm***

Gjinia		Moshë			Ku punon		Arsimi i marrë			Vite në detyrë			
F	M	-30	31-40	41+	C	C	MP	MScS	Dok	4-9	10-15	16-25	25+
50	4	3	18	33	18	36	22	31	1	9	12	14	19

Renditja e saktë e aspekteve sipas rëndësisë që kanë për suksesin e nxënies

Mësuesit me njohuri të mira për zhvillimin kognitiv, zgjedhin për nxënësit detyrat e duhura.	<b>B (15) ose 27%</b>
Mësuesit me njohuri të thella për proceset e të nxënit, zhvillojnë më mirë mësim.	<b>A (21) ose 39%</b>
Mësuesit me njohuri të mira për vlerësimin, vlerësojnë më mirë arritjet e nxënësit.	<b>C (9) ose 16%</b>

RENDITJE E SAKTË		RENDITJE E PASAKTË	
Mësues gjithsej	%	Mësues gjithsej	%
<b>18</b>	<b>33</b>	<b>36</b>	<b>67</b>
Në CU			
6	33	12	67
Në CL			
12	33	24	67

**Perceptimi i mësuesit për bashkëpunimin me psikologjen**

	VLERËSIM NEGATIV			VLERËSIM POZITIV		
	Aspak dakord	S'jam dakord	SHUMA	Dakord	Plotësisht dakord	SHUMA
Jam i kënaqur nga bashkëpunimin me psikologjen	4	20	24	23	7	30
Psikologes më ka ndihmuar të kuptoj sjelljet e nxënësve	3	25	28	16	10	26
Psikologjia më kanë lehtësuar komunikimin me nxënësit	1	30	31	20	3	23
Psikologjia më kanë lehtësuar komunikimin me kolegët		35	35	21	8	29



<b>Psikologia më ndihmon për prezantimin e informacionit</b>	5	22	27	23	4	27
<b>Psikologia më ndihmon të përgatit nxënësit për testime</b>	10	24	34	14	6	20
Në shkollë ka veprimtari ku diskutoj me psikologjen problemet	16	18	34	16	4	20
<b>Psikologia kryen vëzhgime në klasa ose mjedise të nxëni</b>	5	31	36	12	6	18
Shkolla ka literaturë psikologjike për zhvillimin tim profesional psiko-psikologjik.	7	34	41	7	6	13
Në shkollë ka kabinet pune të psikologes së shkollës		2	2	43	9	52

## V. B. DISKUTIMI

### V. B.1. Për formimin fillestar pedagogjik të psikologut

- Në planin mësimor të FSHS / UT, 10% e krediteve i kushtohet formimit pedagogjik të psikologut, përmes disiplinave “Kurrikula shkollore”, “Teoritë e të nxënit dhe modelet e mësimdhënies dhe “Vështirësitë në të nxënë”.
- Në planin mësimor të FSHE në Universitetin “A. Xhuvani”, vetëm 7% e krediteve (“Psikologji zhvillimi” dhe “Psikolinguistikë dhe metodologji e mësimit të gjuhës së huaj”).
- Në planin mësimor të FShES në KU “Wisdom”, 10% e krediteve (“Kurrikula shkollore” dhe “Pedagogji e thelluar”).
- Ka dallime ndërmjet disiplinave që u ofrohen studentëve psikologë shkollor për formimin e tyre pedagogjik, në Fakultetet e konsultuara nga ana jonë.

**V. B.2. Për formimin fillestar psikologjik të mësuesit**

- Në Plani mësimor “Master shkencor në mësuesi “ / Departamenti i gjuhës gjermane / FGjH / UT, formimit psikologjik të mësuesit të matematikës i kushtohet 9% e krediteve (“Psikologji zhvillimi” dhe “Psikolinguistikë dhe metodologji e mësimit të gjuhës së huaj”).
- Në Planin mësimor të “Master Shkencor Mësues i Matematikës për Arsimin e Mesëm të Lartë” / FShN / UT /, i kushtohet 4.1% e tyre (Psikologjia e zhvillimit).
- Plani mësimor “Master profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë – Fizikë” / FShE / Universiteti “A. Xhuvani” ofrohen 9.5% (“Hyrje në Psikologji”, moduli: “Psikologji Edukimi”; moduli: ”Psikologji Zhvillimi”)
- Ka dallime ndërmjet disiplinave që u ofrohen studentëve mësues për formimin e tyre psikologjik, në Fakultetet e konsultuara nga ana jonë.

**V. B.3. Psikologu për mësuesin**

- Të gjitha psikologët janë të seksit femër. Moshë mbizotëruese luhet në kufijtë 31-40 vjeç(83%). Sikundër, mbizotëron diploma “Master i shkencave” (70%).
- 93% e psikologeve shkollore janë të kënaqura nga bashkëpunimi me mësuesit.
- Vetëm 48% e tyre raportojnë një renditje të saktë shkakësore të aspekteve që lidhen me formimin psikopedagogjik të psikologut shkollor. Këtë konstatim ata e përforcojnë edhe në rubrikën e tretë të anketës, kur 97% e tyre deklarojnë se “*Formimi im akademik nuk është i plotë në aspektin arsimor*”.
- Gjithashtu, 96% shprehen që “*kultura psikologjike e mësuesve nuk është e plotë*”; sikundër, 73% e tyre shprehen se “*në bibliotekën e shkollës nuk ka literaturë psikologjike që më ndihmon për zhvillimin profesional*”.

#### **V. B.4 Mësuesit për psikologun**

- Target grupi i të anketuarve mbizotërohet nga moshat mbi 41 vjeç (61%). Rreth 66% e tyre punojnë në ciklin e larta të arsimit bazë. Mbizotëron diplomimi në nivelin "Maste i shkencave" (57%).
- Vetëm 33% raportojnë një renditje të saktë shkakësore të aspekteve që lidhen me formimin psiko-pedagogjik.
- 50% e mësuesve kërkojnë të ndihmohen më shumë nga psikologja ne prezantimin e informacionit lëndor përpara nxënësve; ndërsa 62% e tyre kërkojnë të asistohen më mirë në përgatitjen e nxënësve për testime.
- Psikologët përgjithësisht raportojnë se kryejnë vëzhgime në orët e mësimit, ndërsa 67% e mësuesve nuk mendojnë kështu.
- 76% e mësuesve mendojnë se në shkollë duhet të ketë më shumë literaturën që i shërben përmirësimit të kulturës dhe formimit psiko-pedagogjik të tyre.

#### **VI. PËRFUNDIME**

- Nga studimi ynë, kuptuam se formimi fillestar psiko-pedagogjik i psikologut dhe i mësuesit nuk siguron ndërtimin e njohurive dhe të kompetencave të nevojshme profesionale, me të cilat ata të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së nxënies.
- Rrjedhojat konstatohen nga anketimet me secilin target grup. Kështu, psikologët deklaroj se formimi i tyre pedagogjik nuk u mundëson atyre të ndihmojnë sa e si duhet mësuesit dhe nxënësit për metodat, teknikat dhe instrumentet që mund të përdoren në kontekstin e nxënieve formale apo informale.
- Mësuesit, nga ana e tyre, konstatojnë se në fakultete nuk janë trajnuar sa e si duhet për të njohur teoritë kryesore psikologjike dhe teknikat efektive që ndihmojnë në kuptimin dhe adresimin e sfidave që ndesh subjekti kur nxë.

## VII. REKOMANDIME

- ❖ I sugjerojmë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të nxitë Universitetet që formojnë psikologë shkollorë dhe mësues që:
  - të përmirësojnë kurrikulat në drejtim të përfarimit mes tyre; dhe
  - të përmirësojnë raportet e disiplinave / krediteve që i ndihmojnë studentë të ndërtojnë njohuri dhe kompetenca të nevojshme për ushtrimin e profesioneve të tyre.
- ❖ Departamenti i Psikologjisë në KU “Wisdom” të rishqyrtojë planin mësimor të programit Master i shkencës në “Psikologji shkollore dhe edukim” që t’u mundësohet studentëve të përsosin më tej formimin e tyre pedagogjik.

## LITERATURA

- Varoshi, E. (2013). Implementimi i Shërbimit psikologjik shkollor, risia që kontribuon në përfaqshen e sistemit arsimor shqiptar me atë bashkëkohor. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Program i doktoratës.
- Gray, S. W. (1963). *The psychologist in the schools*. New York: Holt, Rinehart & Winston.
- T. Abdurrahmani Shërbimi psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe perceptimet e mjedisit shkollor mbi këtë shërbim. *BJES* (2016).
- Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, 2013, Fq. 22.
- Përshtatur sipas:
- [<http://www.portalishkollor.al/institucion/dispozitat-normative-per-sistemin-arsimor-parauniversitar>]
- Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, 2013, Fq. 34.
- Johnson, R. B., Onwuegbuzie, A. J., & Turner, L. A. (2007). Toward a definition of mixed methods research. *Journal of Mixed Methods Research*, 1, 112-133.
- [<https://dx.doi.org/10.1177/1558689806298224>]
- Fakulteti i Shkencave Sociale. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë (2018). Plani mësimor “Master Shkencor në Psikologji Shkollore”.
- Përshtatur sipas: <http://fshs-ut.edu.al/programet-master>]
- Departamenti “Psikologji-Sociologji-Shkenca Edukimi” - Universiteti “Aleksandër Xhuvani” (2018).

Përshtatur sipas:

- <https://uniel.ems.al/school/program/c36e7517-78a0-4b8d-88d6-a422009ccacd.aspx>
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (2018). Plani Master shkencor mësues gjermanisht.
- Përshtatur sipas:
- [http://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2016/07/plane\\_Masteri\\_shkencor\\_mesuesi\\_gjermanisht-1.pdf](http://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2016/07/plane_Masteri_shkencor_mesuesi_gjermanisht-1.pdf)
- Fakulteti i Shkencave Natyrore. Departamentit të Matematikës (2018). Planet mësimore.

Përshtatur sipas:

- <https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/departamenti-i-matematikees/studime-te-nivelit-te-pare/matematike/>
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit – Departamenti i metodologjisë së Mësimdhënies (2018). Planet mësimore.

Përshtatur sipas:

- <https://uniel.ems.al/school/program/cbdfcabb-0089-4880-bf8d-a71900c4ac31.aspx>



*Prof. Asoc. Dr. Naim MEÇALLA*  
*Zv. Rektor, KolegjiUniversitar ‘Wisdom’*  
*Dekan, Pedagog*  
*Fakulteti i Drejtësisë*  
e-mail: [naim.meçalla@wisdom.edu.al](mailto:naim.meçalla@wisdom.edu.al)  
[mecalla1963@gmail.com](mailto:mecalla1963@gmail.com)



## **PËRGJIMI SIPAS LEGJISLACIONIT AKTUAL SHQIPTAR**

## Abstrakt

Ky punim është i orientuar rreth trajtimit të përgjimit sipas legjislacionit shqiptar. Fillimisht trajtohet kuptimi gjuhësor i emrit përgjim i cili vjen nga folja përgjoj që do të thotë: “rri i fshehur diku e dëgjoj a vëzhgoj dikë për të marrë vesh çfarë thotë, çfarë bën etj; ndjek fshehurazi veprimet e dikujt, vëzhgoj pa më parë kush”. Më tej në punim do të trajtohet kuptimi juridik, roli, rëndësia, grupet llojet e përgjimit, kushtet kur lejohet përgjimi, kërkesa për përgjim, vendimi, procesverbali i përgjimit etj.

*Fjalë kyçe: Përgjim, legjislacion, penale, kufizim, kompetencë, etj.*

## Abstract

This paper is oriented on the handling of the interception under Albanian legislation. Initially, the linguistic meaning of the name comes from the verb which means: “I hide somewhere, I hear and observe someone to find out what, what does, etc; he secretly follows one’s actions, look at who he is. “ Further on, the work will deal with the legal meaning, role, importance, groups of types of interception, conditions when permitting interception, request for interception, decision, timetable record, etc.

*Key words: Interception, legislation, criminal, limitation, competence, etc.*

## Hyrje

Kreu III, i seksionit IV i Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e fundit të bëra me Ligjin nr.9187, datë 12.02.2004 emërtohet “Përgjimet” dhe përfshin nenet 221 – 226. Legjislatori në formulimin e përmbajtjes së seksionit IV të kreut III të Kodit të Procedures Penale ka mbajtur parasysh faktin që përgjimi lidhet ngushtë me të drejtat, liritë dhe jetën



private të njeriut, me sferën intime, korrespondencën dhe banesën e tij, të drejta këto që mbrohen nga:

- *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut*. Respektivisht në nenet 8 dhe 13 të kësaj Konvente parashikohet: “Çdo person ka të drejtë që t’i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe letërkëmbimi i tij”. “Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instancë kombëtare, edhe atëherë kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.
- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Respektivisht në nenet 36 dhe 37 përcaktohet: “Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër komunikimi janë të garantuara”, “Paprekshmëria e banesës është e garantuar”.
- *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*. Më konkretisht: Neni 92/b “Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike”<sup>1)</sup>, Neni 112 “Dhunimi i banesës”<sup>2)</sup>, Neni 121 “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”<sup>3)</sup>, Neni 123 “Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës”<sup>4)</sup>, Neni 254 “Shkelja e paprekshmërisë së banesës”<sup>5)</sup>,

- 
- 1 Ndërhyrja në çdo formë në transmetimet dhe programet kompjuterike, ... dënohet ....
  - 2 Hyrja ose qëndrimi në banesë e tjetrit pa pëlqimin e tij, ...dënohet ...
  - 3 Vendorsja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij,... dënohet ...
  - 4 Kryerja me dashje e veprimeve të tilla si asgjësimi, mosdorëzimi, hapja dhe leximi i letrave apo çdo korrespondencë tjetër, si dhe ndërprerja dhe vënia nën kontroll, dëgjimi i bisedave telefonike, telegrafike ose i çdo mjeti tjetër telekomunikimi, ... dënohet ....
  - 5 Hyrja në banesë, pa pëlqimin e personit që banon në të, prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, veç rasteve kur lejohet nga ligji, dënohet ...

neni 255 “Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës”<sup>6)</sup>. Ndërkaq në paragrafin e dytë të nenit tetë, Konventa Europiane shprehet: “Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, veçse në shkallën e parashikuar nga ligji ...”. Kjo do të thotë se me ligj të veçantë të drejtat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni mund të kufizohen, por ky kufizim duhet t’i nënshtrohet tri kushteve:

- Kufizimi të jetë i parashikuar shprehimisht nga ligj.
- Kufizimi të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike.
- Kufizimi të vendoset për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

Kufizime të tilla parashikohen edhe në Kushtetutë. Konkretisht neni 17/1 shprehet:

“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”.

### ***Përmbajtja gjuhësore***

Emri PËRGJIM vjen nga folja PËRGJOJ që do të thote: “Rri i fshehur diku e degjoj a vezhgoj dike për të marre vesh çfare thote, çfare ben etj; ndjek fshehurazi veprimet e dikujt, vezhgoj pa me pare kush”<sup>7)</sup>. Pra, brenda kuptimit të emrit pergjim perfshihet edhe emri VEZHGIM që vjen nga folja VEZHGOJ dhe që do të thote: “E ndjek me sy dike a dicka,

6 Dhënia e urdhërave ose kryerja e veprimeve për asgjësimin, leximin dhe përhapjen e korrespondencës postare ose që prish, vështirëson, vë nën kontroll ose përgjon korrespondencën telefonike apo të çdo mjeti tjetër të komunikimit, nga ana e punonjësit të ngarkuar me funksion shtetëror ose në shërbim publik e në ushtrimin e tyre, veç rasteve kur lejohet me ligj, dënohet ...

7 Fjalor i gjuhës së sotme Shqipe, faqe 1437, Tiranë, 1980

e veshetroj me vemendje qe ta njoh mire; pergjoj veprimet e dikujt, gjurmtoj levizjet e tij, e ruaj nga vete a çfare ben”<sup>8)</sup>.

### ***Kuptimi juridik – roli dhe rëndësia***

Si përmbajtje juridike, përgjimi është një mjet i posacëm hetimi i fshehtë, - mjet i kërkimit të provës, - me një teknikë që përdoret gjatë veprimtarisë hetimore nga organet e ndjekjes penale, sidomos në fushat e krimit të organizuar, të krimit ekonomik etj pra, në rrafshin e krimeve të rënda në përgjithësi. Përgjimi nuk bëhet vetëm me një teknikë, por kryhet nëpërmjet disa teknikash. Përgjimi përdoret gjatë fazës hetimore. Hetimet kalojnë në dy faza. Faza e parë është faza e fshehtë, - ku bën pjesë dhe përgjimi - dmth që personi nën hetim nuk ka dijeni që po hetohet. Ky hetim bëhet publik pasi organet hetimore shterrojnë të gjitha veprimet e nevojshme për hetimin. Kjo është dhe faza e dytë e hetimit, ku personit nën hetim i bëhen të njohura të gjitha teknikat që përdoren në fshehtësi. Pra, përgjimi është një mjet delikat, përdorimi i tij duhet të bëhet me shumë kujdes.

Në vështrim të telekomunikimeve, me fjalën “Përgjim” kuptohet ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes<sup>9)</sup>.

“Objekt përgjimi” janë sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuale ose lloj tjetër informacioni, për të marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit”.<sup>10)</sup> Sukseset e arritura në zbulimin e krimit, sidomos të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, siç janë p.sh trafikimi i lëndëve narkotike, armëve apo qenieve njerëzore, vrasjet me pagesë, shfaqjet korruptive, shpërdorimet ekonomike etj që organizohen e kryhen me mënyra tepër të stërholluara sa

8 idem, faqe 2161

9 Ligji, nr.9157, dt.4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve” , Neni 3.

10 idem

në shumë raste nuk lënë as gjurmë prove sepse realizohen nëpërmjet mjeteve teknike nga më modernet e të sofistikuara, flasin për rolin dhe rëndësinë e përgjimit si mjet për kërkimin e provës për hetimin dhe vërtetimin e veprimtarive kriminale, që përgjithësisht mjetet e tjera të kërkimit të provës janë të papërshtatshme, të pamjaftueshme dhe jo efektive. Sidomos përgjimet telefonike dhe ambjentale që përbëjnë metoda hetimore të reja duke përdorur edhe mjete teknike moderne e duke ndryshuar edhe vetë pamjen e mënyrat e hetimit kriminal për grumbullim të dhënash që me mënyrat e zakonshme të hetimit do të mbeteshin pa u zbuluar, i japin përgjimit vlerën e përparësisë dhe të domosdoshmërisë në rendin e mjeteve të kërkimit të provës.

### ***Grupet – llojet e përgjimit***

Sipas neneve 221 dhe 294/a/b të KPrP del se ekzistojnë disa grupe e lloje përgjimi. Kështu mund të renditen:

- Përgjimi i fshehtë ambjental (në vende publike dhe private)
- Përgjimi i bisedave dhe komunikimeve midis të pranishmëve (asnjëri prej personave nuk ka dijeni se po përgjohet ose ka dijeni vetëm njëri prej tyre)
- Përgjimi me telefon, faks, kompjuter, ose me mjete të tjera të telekomunikimeve
- Përgjimi i fshehtë me audio (zanor) dhe video (pamor)
- Përgjimi i fshehtë fotografik
- Përgjimi i fshehtë filmik ose me video
- Regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës
- Përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes
- Përgjimi jo tipik (klandestin, me simulim, me infiltrim)

### ***Kushtet kur lejohet përgjimi***

Përgjimi lejohet nga autoritetet e ngarkuara me ligj, vetëm kur ekzistojnë dy kushte:

## 1. Në kushtin e parë përfshihen dy grupe:

**Grupi I.** Mund të pergjohet personi për të cilin ka procedim penal, parashikuar në nenin 221/1 I KPrP<sup>11)</sup>:

- Krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet.
- Për kundravajtje penale të fyerjes e të kanosjes, të kryera me mjete të telekomunikimit.
- Për të lehtësuar kërkimin e personave të ikur, që nuk gjenden (neni 247/5 I KPrP)

**Grupi II.** Mund të përgjohet personi për të cilin ka procedim penal, parashikuar në nenin 221/2 KPrP<sup>12)</sup>:

- krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim, në maksimum, me dy vjet.

## 2. Kushti i dytë:

- përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara;
- ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën<sup>13)</sup>

Vetem prania e njëkohshme e këtyre dy kushteve e bën të ligjshëm lëshimin e autorizimit për përgjim, që:

### *Urdhërohet kundër:*

- a) të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale;
- b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;
- c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;

11 Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjim me audio dhe video, në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit hyrës dhe dalës.

12 Përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i paisjeve gjurmuese të vendndodhjes.

13 Gjatë trajtimit të temës dhe në konkluzionet shtjellohet më gjerësisht kuptimi dhe përmbajtja e kësaj kërkese

- d) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit.

### ***Vlefshmëria e përgjimit***

Rezultatet e përfuara gjatë veprimtarisë përgjuese janë të vlefshme për të gjithë komunikuesit.(neni 221/4 I KPrP) Kjo do të thotë që rezultatet e përgjimit kanë vlerë për përdorim në funksion të vërtetimit të akuzës, jo vetëm për personin, ndaj të cilit është urdhëruar përgjimi, por edhe ndaj personave me të cilët ai komunikon.

### ***Karakteri parandalues***

Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë<sup>14</sup>. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë. (neni 221/5 I KPrP). Me anë të përgjimit parandalues synohet të rritet efektiviteti i punës së institucioneve informative shtetërore, për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari <sup>15</sup>.

Por rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të Ligjit “Për përgjimin e telekomunikimeve” nr. 9157, datë 04.12.2003 nuk kanë vlerën e provës në një proces penal, me përjashtim të rasteve kur merren sipas Kodit të Procedurës Penale<sup>16</sup>. Në këtë ligj përcaktohen kritere në favor të autoritetit të shtetit, në pajtim me neni 8/2 të Konventës Europiane si nevojë e pranisë së një bazë ligjore konkrete të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit me masat që merren, për mënyrat e përgjimit dhe të mbikqyrjes, për procedurën e autorizimit, për zgjidhjet efektive dhe që lidhen ndër të tjera ruajtjen e

14 Neni 2 i Ligjit “Për përgjimin e telekomunikimeve”nr. 9157, dt. 04.12.2003

15 Neni 2 i Ligjit “Për përgjimin e telekomunikimeve”nr. 9157, dt. 04.12.2003

16 idem, neni 5 I i Ligjit.

fshehtësisë së informacionit <sup>17</sup>).

Në radhën e përgjimeve parandaluese mund të futet edhe veprimtaria e Shërbimit Informativ Shtetëror, ajo e shërbimit informativ / policor i Ministrisë së Brendshme e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe veprimtaria e çdo shërbimi tjetër informativ/policor, i krijuar me ligj<sup>18</sup>), që kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin, për të siguruar të dhëna të domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore<sup>19</sup>). Në lidhje me përgjimin parandalues ka rëndësi të mbahet parasysh se rezultatet që përftohen nga ky lloj përgjimi nuk mund të shërbejnë si burim prove në qoftë se nuk janë marrë

17 Këto parime të përgjimit gjenden të pasqyruara qartë në nenin 4 të ligjit "Për përgjimin e telekomunikimeve"

18 Shërbimi Informativ Shtetëror, është krijuar me Ligjin nr.8391, dt. 28.10.1998. Qëllimi i veprimtarisë së këtij organi (SHISH) është të sigurojë informacionin e domosdoshëm - nga zbulimi dhe kundërzbulimi – për problemet që lidhen me sigurimin kombëtar. SHISH ushtron veprimtarinë e vet duke përdorur menyra dhe mjete të ligjshme (neni 2). Një ndër to është dhe përgjimi. Shërbimi Informativ Ushtarak është krijuar me Ligjin nr. 9074, dt.29.05.2003. Qëllimi i këtij organi është të grumbullojë, analizojë dhe administrojë të dhëna për veprimtaritë, që çënojnë sigurinë kombëtare; kërcënimë të mundshme ose rreziqe ndaj Forcave të Armatosura, që vijnë nga jashtë, ose shfaqen brenda vendit, për t'i paraqitur tek autoritetet e drejtimit dhe të komandimit strategjik të Forcave të armatosura, për t'i mbështetur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre. (neni2). Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik (tani Ministria e Brendshme) është krijuar me ligjin nr. 8749, dt.01.03.2001. Objekti i veprimtarisë së këtij organi është parandalimi, zbulimi dhe dokumentimi i veprimtarisë kriminale që kryhet nga punonjësit e policisë së shtetit dhe të strukturave të tjera të kësaj Ministrie. Policia Kriminale është krijuar me Ligjin nr.8293, datë 26.2.1998 ka si qëllim që me anë të veprimtarisë së vet të realizojë në mënyrë të hapur ose të fshehtë mbrojtjen e jetës, shëndetit, pasurisë, të drejtat dhe liritë e njeriut, sigurinë sociale e shtetërore nga veprimtaria kriminale në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Konkretisht kjo ka për detyrë:

- zbulimin, parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale, evidentimin dhe kapjen e personave që kanë kryer, kryejnë ose përgatiten të kryejnë krime me dashje;
- gjurmimin policor për krimet e kryera me dashje;
- kërkimin e personave që u fshihen organeve të prokurorisë e gjykatës, që i shmangen dënimit penal ose që konsiderohen të humbur.

19 Idem, neni 6 i ligjit.

në respektim të dispozitave që parashikohen në seksionin IV të përgjimeve të KPrP (nenet 221-226).

### ***Kompetenca per autorizim dhe ankimi***

*Në kushte normale:*

- a) Për autorizimin e përgjimit, në kushte normale, ndiqet kjo procedurë:
- Prokurori i kërkon gjykatës autorizim për të kryer përgjimin
  - Gjykatësi, pasi verifikon ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuar me ligj dhe vlerëson kushtet dhe limitet e pranueshmërisë, autorizon me vendim të motivuar, kryerjen e përgjimit. Në vendimin e tij gjyqtari tregon mënyrën e kryerjes dhe kohëzgjatjen e veprimeve të përgjimit. Kjo nuk mund t'i kalojë 15 ditët. (neni 222/3) Gjykatësi, në vendimin për autorizimin e përgjimit të fshehtë, fotografik apo me video, ose për përgjimin e bisedave në vende private, mund të autorizojë oficerin e policisë gjyqësore, ose specialistin e kualifikuar për të hyrë në këto vende, - të karakterit privat – në mënyrë të fshehtë, duke vepruar, në përputhje me vendimin autorizues, brenda 15 ditëve. (neni 222/3 i KPrP)

Kunder vendimit që autorizon përgjimin mund të behet ankimi, - brenda 10 diteve – nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të përgjimit, kur verën shkeljet e kritereve të parashikuara në nenin 221. Ankimi shqyrtohet nga gjykata e apelit, e cila kur e gjen ankimin të drejtë, e shfuqizon aktin e përgjimit dhe urdheron fshirjen e çdo materiali të marre nga përgjimi. Të drejten për t'u ankuar e ka edhe prokurori, kur gjykata refuzon kërkesën për përgjim. (neni 222/a I KPrP).

- b) Kompetenca për autorizimin e përgjimit në fazën e hetimeve paraprake, në vende publike, për regjistrimin e numrave të telefonit, - hyrës dhe dalës -, si dhe për përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendondodhjes i përket prokurorit. (neni 222/1)



Edhe ndaj ketij vendimi i interesuari, që, ka ardhur në dijëni për shkeljet e kriterëve të parashikuara në nenin 221 i KPrP, ka të drejtë, - brenda 10 ditëve, - të ankohet tek Prokurori i Përgjithshëm ose në gjykatë. Këto të fundit, kur e gjejnë ankimin të drejtë, e shfuqizojnë aktin e përgjimit dhe urdhërojnë fshirjen e çdo materiali të marrë nga përgjimi. (neni 222/a i KPrP). Për kryerjen e përgjimit prokurori vepron vetë ose me anën e oficerit të policisë gjyqësore. (neni 222/4 I KPrP).

Për përgjimet që çenojnë direkt jetën private, intimitetin, banesën e personit, legjislatori ka parashikuar garanci të dyfishtë. Keshtu, vendimin e autorizimit për përgjim nuk e ka lënë në kompetencë vetëm të prokurorit, por vlerësimin dhe miratimin për këtë autorizim ia ka ngarkuar gjyqtarit, i cili vlerëson kërkesën e motivuar të prokurorit. Ndërsa për ato përgjime, që do të kryhen në vende publike, regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, si dhe perdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendodhjes, ku niveli i cënimit të së drejtës "privacy" është më i ulët, dhe për këtë arsye, legjislatori ka parashikuar si garanci vetëm vlerësimin e motivuar të prokurorit që e materializon në vendimin autorizues të tij.

### ***Procedura e shpejtë***

Kompetent për autorizimin e përgjimit në rastet e urgjencës është prokurori, kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund të dëmtohen hetimet. Prokurori që vendos përgjimin me akt të motivuar njofton gjykatën menjëherë, brenda 24 orëve. Ndërkaq gjykata, brenda 48 orëve nga marrja e vendimit të prokurorit bën vlerësimin me vendim të arsyetuar, në të kundërt, pra, nëse vlerësimi nuk bëhet brenda afatit të caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren. (neni 222/2 i KPrP) Pra, legjislatori i ka dhënë organit të akuzës, - prokurorit, në raste urgjence - fuqinë apo autoritetin e pushtetit gjyqësor, për një kategori përgjimesh, që ligji, në kushte normale, i

parashikon si kompetencë ekskluzive të autoritetit gjyqësor, pra, të gjykatësit. Prokurori përgatit materialin dhe formulon kërkesën për:

- për vlerësimin e vendimit të autorizimit të përgjimit, lëshuar nga vetë prokurori;
- lëshimin e vendimit autorizues nga gjyqtari për vazhdimin e përgjimit, në të njëjtën mënyrë e për atë kohë sa ka përcaktuar prokurori, por, gjithnjë brenda afatit ligjor.

Të gjitha aktet që urdhërojnë, autorizojnë, vlerësojnë ose zgjasin përgjimet, si dhe fillimi dhe mbarimi i çdo veprimi shënohen në regjistrin që mbahet në prokurori. (neni 222/5 I KPrP).

### ***Kërkesa për përgjim***

Kërkesa për përgjim duhet të hartohet në 2 kopje, një kopje mbahet në fashikullin e prokurorit dhe tjetra i dërgohet gjykatës. Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) emrin e prokurorit dhe prokurorin përkatës;
- b) gjeneralitetet dhe adresën e subjektit në proces përgjimi si dhe adresën e mjedisit/mjediseve me të cilat lidhet kërkesa për përgjim;
- c) përshkrimin e llojit dhe të natyrës së përgjimit;
- ç) arsyet e përgjimit, si dhe bazën dokumentare, ose materialin dyshues, ku mbështetet kërkesa për përgjim;
- d) argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera;
- dh) afatin kohor brenda të cilit do të bëhet përgjimi.

### ***Vendimi për përgjim***

Vendimi për përgjim, i cili jepet nga gjytari, në bazë të kërkesës së prokurorit, hartohet në 3 kopje dhe kur kemi të bëjmë me përgjime të telekomunikimeve një kopje e këtij

vendimi dërgohet pranë zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme, ku ndodhet bërthama komanduese elektronike, e cila lejon, ose ndalon, përgjimin e një pajisjeje telekomunikacioni.

Vendimi për përgjim përmban:

- lejen për kryerjen e përgjimit;
- prokurorin që ka bërë kërkesën;
- gjeneralitetet dhe adresën e subjektit në proces përgjimi dhe mjedisin/mjediset e identifikuara, që do të përgjohen;
- arsyet e autorizimit të përgjimit, si dhe baza dokumentare, ose materialin dyshues ku mbështetet autorizimi për përgjim;
- argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera;
- afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit;
- llojin dhe natyrën e përgjimit.

### ***Procesverbali i përgjimit***

Përgjimi fiksohet me anë të regjistrimit dhe të procesverbaleve të tij. Në procesverbal fiksohen, apo dokumentohen jo vetëm veprimet që kryhen gjatë përgjimit por edhe përmbajtja e transkriptimeve të bisedave dhe komunikimeve të përgjuara (neni 223/2 i KPrP).

Për hartimin e procesverbalit duhet të tregohet kujdes dhe në të përfshihen:

a) Në pjesën hyrëse:

- vendi, data dhe personi, oficeri i policisë gjyqësore dhe/ose specialisti që ka kryer transkriptimin;
- numri dhe data e vendimit që ka autorizuar përgjimin dhe baza ligjore e veprimit të fiksimit në procesverbal;
- ambienti ose telefoni stacionar (fiks) celular apo në rrjet, ose mjete i komunikimit i përgjuar;
- data, ora e fillimit dhe e ndërprerjes së përgjimit
- mënyra e kryerjes së regjistrimit të bisedave ose komunikimeve;

b) Në pjesën përshkruese:

- përmbajtja e bisedave që janë regjistruar, me detajimet e nevojshme që ndihmojnë për të kuptuar bisedën që është dëgjuar;
- bisedat e veçanta që janë përgjuar, duke respektuar rendin kronologjik, kohën e kryerjes së tyre dhe emërtimi i bobinave ku ato janë regjistruar;
- inicialet e personave - objekt përgjimi - dhe të bashkëbiseduesit, karakteristikat e dallueshme të zërit;
- biseda duhet të shkruhet siç është dëgjuar, - me difektet në shqiptim etj. - Kjo është shumë e rëndësishme dhe lidhet me saktësinë e transkriptimit.

c) Në pjesën e fundit:

- përshkrimi i emërtimeve të bobinave të regjistruara që u transkriptuan;
- ora e fillimit dhe e përfundimit të transkriptimit dhe nënshkrimi

Deri tani u trajtua në përgjithësi përmbajtja e neneve 221 dhe 222 të KPrP (kufijtë e lejimit dhe vendimin për lejimin e përgjimit). Përmbajtjet e neneve 223 – 226 të KPrP që kanë të bëjnë me veprimet e përgjimit, me ruajtjen e dokumentacionit, me përdorimin në procedime të tjera, si dhe me ndalimin e përdorimit të rezultateve të përgjimit, si pjesë e zinxhirit të procesit të përgjimit po i trajtoj më poshtë, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme dhe të komentuar jo vetëm përmbajtjen në tërësi të kreut III, seksioni IV “Përgjimet” por edhe shfaqje, probleme, mendime, interpretime, konkluzione e propozime, që kanë lindur ose mund të lindin në praktikën juridike.


***BIBLIOGRAFIA***

- Fjalor i gjuhës së sotme Shqipe, Tiranë, 1980.
- Ligji “Për përgjimin e telekomunikimeve” nr. 9157, datë 04.12.2003.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.





**Msc. Flutura SHABANI**  
*Kryetare e Këshillit të Etikës, Pedagoge*  
*Fakulteti i Drejtësisë*  
*KolegjiUniversitar ‘Wisdom’*  
e-mail: [flutura.shabani@wisdom.edu.al](mailto:flutura.shabani@wisdom.edu.al)  
[flutura.shabani@yahoo.com](mailto:flutura.shabani@yahoo.com)



## KOMPETENCA JURIDIKSIONALE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

## Abstract

Ky punim synon të hedhë dritë mbi Juridiksionin e Gjykatave shqiptare në rastet e marrëdhënieve juridike me element të huaj. Ne marrëdhënien juridike me element të huaj mund të lindin konflikte të cilat arrijnë përpara gjykatës ose arbitrazhit për tu zgjidhur. Duke e parë çështjen në këndvështrimin e realitetit të ri disiplinues që ka sjellë ligji Ndërkombëtar Privat Nr. 10428, dt. 02. 06. 2011, çështjet juridiksionale në konfliktet me element të huaj marrin një rëndësi domethënëse. Ligji i së drejtës ndërkombëtare Nr. 10 428, datë 02. 06. 2011 përcakton juridiksionin e gjykatave. Sipas rregullit të përgjithshëm ndërkombëtar gjykatat shqiptare janë kompetente të gjykojnë proceset civile në një marrëdhënie juridike me elementet të huaj në kushtet e parashikuara nga ligji shqiptar. Sipas ligjit gjykatat shqiptare janë kompetente të gjykojnë një konflikt me elemente të huaj por kjo lidhet me disa kushte sipas situatës që paraqet marrëdhënia juridike me elemente të huaj ose pikave të kontaktit me të cilat është lidhur kjo marrëdhënie. Një ndër kushtet thelbësore që parashikon si rregull të përgjithshëm ligji ndërkombëtar është që pala paditëse të ketë vendqëndrim të zakonshëm të personit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vendqëndrim të zakonshëm percaktuar në ligjin për të drejtën ndërkombëtare, kuptohet vendi, në të cilin personi ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë dhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij vendi gjykata merr parasysh rrethanat e natyrës personale apo profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend, apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla.

***Fjale kyçe:** Kompetencë, juridiksion, element i huaj, ligji ndërkombëtar, gjykatë, etj..*



## **Abstract**

This paper aims to shed light on the Jurisdiction of the Albanian Courts in cases of legal relations with foreign elements. In legal relations with a foreign element, conflicts may arise before the court or arbitration to be resolved. Looking at the issue from the point of view of the new disciplinary reality brought by the International Private Law No. 10428, dated 02.06.2011, jurisdictional issues in conflicts with foreign elements take on importante significance. The law of international law No.10 428, dated 2.6.2011 defines the jurisdiction of the courts. Under the general rule, the Albanian courts are competent to judge civil proceedings in a legal relationship with foreign items under the conditions provided by Albanian law. According to the law, the Albanian courts are competent to judge a dispute with foreign elements but this is related to certain conditions according to the situation that presents the legal relationship with foreign elements or contact points with which this relationship is connected. One of the essential conditions foreseen by international law is that the imputy party as a general rule of thumb has a habitual residence of the person in the territory of the Republic of Albania. An ordinary place of residence defined in the law on international law means the country in which the person has decided to stay for the most part of the time, even in the absence of registration and regardless of the permit or authorization to stay. In determining this, the court takes into account the circumstances of a personal or professional nature that show a lasting connection with this country or the person's intent to establish such links.

***Key words:** Competence, jurisdiction, foreign element, international law, court, etc.,*

## Hyrje

Kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private përcakton gjykatat e një shteti përballë një tjetri, që thirren për të zgjidhur konfliktin me elementë të huaj. Sa më lart duket sikur kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private përcaktohet në bazë të kompetencave materiael pra sipas natyrës së konfliktit. Normat e kompetencës material futen në kuadrin e normave imperative pasi kanë lidhje me mënyrën e organizimit të aktivitetit të organeve gjyqësore, ndërsa normat e kompetencës territoriale janë dispositive.

Kompetenca në të drejtën ndërkombëtare private e gjykatave rregullohet nga ligji 10428/2011 sipas neneve 71-79 të këtij ligji, gjykatat shqiptare janë kompetente të gjykojnë një konflikt me elemente të huaj nëse:

- a. i padituri ose njeri prej tyre e ka selinë, vendbanimin, pjesën më të madhe të kapitalit në Shqipëri, nëse i padituri i huaj nuk ka një adresë të njohur kërkesë-padia do të ngrihet në rrethin gjyqësor ku ka vendbanimin paditësi
- b. Selia e të paditurit person juridik ndodhet në Shqipëri; personi juridik ka vendbanimin në Shqipëri, në rastin e të cilit në territorin e shtetit një filial apo një degë e e përfaqëson.
- c. Paditesi i kërkesës për pension përkujdesjeje, ka vendbanimin në Shqipëri kërkesa për pension përkujdesjeje duhet të ketë karakter parësor.
- d. Vendi ku lindi ose ku duhej të ekzekutohej qoftë edhe pjesërisht një detyrim i lindur nga një kontratë ndodhet në Shqipëri; i huaji mund të jetë paditës ose i paditur nëse lidhja e kontratës ka efekt për Shqipeërinë apo ekzekutimi i saj duhet bërë në vend.
- e. Vendi ku ka ndodhur një fakt juridik, ngai cili lindin detyrimet jashtëkontraktore, ose efektet e tij konsumohen jashtë vendit, i huaji i cili ka kryer veprën ose është viktima e kësaj vepre mund të investojë gjykatën,

ose mund të thirret përpara gjykatave shqiptare. Nëse vendi i konsumimit të faktit është deti i hapur, atëherë aplikohen dispozita të veçanta (neni 80 i ligjit).

- f. Stacioni i trenit ose autobusit, si dhe porti ose aeroporti i ngarkimit, ose i shkarkimit të pasagjerëve, apo mallrave të transportuara, ndodhen në Shqipëri. Këto janë detyrime që rezultojnë nga kontrata e transportit të pasagjerëve apo të mallrave. Në këtë rast i huaji mund të jetë i paditur ose paditës.
- g. Sendi i siguruar ose sendi ku është prodhuar rreziku, ndodhet në Shqipëri, i huaji mund të jetë i paditur ose paditës.
- h. Vendbanimi i të vdekurit ose të mirat materiale, të lëna prej tij ndodhen në Shqipëri. Ligji mund të aplikohet nëse i huaji me banim në Shqipëri ka vdekur si dhe i huaji edhe nëse nuk është banues në Shqipëri, pjesën më të madhe të pasurisë së trashëgimisë e ka në territorin e Shqipërisë.
- i. Sendi i paluajtshëm për të cilin bëhet kërkesa, ndodhet në Shqipëri, i huaji mund të jetë paditës ose i paditur.

Mund të lindë pyetja nëse është fjala vetëm për aksionet reale për sende të paluajtshme, apo është fjala për veprimet personale për sendet e luajtshme, si psh veprimi me anë të të cilit i padituri të detyrohet të bëjë riparimet e duhura për një send të paluajtshëm ose të jetë i detyruar të paguajë një shumë (paditësi është uzufuktues i sendit të paluajtshëm, kurse i padituri është pronar i zhveshur, kurse veprimi është personal dhe i drejtuar një sendi të paluajtshëm. Redaktimi i ligjit është i ndryshëm nga ai i nenit 72 pika a, i cili i referohet proceseve në lidhje me "sendet e paluajtshme të ndodhura në Shqipëri". Në të drejtën e brendshme neni 45 pka 1, që i referohet kompetencës alternative, parashikon që gjykata kompetente është ajo ku ka vendndodhjen sendi, përveçse asaj ku ka vendbanimin i padituri, kjo përsa i përket marrëdhënieve që lindin për vendndodhjen e një sendi të paluajtshëm. Në

këto raste mund të pranohet edhe interpretimi i gjerë pasi nuk është fjala vetëm për veprimet reale mbi sendet e paluajtshme por edhe vendimet personale mbi pasuritë e paluajtshme.

Por sipas nenit 80 të ligjit 10428/2011, gjykatat shqiptare, janë kompetente të gjykojnë gjithashtu

- a. Proceset midis personave me vendbanim jashtë Shqipërisë por që lidhen me akte apo fakte të gjendjes civile të regjistruara në Shqipëri, nëse të paktën njëra nga palët është shtetas shqiptar. Është e mundur që palët të kenë vendbanimin në një vend tjetër të huaj, ose në dy vende të ndryshme.

Teksti jep zgjidhje që tashmë ishte dhënë në praktikë. Keshtu u konsiderua që një gjykatë shqiptare është kompetente të gjykojë një padi divorci midis bashkëshorteve të cilët kanë vendbanimin jashtë Shqipërisë, por të paktën kur njëri është shqiptar dhe e zgjedh vendbanimin procedural në lokalitetin ku ndodhet selia e gjykatës. Psh në dallim nga zgjedhja që mund të japin gjykatat shqiptare, kësaj shtate, sot një padi për anulimin e martesës kur të dy bashkëshortët kanë vendbanim jashtë Shqipërisë, por banojnë në të njëjtin vend, këto i japin kompetencë gjykatave shqiptare. Kërkohet plotësimi i kushtit që procesi të referohet akteve dhe fakteve të gjendjes civile të regjistruar në Shqipëri. Kur të paktën një nga palët të jetë me shtetësi shqiptare.

- b. Në proceset në lidhje me mbrojtjen e të miturit ose të personit nën kujdestari shtetas shqiptar me vendbanim jashtë vendit. Shtetësia shqiptare përcaktohet në përputhje me ligjin shqiptar. Ligji aplikohet edhe në rastin në të cilin i mituri ose personi nën kujdestari mund të ketë dy shtetësi, ku njëra është ajo shqiptare.
- c. Deklarimi i vdekjes se prezumuar të një shtetasi shqiptar edhe nëse ai ndodhet jashtë vendit në datën kur ka ndodhur zhdukja. Deri në marrjen e disa masave provizore nga gjykata shqiptare, mbeten të vlefshme masat provizore të marra nga gjykata e huaj. Përcaktimi

i shtetësisë bëhet në këtë rast në të njëjtat kushte që përcaktuam me lart.

- d. Proceset në lidhje me mbrojtjen jashtë vendit të pronësisë intelektuale, të një personi me vendbanim në Shqipëri, shtetas shqiptar ose i huaj ose apatrid, nëse me anë të marrëveshjes së palëve nuk është përcaktuar një kompetencë tjetër. Ligji ka parasysh të huajin pa shtetësi dhe jo atë me shtetësi të një shteti tjetër.
- e. Procese midis të huajve nëse ata kanë rënë dakort shprehimisht në këtë mënyrë ndërsa raportet juridike lidhen me të drejta që ata disponojnë, në lidhje me sende apo interesa të personave me shtetësi shqiptare. Pra procesi gjyqësor zhvillohet midis të huajve.

Gjykatat shqiptare janë kompetente nëse plotësohen kushtet e ligjit si më poshtë:

1. Të huajt kanë rënë dakort shprehimisht për këtë gjë
2. Të jetë fjala për të drejta që palët i disponojnë
3. Të ketë lidhje me sende apo interersa të individëve me shtetësi shqiptare.
- f. Proceset në lidhje me përkatësinë e disa anijeve ose avionëve, si dhe ato në lidhje me asistencën apo shpëtimin e disa personave, ose e disa sendeve në det të hapur, ose në një vend që nuk i nënshtrohet sovranitetit të një shteti nëse:
  1. Anija ose avioni kanë flamurin shqiptar
  2. Vendi i destinacionit porti ose aeroporti i preku anija ose avioni ka mbërritur gjendet në territorin shqiptar
  3. Anija ose avioni janë sekuestruar në Shqipëri
  4. I padituri ka vendbanimin apo vendqëndrimin në Shqipëri

Këto kushte nuk kërkohen që të plotësohen njëherësh, siç edhe rezulton nga argument me analogji i ligjit 10428/2011 i cili respektivisht shprehet se “ nëse ....’ Duke qenë e

qartë që këto kushte nuk është e nevojshme të plotësohen domosdoshmërisht.

- g. Falimentimi dhe çdo lloj procedurë tjetër juridike në lidhje me ndalimin e pagesave në rastin e një shoqërie tregtare të huajt me selinë në Shqipëri. Pra një person juridik ka selinë në një vend dje ka shetëtesinë shqiptare.
- h. Çdo lloj procesi tjetër i parashikuar nga ligji.

Me seli qëndrore në literaturën perëndimore kuptohet zyra e administrimit ose selia nga e cila drejtohet biznesi i shoqërisë. Në rastet e agjensive, filialeve dhe institucioneve të cilat lidhin kontrata, si vendqëndrim gjykohet vendi ku ato ndodhen dhe si pasojë gjykata e vendqëndrimit ushtron juridiksion në këtë rast. Pra në rastin kur dega e “Mangos” me seli në Tiranë lidh një kontratë shitjeje të mallrave që ajo prodhon e tregon me disa dyqane, atëherë gjykata e Tiranës është ajo që ushtron juridiksion në këto kontrata, ndërkohë që në përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm, momenti përkatës në kohë është koha e lidhjes së kontratës.

### **Juridiksioni ekskluziv i gjykatave shqiptare**

Juridiksioni ekskluziv është i rregulluar në nenin 72 të këtij ligjit 10428/2011 i cili përcakton Aktet e gjendjes civile të plotësuara në Shqipëri dhe të cilat i referohen personave me vendbanim në Shqipëri, shtetas shqiptar, shtetas të huaj ose apatridë. Ligji nuk aplikohet ndaj shtetasve të huaj edhe pse banojnë në Shqipëri. Akti i gjendjes civile kuptohet në kuptimin e instrumentit dhe duhet të ketë qenë i përpiluar në Shqipëri, dhe ti referohet një qytetari shqiptar ose apatridi me banim në Shqipëri. Dhënia e pëlqimit për birësim, nëse ai i cili do të birësohet ka vendbanimin në Shqipëri dhe është shtetas shqiptar ose i huaj dhe pa shtetësi; shtetasi i huaj edhe pse me vendbanim në Shqipëri, nuk i nënshtrohet këtyre dispozitave. Vendbanimi dhe shtetësia kualifikohen sipas ligjit shqiptar. Kujdestaria dhe bashkëkujdestaria në

lidhje me mbrojtjen e një individi me vendbanim në Shqipëri, shtetas shqiptar ose i huaj ose pa shtetësi, nëse është fjala për një person të mbrojtur me anë të kujdestarisë me vendbanim jashtë Shqipërisë aplikohet neni 79 i ligjit ku kompetenca nuk është ekskluzive, ligji nuk aplikohet ndaj shtetasit të huaj me vendbanim në Shqipëri, ose i cili nuk e ka vendbanimin në Shqipëri. Vendosja nën ndalim i një personi, apo heqja e zotësisë për të vepruar e një personi me banim në Shqipëri, përfitojnë nga këto dispozita ligjore.

- a. Zhbërja anullimi apo pavlefshmëria e martesës, si dhe konflikte të tjera midis bashkëshorteve, me përjashtim të sendeve të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit, nëse në ditën e ngritjes së padisë të dy bashkëshortet banojnë në Shqipëri, ndërsa njëri prej tyre është shtetas shqiptar ose i huaj ose pa shtetësi. Kërkohej pra plotësimi i disa kushteve.

Objekt i procesit i cili i referohet marrëdhënieve midis bashkëshorteve, por jo të gjitha;

Të dy bashkëshortët banojnë në Shqipëri në datën e ngritjes së kërkesës, pa u interesuar nëse njëri apo të dy bashkëshortët vazhdojnë të banojnë në Shqipëri. Një bashkëshort të jetë shqiptar ose i huaj pa shtetësi. Trashëgimia e lënë nga një person i cili vendbanimin e tij të fundit të ka pasur në Shqipëri; shtetas shqiptar, shtetas i huaj ose apatrid. Vendbanimi i fundit i të vdekurit duhet të jetë në Shqipëri ndërsa proceset gjyqësore të kenë lidhje me trashëgiminë. Është konsideruar që ishte fjala për një konflikt suksesorial, në lidhje me sendet e luajtshëm dhe konsiderohet që kërkesat e trashëgimtarëve apo kreditorëve të bëra pas kryerjes së ndarjes së pasurisë trashëgimore, i nënshtrohen rregullit *actor sequiturforum rei*. Rregulli duke ju aplikuar edhe në rastin në të cilin ekziston vetëm një trashëgimtar i vetëm. Në të drejtën e brendshme, padia për ndarjen gjyqësore është reale, duke qenë e mundur të marrë karakter miks kur mbi të vendosen edhe kërkesa të tjera incidente raporti ose zvogëlimi apo kërkesë të tjera

personale. Në të dyja rastet aplikohet rregulla për kompetencën territoriale, të parashikuara për paditë reale. Karakteri personal i padisë në këtë marrëdhënie është bazuar në praktikën gjyqësore. Po ashtu ka qenë e bazuar edhe në Rastin e padisë për pjestueshmëri në të drejtën ndërkombëtare private, aplikohet neni 80 i ligjit 10428/2011. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e: çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare; çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë; çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë. Pra, legjislatori shqiptar parashikon si kusht për zbatimin ekskluziv të juridiksionit të gjykatave shqiptare në çështjet e pronësisë, parimin e vendndodhjes së pronës, në çështjet tregtare, seline qëndrore të shoqërive tregtare dhe në çështjet e pronësisë intelektuale vendin e regjistrimit të këtyre të drejtave. Ky parim njihet ndryshe në literaturën e të drejtës ndërkombëtare private edhe si *parimi i territorialitetit*, që lidh vendndodhjen e objektit, shoqërisë tregtare dhe regjistrimin e të drejtës intelektuale me juridiksionin e gjykatës ku ndodhet objekti, selia ose është kryer regjistrimi. Në rastet e juridiksionit të caktuar me marrëveshje (neni 73), gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar, kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare. Këto marrëveshje duhet të vërtetohen me shkrim



dhe të jenë në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare, të cilat janë ose konsiderohen të njohura nga palët. Gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

### **Juridiksioni për martesën**

Në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me institutin e martesës (neni 75), gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën kur: *1. Njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar; 2. Bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; 3. Njëri nga bashkëshortët është pa shtetësi dhe ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.* Në praktikë, në rast se një shtetase shqiptare është e martuar me një shtetas austriak, atëherë, në çështjet martesore (paditë dhe pasojat, që lidhen me martesën për zgjidhjen dhe shpalljen e pavlefshmërisë së martesës, vërtetimin e lidhjes së martesës, si dhe ato që lidhen me regjimet pasurore martesore) gjykatat shqiptare kanë juridiksion, ashtu sikurse edhe në rastet e zgjidhjes së martesës, kur njëri nga bashkëshortët ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Shqipëri. Që të kuptojmë më qartë këtë nen, le të shqyrtojmë një vendim të gjykatës së lartë të Shqipërisë që ka të bëjë me zgjidhjen e martesës. Në këtë vendim bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, në një kohë kur nuk kishte hyre në fuqi ligji Nr. 10 428, datë 2.6.2011 Për të drejtën ndërkombëtare private. Në këtë vendim bëhet fjalë për këto të dhëna themeltare: *Martesa mes A. dhe Gj.F. është lidhur sipas ligjit shqiptar, më datë 20.10.1975, në Tiranë. Më pas ata kanë jetuar në Gjermani ku*

edhe janë bërë pronarë pasurie të paluajtshme atje. Me vendimin nr.8975, datë 23.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, kanë zgjidhur martesën. Në kuadrin e zgjidhjes së pasojave të martesës, paditësja A. ka kërkuar me padi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pjestimin e pasurisë së paluajtshme bashkëshortore që ndodhet në Republikën e

Shqipërisë. Ndërkohë edhe i padituri ka paraqitur një kundërpadi, me të cilën ka kërkuar pjestimin e pasurisë së paluajtshme që palët kanë në shtetin Gjerman. Kjo kundërpadi është pranuar për shqyrtim nga gjykata. *Por ka rezultuar se në seancën e datës 29.04.2009 Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë ka pushuar gjykimin e çështjes në lidhje me padinë, për shkak të mosparaqitjes së paditëses në seancë gjyqësore pa ndonjë shkak të arsyeshëm dhe ka vazhduar të gjykojë kundërpadinë.* Si një nga detyrimet e para ligjore, gjykata ka bërë verifikimin e kompetencës së saj për gjykimin e çështjes. Asaj i ka rezultuar se pasuritë që kërkohen të pjestohen nëpërmjet kundërpadisë janë apartamente banimi të ndodhura në shtetin Gjerman. Gjithashtu i ka rezultuar se midis palëve, në datën 15.12.2003 është bërë një marrëveshje e titulluar "kontratë martesore", ku për efektet ligjore pasurore të martesës, ata kanë zgjedhur të drejtën gjermane. Së fundi, i ka rezultuar se në kohë të mëvonshme nga kjo kontratë, paditësja e kundërpaditur A. F. është bërë shtetase gjermane. Nisur nga këto rrethana faktike dhe ballafaquar ato me ligjin procedural shqiptar (K.Pr.C.), gjykata ka arritur në konkluzionin se nuk është kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje. Gjykata arsyeton se sendet që kërkohet të pjestohen ndodhen në shtetin gjerman dhe sipas nenit 45 të K.Pr.Civile paditë për pjestimin e sendeve në bashkëpronësi ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen këto sende. Kjo është një kompetencë ekskluzive dhe ligji nuk lejon asnjë alternativë tjetër. Edhe në rast referimi të marrëveshjes së vitit 2003, sipas gjykatës, ajo nuk duhet marrë në konsideratë lidhur me çështjen që i përket gjykatës kompetente, pasi ligji shqiptar (neni 52 i K.Pr. Civile) e ndalon marrëveshjen për ndryshimin e kompetencës

tokësore për kategori çështjesh si kjo objekt gjykimi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se konkluzioni i arritur nga gjykata e rrethit është i drejtë, ndërkohë që arsyetimi I vendimit shihet me vend të ndryshohet si më vijon: Gjykata, edhe pse pranon faktin se një nga palët në gjykim (e paditura A.) është shtetase gjermane, e ka zgjidhur çështjen duke patur parasysht dispozitat e K.Pr.Civile që rregullojnë kompetencën në rastet kur mosmarrëveshja është midis shtetasve shqiptarë dhe çështja hyn në juridiksionin e gjykatave shqiptare, apo edhe kur një nga palët është I huaj dhe ka pranuar vetë këtë juridiksion. Ndërkohë që shtrirja e juridiksionit të gjykatës për të vendosur për një çështje, në rastin që ka të bëjë me elementë të huaj, është problem që i referohet të Drejtës Ndërkombëtare Private *Ligji shqiptar në këtë fushë në këtë kohë (2010) është ai me nr.3920, datë 21.11.1964 "Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj", i cili rregullon të drejtat e shtetasve, si dhe të personave juridikë të huaj në Republikën e Shqipërisë në të gjithë fushat, duke përfshirë dhe atë të marrëdhënieve pasurore, sikundër është çështja objekt gjykimi. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë hollësisht si problemet e ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe problemet e juridiksionit të gjykatave shqiptare kundrejt të huajve, duke i specifikuar ato dhe në kuadrin e ngushtë të marrëdhënieve personale e pasurore midis bashkëshortëve. Lidhur me ligjin e zbatueshëm, duhet thënë se si e drejta ndërkombëtare private në përgjithësi dhe e ajo shqiptare në veçanti, krijojnë hapësirë dhe u japin bashkëshortëve autonomi për të përcaktuar se cilit legjislacioni do t'i referohen për zgjidhjen e marrëdhënieve mes tyre. Sigurisht kjo autonomi nuk është e pakufizuar, pasi ajo lidhet me disa kritere si shtetësia e të dyve ose e njërit prej tyre, vendbanimi apo dhe vendndodhja e pasurisë. Këto elemente bazë janë edhe me ligjin ndërkombëtar të 2011 në fuqi, siç sqaruar më sipër. Këtë gjë kanë bërë dhe palët e këtij gjykimi me kontratën e titulluar "martesore" të vitit 2003, ku në nenin 1 të saj, të titulluar "zgjedhja e të drejtës", është përcaktuar se për efekt të pasurisë bashkëshortore palët kanë zgjedhur me efekt të menjëhershëm të **drejtën gjermane.***

Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e rrethit, kur e ka përmendur këtë fakt, e ka ngatërruar konceptin e të drejtës së zbatueshme (të drejtës gjermane) me atë të gjykatës që do të gjykojë çështjen (juridiksionin) dhe për rrjedhojë, ka pranuar se marrëveshja ka qenë për këtë të fundit. Kjo ka qenë arsyeja që në vendimin e saj ka përmendur nenin 52 të K.Pr.Civile, i cili nuk lejon ndryshimin me marrëveshje të gjykatës kompetente për rastet e pjestimit të pasurisë. Ndryshe nga autonomia e theksuar më lart, e drejta ndërkombëtare private nuk u ka lënë hapësirë palëve lidhur me problemin e përcaktimit të juridiksionit të gjykatës që do të gjykojë çështjen. Kjo ka arsyet e veta, pasi nëse një çështje nuk gjykohet nga gjykata që ka juridiksionin ta gjykojë, palët do të humbisnin një mjet të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërkohë që nëse gjykata gjykon një çështje që nuk i takon dhe që duhej të zgjidhej nga një gjykatë tjetër, sigurisht që çështja nuk është zgjidhur si duhet. Për arsyet e mësipërme, ligji nr 3920 i vitit 1964 i ka kushtuar një kapitull të veçantë problemit të juridiksionit të gjykatave shqiptare kundrejt të huajve. Ndërsa ka bërë disa rregullime të posaçme lidhur me çështjet për deklarimin e zhdukjes ose vdekjes së një personi, si dhe me zgjidhjet apo pavlefshmëritë e martesës, në nenin 30 ka rregulluar juridiksionin e përgjithshëm që i referohet të gjithë rasteve të tjera. Në këtë dispozitë parashikohet: *“Kur nuk janë rastet e parashikuara në nenet e mëparshme, shtetasi ose personi juridik i huaj mund të paditet para gjykatave shqiptare: Kur ka banim në Republikën e Shqipërisë, ose kur ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare, përveç kur padia ka të bëjë me sende të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit”*. Siç shihet, në këtë dispozitë, vetë ligjvënësi ka vendosur përjashtimin për paditë që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit. Edhe sikur vetë shtetasi i huaj të ketë pranuar gjykimin nga gjykata shqiptare, në raste të këtyre padive, shtetasi i huaj nuk mund të paditet para gjykatës shqiptare. Siç shpjegoam më lart, gjykata tashmë është duke gjykuar vetëm kundërpadinë, pra *padinë e paditësit Gj. kundër të paditurës A.*, që është shtetase e huaj, me të cilën kërkohet pjestimi i dy

apartamenteve të banimit të ndodhura në shtetin gjerman. Për rrjedhojë, në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata shqiptare nuk ka juridiksion për të gjykuar çështjen. Në rekursin e paraqitur, paditësi ka pretenduar juridiksionin e gjykatës shqiptare dhe për këtë i është referuar nenit 8 të ligjit nr.3920 të vitit 1964. Kjo dispozitë, në fakt, ka të bëjë jo me juridiksionin, por me të drejtën e zbatueshme, pasi parashikon: *"Marrëdhëniet personale dhe pasurore midis bashkëshortëve rregullohen nga legjislacioni i shtetit, shtetas të të cilit ata janë. Kur bashkëshortët nuk janë shtetas të të njëjtit shtet, dhe legjislacionet e shteteve të tyre janë të ndryshme, këto marrëdhënie rregullohen nga legjislacioni shqiptar"*. I pabazuar është edhe pretendimi tjetër se e paditura ka dhënë vetë pëlqimin për t'u paraqitur para gjykatës shqiptare, pasi edhe për zgjidhjen e martesës është zbatuar ligji shqiptar dhe është zgjedhur gjykata shqiptare. Kjo, pasi juridiksioni i gjykatave shqiptare për zgjidhjen e martesës në ligjin e mësipërm ka një rregullim specifik të ndryshëm nga ai për çështjen objekt gjykimi.

Së fundi, i pabazuar është edhe referimi i paditësit në të drejtën ndërkombëtare private gjermane, sipas të cilës *rregullimi i marrëdhënieve që rrjedhin nga pasuria bashkëshortore e martesës i nënshtrohet të drejtës së zbatuar për pasojat e përgjithshme të martesës në rastin e lidhjes së martesës*. Edhe ky parashikim ka të bëjë me të drejtën materiale të zbatueshme në rastin e këtyre konflikteve dhe jo me juridiksionin e gjykatës për t'i shqyrtuar ato. Nga sa më sipër, duke qenë se përfundimi i gjykatës së rrethit ka vendosur të shpallë moskompetencën e saj në gjykimin e çështjes civile me nr. 3733 akti, date 24.11.2008, pasi kompetente është gjykata ku ndodhet pasuria bashkëshortore. Kolegji Civil nuk e sheh me vend ta cënojë vendimin, por të plotësojë arsyetimin me sa u thane më lart.

## **Përfundime**

Nëse e rishikojmë vendimin e mësipërm sipas ligjit Nr.10 428, date 2.6.2011 *"Për të drejtën ndërkombëtare private"*,

atëherë duhet parë rregullimi i regjimit pasuror martesor në nenin 24 i cili përcakton se: Regjimi pasuror martesor përcaktohet nga ligji i shtetit, që rregullon marrëdhëniet personale të bashkëshortëve. Ndryshimi i regjimit pasuror nuk prek të drejtat e fituara më parë nga bashkëshortët. Ashtu sikurse nga ana tjetër bashkëshortët, në marrëveshje midis tyre, të bërë me akt noterial apo me akt tjetër të barasvlershëm dhe të lëshuar nga një organ publik, mund të vendosin që për regjimin pasuror martesor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, të zbatohet ligji i shtetit: a) *Shtetësinë e të cilit ka njëri nga bashkëshortët;* b) *Në të cilin ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm njëri nga bashkëshortët;* c) *Në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme.* Kjo dispozitë ligjore, ka të bëjë jo me juridiksionin por me të drejtën e zbatueshme dhe në vendimin tonë, është e qartë që e drejta e zbatueshme është ajo gjermane. Edhe neni 23 për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve i cili përcakton se: Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve rregullohen nga ligji i shtetësisë së përbashkët; nëse bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zbatohet ligji i shtetit, në të cilin ata kanë vendqëndrimin e përbashkët, përcakton të drejtën e zbatueshme dhe jo juridiksionin e gjykatës, ndërsa përsa i përket juridiksionit, ndërkohë që ligji nr. 3920 të vitit 1964 në nenin 30 të tij e kishte zgjidhur çështjen duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në rastet e *padive që kanë të bëjnë me sende të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit, ligji ndërkombëtar i 2011 nuk e ka përjashtuar këtë gjë, por në nenin 75 pika 2 të tij ka përcaktuar se gjykata shqiptare ka juridiksion kur bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, në rastin që Gj. F. ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Shqipëri, atëherë gjykata shqiptare ka juridiksion dhe duhet të shqyrtojë çështjen për regjimin pasuror martesor në bazë të ligjit gjerman.*

**LITERATURA:**

- Qoku, M. (2016) “*E drejta ndërkombëtare private*”. Tiranë
- Papajorgji, E. (2016). “*E drejta e konkurrencës – Praktikë dhe jurisprudencë ndërkombëtare*”. Tiranë.
- Papajorgji, E. (2015). “*Privatizimi në Shqipëri – Nga e drejta tek ekonomia*”. Tiranë.
- Papajorgji, E. (2014). “*E drejta ndërkombëtare dhe shqiptare e konkurrencës*”. Tiranë.
- Papajorgji, E. (2013). “*Privatisierung von Unternehmen in Albanien und Mazedonien im Rechtsvergleich*”. Saarbrücken.
- Papajorgji, E. (2013). “*E drejta ndërkombëtare private*”. Tiranë.
- Papajorgji, E. (2013). “*E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit*”. Tiranë.
- Papajorgji, E. (2012). “*E drejta europiane private*”. Tiranë.
- Streinz, R (2010). “*Europarecht*”.
- Vendim i Gjykatës së Lartë Nr. 61 i datës 9.2.2010.







**Dr. Valbona SOFTA**

*Përgjegjëse, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe MJ, Pedagoge  
Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore  
Kolegji Universitar “Wisdom”*

email: [valbonasofta@gmail.com](mailto:valbonasofta@gmail.com)

[valbona.softa@wisdom.edu.al](mailto:valbona.softa@wisdom.edu.al)



## **PROGRAMI I GJUHËS ANGLEZE NË FOKUSIN E INTERESIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETET PUBLIKE**

**Abstrakt**

Mësimi i gjuhës angleze shihet sot si një domosdoshmëri e kohës në vendin tonë, kryesisht në fushën e edukimit dhe më specifikisht në studimet universitare dhe pasuniversitare për të thelluar njohuritë profesionale dhe shkencore. Evidencat e praktikës individuale në mësimdhënie, të cilat janë të prekshme nga afër, tregojnë një tablo, ku përgjithësisht, studentët e vitit të parë të regjistruar në sistemin e Arsimit të Lartë, rezultojnë të kenë fokus interesi më të lartë në lëndët profesionale se në mësimin e gjuhës angleze, pavarësisht domosdoshmërisë së njohjes së huaj në nivel të avancuar. Ky studim synon të studiojë interesin e studentëve në kursin e gjuhës angleze në universitetet publike, ku rast studimor do të jetë programi Master në Mësuesi për Arsimin e Mesëm dhe të Lartë. Studimi u iniciua nëpërmjet metodave të kërkimit Cilësor, bazuar në indikatorët dhe metodat kualitative. Studimi u krye për një periudhë gjashtë mujore dhe kishte si bazë zgjedhjeje kampionin e marrë nga studentët e vitit të parë. Qëllimi i zgjedhjes së këtij kampioni është se studentët e këtij viti studimor akademik rezultuan në fund të semestrit të parë me nivelin më të ulët të interesit për gjuhën angleze në universitet, sipas vëzhgimeve të kryera. Numri i kampionit që u përzgjedh është i përbërë prej 30 studentësh, dhe teknika e përdorur ishte selektimi rastësor. Studimi u krye në varësi të metodave të: shqyrtimit të literaturës, pyetësorëve të pastandartizuar dhe vëzhgimit pjesmarrës.

***Fjalë Kyçe:** Mësimi i gjuhës angleze, selektimi rastësor i kampionit, studentët e vitit të parë, interesi në gjuhën e huaj.*

**Abstract**

English language learning is considered nowadays as a necessity in Albania, mainly in education field and especially in undergraduate and postgraduate studies to deepen

professional and scientific knowledge. The evidence of individual teaching practice, which is closely tangible, shows a picture, where, generally, first-year students in the higher education system tend to have decreased interest in learning English, regardless the obligation for language competence at advanced level. This study aims to study the interest of students in English language teaching in public universities, where the case study will be the Faculty of Natural Sciences, the Master Program in Teaching for Higher and Secondary Education. The study was initiated through quality research methods, based on indicators and qualitative methods. The study was conducted for a period of six months and was based on the sample selection of first-year students. The aim of this sample selection is that the students of this academic year of study resulted in the end of the first semester with the lowest level of interest in the English language at the university, according to the observations made. The sample number was made up of 30 students, and the technique used was random selection. The study was conducted depending on the methods of: reviewing literature, non-standardized questionnaires and participant observation.

**Key words:** *English language learning, random selection sample, first year students, Students` Interest in English.*

## Hyrje

Duke iu referuar rëndësisë së gjuhës angleze në nivel kombëtar dhe reformave mbi kurrikulat universitare, theksohet se gjuha angleze si gjuhë e huaj është përfshirë në Planet mësimore të Ciklit të dytë të studimeve që nga viti akademik 2015-2016 e deri më tani. Ndërkohë që universitetet jo publike e kanë vendosur lëndën e gjuhës angleze në programin e Masterit të Shkencave përpara këtyre kufijve kohorë. Në pozicionin e mësimdhënësit të gjuhës angleze, të mësuarit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj shihet si një proces në vazhdimësi dhe si i

tillë, duhet vëzhguar në mënyrë të qëndrueshme. Ky studim u iniciua nga përshtypja se studentët në vitin e parë të studimeve të larta shfaqin mungesë interesi në lidhje me të mësuarën e kësaj gjuhe. Kjo dukuri përsëritet vit pas viti dhe kërkohet pjesëmarrje më aktive e studentëve në mësim, frekuentim i rregullt i lëndës, nxitje e interesit për metodën e zgjedhur të gjuhës së huaj, të cilat të marra së bashku ftojnë për njohuri më të zgjeruara dhe rrjedhimisht, do të krijojnë kushtet që studentët të kenë në rezultate më të larta në lëndën e gjuhës angleze dhe interesi për gjuhën e huaj t`u përafrohej me lëndët profesionale. Ajo që befason më së shumti në këtë diskutim është se rënia e interesit vazhdon, megjithëse aktualisht jemi përballë reformave të mëdha në lidhje me gjuhën angleze, ku përmenden provimi me detyrim i gjuhës angleze në Maturën Shtetërore dhe mbrojtja në nivel ndërkombëtar e kësaj gjuhe, si një ndër pesë e gjuhët e miratuara nga MAS, si kusht në pranimet për Ciklin e Dytë dhe të Tretë të studimeve, Master i Shkencave dhe Doktoraturë. Për të qartësuar më shumë fokusin e këtij studimi, do të paraqitet paradigma e fjalëve kyçe të tij:

- Student i vitit të parë
- Interesat e studentëve
- Gjuha angleze në universitet

### *Etimologjia e Fjalës 'Student'*

Sipas fjalorit etimologjik fjala student e ka prejardhjen nga fundi i shekullit 14, në frëngjishten e Vjetër njihet si 'estudiant', pra dikush që studion' dhe nga Latinishtja e Mesjetës, studiare 'të studiosh' dhe nga Latinishtja 'studium' ([www.etymonline.com/index.php?term=student](http://www.etymonline.com/index.php?term=student))

- Studenti tipik i vitit të parë është një 19 ose 20-vjeçar që sapo ka përfunduar studimet e shkollës së mesme dhe ka fituar të drejtën për të ndjekur studimet e larta në degë të ndryshme universitare.
- Studenti si objekt studimi (mund të eksperimentohet me studentin, siç është rasti i plotësimit të pyetësorëve

në kushte jo transparente, për efekt pilotimi, gjë që e bën imponues rolin e pedagogut dhe objektifikon vetë studentin ose aplikimi i metodave të reja studimore.)

- Studenti i papërfshirë në politikëbërje, kemi parasysht këtu mungesën e komunikimit me studentët dhe ftesës nëpër departamente për të marrë në konsideratë edhe zërin dhe nevojat e tyre.
- Studenti dhe problemet e tij sociale. Formimi i identitetit të studentit mund të shoqërohet me probleme të rënda qoftë fizike dhe psikologjike, psh. krizë identiteti, abuzimi me alkolin ose drogën, çrregullimet e të ngrënit, marrja e risqve deri në ekstremitet, kushtet ekonomike etj.
- Studenti dhe qëndrimi dhe sjellja gjinore e tij. Kalimi nga stadi i adoleshencës në adult sjell një drejtim ndaj zbulimit të vetëvetes dhe mund të shërbejë si periudhë eksplorimi për të.

### *Etimogjia e fjalës 'Interes'*

Në fillimet e shekullit të 15 -të, fjala *interesse*, nga burimet Anglo-Frankofone, do të thotë 'çfarë dikush ka si preokupim ligjor'; në latinishten e Mesjetës *interesse* "kompesim për humbje", nga latinishtja "të paraqesë preokupim ose shqetësim"; "të bësh ndryshim". Në vitet 1520 kuptimi i fjalës *interes* kishte kuptim financiar "para në shkëmbim të parave të dhëna hua".

Në këtë studim interesi i studentëve për gjuhën do të shprehet sa më poshtë:

- Interesat studentore si një faktor fluid për t'u studiuar pasi interesat janë në varësi të grupmohave dhe backgroundit që studentët kanë.
- Interesat studentore dhe vështirësia e përçimit të tyre në Senatin e universitetit.
- Marrëdhëniet pedagog-student, ç'ka vihet re në marjen në konsideratë ose jo, të nevojave të tyre gjuhësore në

funksion të profileve të studimeve.

- Mospërputhja e politikave të mëdha për gjuhën e huaj me praktikën e përditshme të gjuhës së huaj në universitete.

Termi gjuhë e huaj:

- Mënyrat dhe strategjitë e të mësuarit të gjuhës së huaj nga studentët e vitit të parë.
- Teoria bihejvioriste e të mësuarit të gjuhës së huaj.
- Teoria konjitive e të mësuarit të gjuhës së huaj.

### ***Këndvështrimi teorik***

Për realizimin e këtij studimi u shqyrtua literatura në lidhje me konceptet e paraqitura në temën e studimit, dhe u identifikuan raste të reja lidhur me çështjen, ku me anë të metodës “juxtaposicion”, pra “përqsasje” do të bëhet “bashkangjitje” e gjetjeve. Studimet në lidhje me interesin në mësimin e gjuhë angleze tregojnë se “Pedagogët duhet të rrisin interesin e studentëve duke planifikuar plotësisht dhe qëllimisht programet me objektivin për të transformuar nevojat e familjes, shoqërisë dhe shkollës në interesa të brendshme të vetë studentëve.” (Zhang Guoliang).

Shumë teoricienë dhe kërkues kanë zbuluar se është e rëndësishme të njohim ndërtimin e interesit dhe motivimit të studentëve për të mësuar gjuhën e huaj, jo si një njësi e vetme, por si një njësi e përbërë prej shumë faktorësh. Oxford dhe Shearin (2004) analizuan një total prej 12 teorish dhe modelesh motivimi. Është e rëndësishme të përmendim këtu pesë fazat e zhvillimit konjitiv sipas Warner Schaie.

1. Faza e të nxënit,  
Çfarë kam nevojë të di, (nga fëmijëria deri në adoleshencë)
2. Faza e arritjeve, si duhet të përdor atë që di. (integrimi i shprehive të fituara në kuadrin praktik)
3. Faza e Përgjegjshmërisë: Pse duhet të di (hulumtimi i kuptimit dhe qëllimit me kulmin në moshën adulte)

4. Faza e veprimit, deri në moshën e mesme
5. Faza e ri integritit, moshë e tretë
  - Studimet universitare përkojnë me një periudhë zbulimi intelektual si dhe rritje personale. Për studentët e moshës tipike, që do të thotë nga 18 deri në 22 vjeç të cilët kalojnë nga adoleshenca në adultë, universiteti ofron një mundësi për t'i gjetur përgjigje hamendësimeve që vijnë nga fëmijëria, duke sjellë për pasojë mbrujtjen e një identiteti adult. Piaget besonte se adoleshentët dhe të rriturit mendonin në të njëjtën mënyrë, por Keating beson se kjo grupmoshë nuk e ka të konsoliduar të menduarit operacional, tipar që zhvillohet në periudhën e pjekurisë moshore.
  - Pyetja mbi formimin e identitetit adult shoqërohet me probleme të rënda qoftë fizike dhe psikologjike, psh. krizë identiteti, abuzimi me alkolin ose drogën, çrregullimet e të ngrënit, marja e risqve deri në ekstremitet. Sidoqoftë për shumicën kjo periudhë stimulon një zhvillim të shëndetshëm. Ajo sjell një drejtim ndaj zbulimit të vetëvetes dhe mund të shërbejë si periudhë eksplorimi i zgjedhjeve të reja dhe më realiste të karrierës.
  - Sfidat akademike dhe sociale gjatë jetës në universitet shpesh çojnë në rritje intelektuale dhe morale. Në një studim të vitit 2000 nga William Perry, i cili intervistoi 67 studentë të Harvardit dhe te universitetit Radcliffe para diplomimit, zbuloi se të menduarit e tyre përparoi nga faza e ngurtësimit deri në fleksibilitet dhe si përfundim arritën në angazhime studimore me zgjidhje të lirë.
  - Studentët ndryshojnë në përgjigje të sjelljeve të studentëve të tjerë të cilët sfidojnë këndvështrimet dhe vlerat e hershme, reagojnë ndaj kulturës së vetë studentëve e cila në vetvete është e ndryshme nga kultura e shoqërisë në tërësi, reagojnë ndaj

kurrikulës, e cila sjell pikëpamje dhe mënyra të reja të menduarit, dhe e fundit por jo më pak e rëndësishmja marëdhënia me personelin akademik, i cili shpesh i objektifikon studentët dhe krijon modele të reja që jo gjithnjë rezultojnë të suksesshme.

- Teoria bihejvioristë është një nga modelet e përdorura rëndom nga studentët në të mësuarin e gjuhës së huaj. Teoria psikologjike e viteve 50-60` është teoria bihejvioriste e të mësuarit. Sipas kësaj teorie mësimi i gjuhës së huaj është si çdo lloj mësimi në sensin që përfshin krijimin e shprehive në formë instiktive. Shprehitë formohen teorikisht kur studentët i përgjigjen stimulit në mjedisin rrethues dhe për pasojë përforcojnë përgjigjet e tyre në mënyrë që t'u kujohen. Kështu një shprehje është një lidhje stimul-përgjigje.
- Kjo metodë është një teori psikologjike që gjen shprehje veçanërisht në metodën Audio-linguistike të të mësuarit të gjuhës së huaj, e përdorur veçanërisht në Amerikë, por rrallë në vendin tonë.

## METODOLOGJIA

### *Shqyrtimi i Literaturës*

Liria akademike sjell forma të ndryshme të aplikimit të metodave të mësimit të gjuhës së huaj, si për shembull, pedagogu është i pavarur për zgjedhjen e tekstit, rasti i Universitetit të Tiranës, ose totalisht i diktuar nga departamenti ku është i angazhuar për zgjedhjen e tekstit (Universiteti i Durrësit, UAMD). Megjithëse janë bërë përpjekje për të ruajtur koherencën e nivelit të teksteve të aplikueshme në universitet, krahasuar me nivelin B1-B2 të gjuhës së huaj të mësuar në shkollën e mesme, sipas Portofolit të Gjuhëve të Huaja, studentët ndeshen ose me përsëritje njohurish, çka nuk zgjon interes tek studentët, si për shembull, metoda që janë zhvilluar në shkollat e mesme dhe transmetojnë vetëm njohuri



të përgjithshme, ose niveli gjuhësor i teksteve në universitet rezultojnë të jetë i lartë, C1 sipas Kuadrit të përbashkët Evropian të Gjuhëve, (KPERGJ). Kjo vërehet kryesisht në metodat e anglishtes për qëllime specifike, English for Specific Purposes, (ESP), gjë që ndikon tek interesi i studentit, për shkak të mos përputhjes së nivelit të gjuhës, ku dallohen mangësi tek mësimi i gjuhës angleze në shkollat e mesme. Zhvillimi i shprehive të punës në grup si faktor rrisi ndryshe nga metodat tradicionale, gjë që shkon në analogji me ritmet e zhvillimeve aktuale ( fq. 172, V. Tafani), teori psikologjike që gjejnë shprehje vecanërisht në metodën Audio-linguistike të të mësuarit të gjuhës së huaj, e përdorur veçanërisht në Amerikë, por rrallë në vendin tonë.

### INSTRUMENTAT

Mbështetur në literaturën e mësipërme dhe natyrën e studimit, u pilotua një pyetësor gjysëm i strukturuar në një kampion prej 30 studentësh të vitit të parë, në IAL-të publike, ku teknika e përdorur ishte selektimi rastësor. Përmbajtja e pyetësorit testonte interesin e këtyre studentëve në lëndën e gjuhës angleze, prirjen e tyre për të studiuar këtë gjuhë në universitetet publike, diferencën e nivelit të gjuhës nga programi i gjuhës së huaj në shkollë të mesme krahasuar me të njëjtin program në shkollën e lartë, bashkëpunimi mes pedagogut dhe studentit në realizimin e programit, me orientim zbulimin e nevojave për gjuhën e huaj, dhe objektivi i rolit të studentit. Pyetësori përmbante 30 kërkesa me përgjigje shteruese Po/Jo dhe kërkesa jo- shteruese. Pasi u morën përgjigjet, u regjistruan në skeda dhe më pas u interpretuan me anë të analizës cilësore së të dhënave.

### PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si përfundim, nga ky studim rezultoi në fund të aplikimit të pyetësorit gjysëm të strukturuar se metodat mësimore duhet të përshtaten me nevojat gjuhësore dhe profesionale të

studentit ku të arrihet: ngritja e nivelit të gjuhës si standart parapërgatitor për realizimin e provimit ndërkombëtar të anglishtes si detyrim për pranimet në Programin e Studimeve Master i Shkencave; përdorimi i gjuhës angleze për qëllime specifike, English for Specific Purposes në funksion të formimit profesional të studentit, siç janë materialet autentike të gjuhës angleze në fushën përkatëse të studimit; orientimi i gjuhës së huaj në universitete, konkretisht, në fushën e drejtësisë, duhet të jetë si për shembull: si të shkruajnë një letër padi, një prokurë, anikimim në gjuhën angleze; në Shkencat Sociale si të ndërtojmë një pyetësor, intervistë të strukturuar ose test të standartizuar në gjuhën angleze. Gjithashtu, sipas rezultateve të këtij studimi, gjuha e huaj angleze shërben për nxitjen e metodave kërkimore në fushën e tyre të studimit, por mangësitë relative në kapacitetet logjistike, pedagogjike, fizike në IAL-të publike, për trajtimin në mënyrë të diferencuar të grupeve me përparësi në gjuhën e huaj, shkaktojnë formim gjuhësor jo homogjen, fenomen që është i ndryshëm në IAL-të jopublike, ku këto grupe trajtohen në formë të diferencuar, si dhe punohet me module, ku në Semestrin e parë zhvillohet praktika e gjuhës Angleze të Përgjithshme dhe në Semestrin e dytë, aplikohet gjuha angleze për qëllime specifike (English for Specific Purposes, ESP), një metodë që rekomandohet të ndiqet edhe në IAL-të publike. Mungesa e buxheteve për sigurimin e faciliteteve elektronike për zhvillimin e gjuhës angleze, hapësirat e kufizuara të auditoreve, në formën e laboratoreve, si dhe fasiliteteve, ku përmenden mjetet audiovizive për mësimin e gjuhës angleze, janë evidentuar nga studentët e universiteteve publike. Mirë menaxhimi i zgjedhjes së teksteve të gjuhës angleze në përshtatje me nevojat studimore në universitete, English for specific purposes, ESP, do të rriste interesin dhe motivimin e studentëve në mësimin e gjuhës angleze.

**BIBLIOGRAFI**

- Alcala, F. R. (2002). Making oral tests more human and less anxiety generating.
- *Humanising Language Teaching*, 4 (4): 1 – 3.
- Young, D. J. (1999). Affect in foreign language and second language learning.
- Boston, MA: McGraw-Hill.
- Papalia, E. D, Olds. W. S. (1998). Human development. Fifth edition, 381
- Littlewood, W. (1992). *Teaching Oral Communication: A Methodological Framework*.Oxford: Blackwell.
- Lorents, A., Morgan, J., & Tallman, G. (2003). The impact of course integration on Student grades. *Journal of Education for Business*, 78(3), 135-138 *Linguistics*,24:26-43 Mc Graw-Hil. .
- Mitchell, J. T. & Redmond. M. L. (1993).Rethinking Grammar and Communication.
- *Foreign Language Annals*, 26, 13-19.
- Murphy, J. (1991). Oral Communication in TESOL: Integrating Speaking, Listening, and Pronunciation. *TESOL QUARTERLY*, Vol. 25, No. 1,
- Schmidt, R. (1993); Awareness and second language acquisition; *Annual Review of Applied Linguistics*, 13,206-226.
- Sysoyer, V. (1999).Integrative L2 grammar teaching: exploration, *explanation and expression*. *The Internet TESL Journal* .vol.v, no.6.
- European Languages Portofolio Huchiston T. And A. Waters.1987 *English for Specific purpose*; A learning-centred approach Cambrige
- Holmes,John1983 The teaching of language items in ESP, In *Working papers number 8* Sao Paulo CEPRIL-PUC
- TEXTBOOK EVALUATION RUBRICd (Cheryl Beth Cheifetz B.S.,) Indiana University1992, Educational Psychology 474: Evaluating Learning Technologies Dr. Cheryl Bullock University of Illinois, Urbana-Champaign December 10, 2004
- Psychologist Today, Vol. III, 1999; f.170
- [www.etymonline.com/index.php](http://www.etymonline.com/index.php)





**Dokt. Meri KRAJA**  
*Pedagoge*  
*Fakulteti i Drejtësisë*  
*Kolegji Universitar “Wisdom”*  
e-mail: meri.kraja@wisdom.edu.al



**Msc. Flavia KOLLESHI**  
*Pedagoge*  
*Fakulteti i Drejtësisë*  
*Kolegji Universitar “Wisdom”*,  
e-mail: flavia.kenaj@wisdom.edu.al



## **PSE SHQIPTARËT SHPËTUAN HEBRENJT?**

## Abstrakt

Përgjatë një prej periudhave dhe kapitujve më të erët të historisë botërore ku me mijëra hebrenj, njerëz me bindje komuniste, minoritete raciale po endeshin kryq e tërthorë Europës, shumë shqiptarë filluan një betejë të vertetë në mbrojtje të personave krejtësisht të panjohur për ta. Ata rrezikuan jetën e tyre për të strehuar familjet hebreje të larguara prej akupimit italian dhe më vonë atij gjerman, dhe gjate këtij të fundit përfshihet edhe periudha e Holokaustit. Shumë shqiptarë i strehuan hebrenjt në shtëpitë e tyre, pavarësisht rreziqeve dhe kostos, i trajtuan si miqtë e tyre si anëtarë të familjes për t'i shpëtuar ata. Në thelb të kësaj përpjekjeje ishte një koncept i quajtur "Besa", një kod i nderit shqiptar që mbart në vetvete betimin e një personi si të shenjtë. Arsyeja kryesore për shpëtimin e hebrenjve nga shqiptarët ishte historia e tyre e tolerancës fetare bazuar në "kanunin" dhe në kodin e tij moral. Kanuni" ka qenë një faktor qendror për mbijetesën shqiptare përballë qindra viteve të pushtimit. Si i tillë, ai është një formë e kujtesës kolektive, identitetit kulturor dhe rezistencës madje disa prej zakoneve të përshkruara në Kanun besohet se ekzistojnë dhe e kanë origjinën qysh prej antikitetit. Ato u transmetuan gojarisht dhe u trashëguan brez pas brezi edhe me mbështetjen e padiskutueshme të shumë autorëve. Ky artikull shqyrton konceptin e Besës, (dhe jo vetëm), e cila në mënyrë të pandashme lidhet me nderin personal, respektin dhe barazinë me të tjerët si elemente që përbëjnë themelin e Kanunit. Besa ka kuptime të shumëfishta, duke filluar nga besimi, besimi i pacenueshëm, paqja dhe fjala e nderit e dhënë si një premtim i shenjtë dhe detyrim për të mbajtur fjalën për të siguruar mikpritjen dhe mbrojtjen. Ajo përfshin mbrojtjen e pakushtëzuar të një mysafiri, madje deri në pikën e sakrifikimit të jetës së tyre. Ndërkohë që duhet të theksojmë se ne nuk do të flasim mbi konceptin modern perëndimor i "të huajit" pasi nuk ekziston në Kanun por vetëm mbi konceptin e mysafirit. Çështja kryesore për analizën tonë është: arsyeja pse shqiptarët i shpëtuan hebrenjtë? Përfundimisht, në zemër

të kanunit është vetëqeverisja demokratike; qeveria e vetme që ajo njeh.

*Fjalë Kyçe: Kanun, hebre, Besa, mikpritja, mbrojtja.*

## **Abstract**

During one of humanity's darkest chapters, when millions of Jews, gays, communists and racial minorities were rounded up across Europe, many Albanians put up a fight to save complete strangers. They risked their lives to shelter displaced Jewish families under Italian and later German, occupation during the Holocaust. Many Albanians took refugees into their homes despite the risks and the cost, treated their guests off as family members to keep them safe. At the core of this effort was a concept called "Besa", an Albanian code of honor that holds a person's oath as sacred. The principal reason for Albanians saving Jews was their history of religious tolerance based on the "Kanun" and its underlying moral code. The "Kanun" has been central to Albanian survival in the face of hundreds of years of occupation. As such, it is a form of collective memory, cultural identity, and resistance. Some of the customs described in the Kanun are believed they existed since anticity. They were transmitted orally and handed down from generation to generation, with input from a variety of authors. This paper explores the concept of Besa, and not only, which inextricably links personal honor and respect for and equality with others is the foundation of the Kanun. Besa has multiple meanings, ranging from faith, inviolable trust, truce, and word of honor to a sacred promise and obligation to keep one's word to provide hospitality and protection. It involves uncompromising protection of a guest, even to the point of forfeiting one's own life. The modern Western concept of "foreigner" does not exist in the Kanun, only the concept of the guest. The central question to our analysis is: the reason why Albanians saving Jews? Eventually, at the

heart of the Kanun is the Democratic self-Government; the only government that it recognizes.

**Keywords:** *Kanun, jews, besa, hospitality, protection, etc.,.*

## HYRJJE

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, hebrenjtë u ndoqën, u persekutuan me dëbime masive, por populli shqiptar edhe pse ishte vetë i robëruar, i strehoi, i ndihmoi dhe i përkrahi. Faktet historike pohojnë se Shqipëria gjatë asaj periudhe ishte i vetmi shtet evropian që kishte hapur dyert zyrtarisht për mijëra hebrenj të shtetësive të ndryshme. Kushdo që arriti të hynte në tokën tonë gjeti strehë, fshehje dhe shpëtim. Në këtë histori kaq mbreslënëse është e nevojshme të kërkojmë motivet dhe mekanizmat sociale dhe morale që kanë karakterizuar këtë mbrojtje. Pyetja themelore është a mund të shpjegohet shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri me Kanunin?

Ish –shefi i misionit diplomatik amerikan në Tiranë, Herman Bernshtain (Bernstein), pohonte në vitin 1934 se; “*s`ka asnjë gjurmë të diskriminimit të hebrenjve në Shqipëri*” dhe shtonte se “*Shqipëria është një nga vendet e pakta në Europë, ku paragjykimet fetare dhe urrejta nuk ekzistojnë, edhe pse shqiptarët vetë janë të ndarë në tri fe*”<sup>1)</sup>. Dhe koha tregoj se kishte patur të drejtë, pasi shqiptarët pa kaluar dhjetë vjet nga deklarata e tij, mbrojtën çdo hebre të ndjekur nga persekutimi i Doktrinës Naziste<sup>2)</sup>.

Sot, Shqipëria është pjesë e listës së “Të Drejtët Ndër Kombe”! Fenomeni i Holokaustit dhe i shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri nuk është një çështje me të cilën ne duhet të mburremi, por të kërkojmë shpjegim se si ishte e mundur që populli më i varfër në Europë, i mbetur pa qeveri dhe i pushtuar për vite, arriti të kthehej në një model për mbrojtjen e një race në rrezik.

---

1 “The Jewish Daily Bulletin“, Nju-Jork, vëllimi XI, nr. 2821, 17 prill 1934.

2 Po aty.



Shqiptarët ua hapnin dyert të gjithë hebrenjve që vinin nga vendet fqinje dhe nga Europa Qendrore të cilët kërkonin shpëtim, pasi kishin udhëtuar në këmbë, me makinë, me karrocë, nëpër male, të sëmurë, të dëshpëruar. Dhe duke lënë pas vetes shumë varre të ditura e të paditura të njerësve të shtrenjtë. Ata që i kanë pritur kujtojnë se nuk shfaqeshin të veshur keq apo si lypës. Në sjelljet e tyre kishte fisnikëri, visheshin pastër e me shije, punonin pa u ndjerë. Sikurse shkruan dhe H. Sarner në librin e tij "Shpëtimi në Shqipëri", *"Shpëtimtarët shpeshherë nuk i njihnin fare hebrenjtë për të cilët rrezikonin jetën"*, madje *"në shumë raste s'komunikonin dot me ta, për shkak të mosnjohjes së ndërsjelltë të gjuhës"*<sup>3</sup>).

Mbrojtja që shqiptarët u bënë hebrenjve nga holokausti mund të shpjegohet pa dyshim edhe me "Besën". Lashtësia e fjalës "Besa" dhe përhapja e këtij termi në gjuhët e tjera është një e dhënë e sigurtë për të kuptuar rëndësinë e saj. Instituti i Besës është thjesht shqiptar. Sipas Mark Milanit, *"kjo fjalë vlen shumë midis shqiptarëve dhe e gjen veç ndër shqiptarë dhe askund tjetër"*<sup>4</sup>). Në të gjitha rastet ne kemi një vlerë semantike që gjen shpjegim vetëm në autoritetin e kuptimit social dhe historik që Besa ka marrë në rrjedhën e shekujve në popujt e Ballkanit dhe, natyrisht në brendësi të shoqërisë shqiptare<sup>5</sup>).

Ky kod mesjetarë është një tekst që mishëron themelet morale dhe ligjore të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, dhe perbëhet nga një grup ligjesh zakonore. Sistemi i vetëqeverisjes nuk mund të zgjasë gjatë, pa një kornizë ligjore solide, në bazë të traditës. Tradita e mikpritjes së popullit shqiptar, nuk varet nga feja, por është pikërisht një tipar kulturor. Kanuni është përcjellë brez pas brezi në kujtesën e njeriut dhe të rrënjosur

3 Harvey Sarner, Shpëtimi në Shqipëri ,Një qind për qind e hebrenjve në Shqipëri të shpëtuar nga Holokausti,Tiranë 1998.

4 M Milan, *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve*, Muza, Tiranë 1995.

5 *Matteo Mandalà*, Lingua mito storia religione cultura tradizionale nell letteratura Albanese della Rilindja. *Universiteti i Palermos*,12 Giugno 2011.

thellë në vetëdijen e popullit.

Besa ka domethënie të shumëfishtë, duke filluar nga feja, mirëbesimi paqësor, armëpushimi dhe fjala e nderit, deri te premtimi i shenjtë e obligimi për ta mbajtur premtimin dhe për të ofruar mikpritje dhe mbrojtje. Ajo parasheh mbrojtjen e mikut në mënyrë të palëkundur dhe pa kompromis, nëse lipset edhe me kusht vetsakrifkimi. Qëndrimin e guximshëm njerëzor të shqiptarëve të huajt e kanë shpjeguar me “*Besën*” si kod nderi. Edhe ekspozita fotografike e autorit amerikano-hebre Norman Gershman, titullohet: *Besa*<sup>6)</sup>. Besa është një term shumë i vështirë për tu përkthyer nga të huajt, pasi e vështirë është të kuptosh thelbin dhe përmbajtjen e saj arkitekture.

Kur tenton ta shpjegosh këtë term në gjuhë të huaj, rreziku i parë është thjeshtëzimi sipas stereotipeve kalorësiake, njëjtësimi me “*la parole d’honneur, la parole donnee*”. Ky thjeshtëzim do të hijezonte e do të fshinte përmasat e një instituti të ndërthurur si Besa. Pasi kjo do i fshinte thelbin identitar<sup>7)</sup>. Por Besa nuk është i vetmi institut i së drejtës kanunore që ka ndikimin e saj në mbrojtjen e hebrenjve. Ky institut i marrë i vetëm në analizë do të ishte i pakuptueshëm dhe nuk do shpjegonte heroizmin e popullit tonë. Pasi tek ne Hebrejt nuk ishin vetëm në besën e shqiptarit , por dhe në *ndore, ishin fqinj, ishin rob zoti në ditë të ngushtë*.

Siç pohon dhe Faik Konica “*fyerja më e rëndë në Shqipëri është të quash dikë të pabesë.*”

## 1. E DREJTA ZAKONORE APO E DREJTA SHQIPTARE?

Për ti paraprirë studimit tone po japim një parashtesë mbi tablonë e përgjithshme në të cilën pasqyrohet në ditët e sotme ky institucion juridik. Pikësëpari, mund të shtrohet çështja

6 Mehmet Elezi, *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Botimet Fishta , Lezhë 2013, fq 16.

7 Po aty, fq 18.

se si është më e drejtë të emërtohet sistemi juridik shqiptar i mesjetës. Rëndom në punimet studimore e gjejmë me emërtesën: e drejta zakonore shqiptare, apo e drejta kanunore. Nuk janë të paktë autorët e huaj që kanë shkruar për të, të cilët flasin për doke e zakone juridike shqiptare. Më tej, nga vetë emërtesa rrjedh edhe kuptimi i rendit me të cilin shqyrtohet, apo edhe rëndësia institucionale që i jepet.

Kur trajtohet si grumbull dokesh e zakonesh, kthehet në lëndë shqyrtimi etnografik, si e drejtë zakonore apo kanunore më së shumti është marrë historigrafia, dhe jo mjaftueshëm ajo është trajtuar si lëndë e së drejtës. Apo më tej, të trajtohet, siç po ndodh ditët e sotme, vetëm nën optikën e gjakmarrjes dhe të ngujimit. Njihet dhe studiohet e Drejta Romake, e Drejta Bizantine, ajo Osmane apo Sllave, pa cilësorin "zakonor", ndërsa e Drejta Shqiptare bën përjashtim.

Kjo, mënyrë trajtimi për mendimin tonë, zbret dhe nivelin studimor, pasi nuk pranohet si sistem juridik. Ndoshta, që në emërtesë, do të fillonte edhe ecuria e mbarë e shqyrtimit dhe e vlersimit racional të kësaj të Drejte Shqiptare, duke e ngritur në përfaqje me të drejtat e tjera dhe duke përcaktuar kriteret e studimit të saj. Mund të ketë kundërshtime të natyrave të ndryshme ndaj qëndrimit tonë për klasifikimin e së drejtës shqiptare krahas të drejtave të tjera të njohura dhe të pranuara si sisteme juridike. Por, ekzistenca dhe vlera e një lënde të caktuar nuk mund të përcaktohet detyrimisht me modalitetet me të cilat ajo paraqitet. E shkruar në letër apo në papirus, e gdhendur në gur apo pllaka metalike, e gërryer në lëkurë apo e derdhur në dyll, apo më tej e përcjellë gojarisht, - kjo nuk përbën thelbin e vetë lëndës, por vetëm një modalitet. E rëndësishme është përmbajtja dhe vlera që përcjell.

Pra, përkufizimi si e drejtë zakonore, sipas parimit si e tillë quhet e drejta e pashkruar, për mendimin tonë nuk ka themel të qëndrueshëm dhe duhet rishikuar në bazë të kriterëve të mendimit juridik që ajo shpreh.

Megjithatë nuk ka një përmbledhje dhe përpunim të plotë, e më tej një klasifikim sistematik të normave të së drejtës

tradicionale në të gjithë viset shqiptare. Pas këtij shqyrtimi, gjithsesi të kufizuar prej natyrës së trajtesës, mund të ndjehet një lloj idealizimi i këtij institucioni juridik shqiptarë të traditës, ndërkohë që përceptimi i opinionit të sotëm publik është krejt tjetër.

## **2. A KA SHËRBYER KANUNI SI FRYMËZIM PËR SHPËTIMIN E HEBRENJVE?**

Hebrenjtë në tokën shqiptare ishin ,miq, ishin në besë, ishin në ndore, ishin fqinj, ishin njerëz të zotit në ditë të ngushtë. Kaq mjaftonte që çdo hebre në Shqipëri të ndihej po aq i sigurt sa çdo shqiptar i pafajshëm që sheh problemet e veta në shtëpinë e vet. Çdo jetë e pafajshme njerzore duhej mbrojtur për shqiptarin.

Në Bibël thuhet "*Zoti i mbron të pambrojturit*", të tërë njësoj, pa pyetur kush janë, nga vijnë, prej kësaj filozofie ndërtohen dhe institutet kanunore. Besa, miku, ndorja. Kjo filozofi nuk ishte një sistem i përpunuar, nuk përfaqësonte shkollë juridike, nuk ishte përhapur nga murgjit, as prej katedrash e profesorësh. Ishte përcjellë si edukatë e natyrshme në përditshmërinë e jetës, si mënyrë e vetëdishme e të jetuarit, si një sistem vlerash, si një tërësi parimesh morale<sup>8</sup>.

Por a është e drejtë që çdo element të historisë së shpëtimit të hebrenjve ta lidhim me Besën? A është ajo e vetme si institut i së drejtës që shpjegon arsyet e mbrojtjes? Po Besa vete ku i ka rrënjët dhe origjinën? Në përpjekje për të shpjeguar këtë institucion, rreziku më i madhë është thjeshtësimi sipas stereotipeve të ndryshme! Besa nuk është i vetmi institut i së drejtës Shqiptare, le të themi që i përket një tërësie institutesh që përbëjnë në vetvehte kanunin, dhe që të gjitha së bashku mund të na ndihmojnë në shpjegimin e këtij akti të fisshëm që bënë shqiptarër ndaj hebrenjve në rrezik. Besa është më i përmënduri ndër këto institute, por jo i vetmi. Ndoshta një

---

8 Mehmet Elezi, *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Botimet Fishta , Lezhë 2013, fq 131

analizë dhe mbi institutet e tjera të së drejtës të cilat kanë ngelut në hije në këtë histori, do na ndihmonte që të kuptonim më mirë veprimin njerëzor, nga i cili merr dhe vlerat e veta edhe vete instituti i Besës. Në analizën tonë *“Kodi i besës, i nderit, i mikpritjes”*, nuk duhet konsideruar si shkak i vetëm dhe thelbësore i mbrojtjes së hebrenjve. Në këtë analizë duhet të merren në konsideratë dhe veprimet njerëzore të disa figurave historike shqiptare që me pragmatizmin, civilizimin, zgjuarsinë dhe intuitën e tyre bënë që të ruhen e mbrohen hebrenjtë në Shqipëri. Le të shqyrtojmë ndikimin që mund të kenë patur këto institute në mbrojtjen e hebrenjve!

### **2.1 Besa**

Instituti i besës tek shqiptarët, është kuptuar si një fjalë e dhënë edhe e mbajtur, armëpushim sipas kanunit, besnikëri, mbështetje, siguri e sa e sa elemente tjera që respektoheshin me përpikëri shqiptarit ndaj shqiptarit, apo shqiptari ndaj armiku e mikut. Dhënia e besës ishte një institut aq i rëndësishëm sa ai që e jepte atë, ishte në gjendje të humbiste gjithçka, por jo edhe ta thyej atë. Besa përkufizohet si *“fuqi morale e teorisë dhe e vetëmohimit”*.

Të japësh besën nga Kanuni vlersohet si një detyrë dhe një akt fisnikërie. Besa për shqiptarin qëndronte mbi të gjitha. Marrja e nderit ishte vdekje, edhe pse atij që iu ishte marrë ishte gjallë, ishte i vdekur, sipas kanunit. Besa mund të vlerësohet si besim i betuar dhe përmban idenë e fesë dhe të besimit. Ajo është sinteza e virtyteve morale të burrit që i qëndron zotimeve dhe që i atribuon fjalës së dhënë vlerën e një urdhërimit të padhunueshem. Besa kapërcen sferën e njeriut individ dhe bëhet normë e jetës kolektive, e prej kësaj virtyt shoqërorë i popullit shqiptar.

### **2.2 Mikpritja: shtëpia e shqiptarit**

Aty ku, më pas, detyrimi i mbrojtjes arrin rëndësinë e tij më të madhe është mikpritja. Me interes është mënyra se si trajtohet miku në kanun, ku thuhet: *“Shtëpia e shqiptarit*

*është e zotit dhe e mikut*”. Ky kod mesjetarë është një tekst që mishëron themelet morale dhe ligjore të shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Tradita e mikpritjes së popullit shqiptar, nuk varet nga feja, por është pikërisht një tipar kulturor. Në Kanun nuk ekziston koncepti për “*të huajin*”.

“*Shqipëria u bë Shtëpia e Zotit*”, thotë fotografi amerikano-hebre Norman Gershman. Në banesat shqiptare dhoma e miqve ishte e veçantë, si rregull në kat të tretë të kullës, e shtruar me cerga, qilima e sixhade, sipas mundësive ekonomike të familjes<sup>9</sup>). Ajo duhej të mbahej e pastër dhe e rregullt, në gatishmëri për të pritur mikun. Në vorbën e darkës e zonja e shpisë shtonte më shumë copa mishi tepër, për ndonjë mysafiri që mund t’ia behte papritur. Mes elementëve ndër të cilët një burrë mund të quhej i “koritur”, pra me nder të humbur, Kanuni rreshton thyerjen e besës dhe “premjën e mikut”. Edit Durham kujton:

*“një natë e kalova te Sumajt, në shtëpinë e njërit që ishte në gjak. Vëllezërit dolën e bërtitën në të gjitha drejtimet:- Kemi miq. Dyshaljanë, një shkodran dhe një grua të huaj!, Dhe pasi njoftuan këtë, u kthyen për të festuar në siguri...”<sup>10</sup>.*

Në traditën shqiptare mik nuk cilësohet vetëm një i njohur, me të cilin të bashkojnë nderimi i ndërsjellë ose lidhjet martesore. Mik është edhe një udhëtarë i panjohur, të cilit i bie rruga e të thërret në derë. Domethënë cilido bujtës, mysafir i rastit. Sipas Kanunit:- “*po të hini miku në ship, gjak me të pasë do t’i thuesh “Mirë se erdhe”!*”.

Hebrenjtë përmbushnin të gjitha kriteret për tu quajtur miq. Madje përbëjnë rast tipik të dikujt që gëzon në mënyrë të përkryer statusit e mikut, me tërësinë e të drejtave që garanton ky status. Njerëz paqësorë, ishin paraqitur në dyert e shqiptarëve.

Në librin e tij. H. Sarneri përmbledh një histori:

9 Po aty, fq 29

10 Po aty, fq 30

*Sulo Meçaj ishte nga Kruja . Jetonte me djalin e gruan në një shtëpi të vogël që ua kishte lënë babai. Në vitin 1943 ai hapi derën e shtëpisë për dhjetë hebrenj....*

*Djali i Sulos tregon çfarë ndodhi kur erdhën gjermanët në Krujë: "Babanë e lajmëruan se gjermanët po vinin te shtëpia jonë për të kontrolluar për hebrenj. Ai u tha miqve që sapo të jepte një shenjë, ato duhej të shkonin zvarrë te një vend që ai e kishte përgatitur posaçërisht për ta, nën çati. Miqtë i kapi paniku... Njëri prej tyre e pyeti babanë çfarë do të ndodhë nëse gjermanët djegin ndërtesën. Për t'i siguruar babai më urdhëroi mua, të vetmin djalë që kishte, me shku në çati me ta, duke ndarë të njëjtin fat nëse shtëpia do të digjej prej nazistëve. Im atë nuk mund të zgjidhte rrugë tjetër: kjo ishte çështe nderi për të... ".<sup>11)</sup>*

Ky status i mikut u përkiste jo vetëm hebrenjve të ardhur rishtas, por dhe atyre që jetonin prej vitesh në trojet shqiptare.

### **2.3 Ndorja: Mbrojtja**

Duke u konsideruar miq, hebrenjtë ishin "gjind të marrun me ndore". Me marrë me Ndore dikë do të thotë me e marrë në mbrojtje, në besë, me i dhënë statusin e mikut. Dhe me i ra ndore dikujt do të thotë të kërkosh mbrojtjen e tij, të kërkosh që të jesh në besën e tij. Ndonjëherë ndodh edhe që ndorësi të mos e njihte të mbrojturin e vet, por mjaftonte, që personi të hynte në tokën apo në shtëpinë e tij, për ta detyruar të parin që t'i dilte zot të dytit dhe pastaj të hakmerrej nëse atij do t'i ndodhte ndonjë e keqe<sup>12)</sup>.

Instituti i Ndores funksionon afërsisht si besa dhe si Miku! Shpesh Besa dhe Ndoria ngatërrohen, por këto institute nuk janë e njëjta gjë. Kanë ngjashmëri pa dyshim por edhe

11 Po aty, fq 34

12 Xh. Kasteleti, *Normat zakonore dhe jeta shoqërore në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, Studii Albanesi 3-4, Romë 1933. OMBRA GVG 2012, fq 145.

ndryshime. Kur flasim per institutin e Ndores, nënkuptohet gjithmonë dikush në rrezik të drejtpërdrejtë jete. Rreziku duhet të jetë nga njeriu dhe jo nga forcat e natyrës.

Miku jo domosdoshmërisht është i kërcënuar. Të shumtën e herës rreziku për mikun shihet si mundësi, pra është në mbrojtje nga ndonjë rrezik potencial. Në shumicën e rasteve Ndorja është një frymë, pra një person, në raste të jashtëzakonshme, mund të jetë për disa frymë. Në rastin e mbrojtjes së hebrenjve të përndjekur nga Nazizmi ajo u drejtohet disa personave, ky mund të konsiderohet një rast i jashtëzakonshëm.

Ndorja nuk duhet kuptuar si një marrëveshje mbrojtjeje për një kohë të gjatë. Si rregull ajo lidhet me një hark kohorë të caktuar, sa të kaloj rreziku eminent, psh: sa të kalohet një pyllë apo një pritë, sa të arrihet që të ulen ca gjakra të ndezura etj.. Ndorja jetësohet dhe hyn në fuqi në dy mënyra: Në rastin e parë, hyn në fuqi me pëlqimin e dy palëve, si Besa, domethënë me vullnetin e atij që kërkon ndore dhe të atij që merr me ndore.

Në rastin e dytë, hyn në fuqi edhe si shprehje e një vullneti të njëanshëm, siç ndodh me amanetin, dhe në rrethana të caktuara edhe me Besën. Kur një person thotë: "*të kam ra në ndore*", sipas shqiptarit, dëshiron apo jo, je i detyruar për ti dalë zot.

#### **2.4 Fqinji: mbrohet si njeriu i shpisë**

Hebrenjtë që kishin jetuar në Shqipëri gëzonin po ashtu statusin e fqinjit<sup>13</sup>. Në pamje të parë duket sikur hebrenjtë dhe judaizmi janë të panjohur për shqiptarët, por ato ishin të pranishëm gjatë gjithë historisë. Lidhjet kulturore dhe bashkëjetesa midis shqiptarëve dhe hebrenjve, për të cilat është shkruar vitet e fundit janë më të thella se sa janë paraqitur në disa studime. Karakteristikat më të dukshme për studiuesit e historisë së hebrenjve në Shqipëri lidhen me lashtësinë e këtij komuniteti, prania e tij e vazhdueshme në gadishull dhe shkalla e lartë e integritit dhe ndërlidhja me kulturën shqiptare. Këto

---

13 Mehmet Elezi, *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Botimet Fishta, Lezhë 2013, fq 45.



lidhje i gjejmë të shprehura në rënditje kohore në disa forma, si në arkeologji, në gjuhë, në folklor, në besimin e riteve, në ndërtesat e kultit në jetën ekonomike, në burimet dokumentare vëndase e të huaj<sup>14</sup>). Lidhjet e ekzistencës së marrëdhënieve Hebreo -Shqiptare, datojnë që në lashtësi. Ardhjet më të mëdha në rend kronologjik janë katër:

1-Në shekujt e parë p.k, kur deportoheshin si skllevër, pra i referohemi hebrenjve Romaniot.

2-Periudha e Inkuizicionit Përëndimorë, specifkisht atij Spanjoll i fundit të mesjetës, pra i referohemi hebrenjve Safarditë.

3-Në periudhën e përndjekjeve të tyre nga Perandoria Osmane, pas dështimit të kryengritjes së Mesias Mistik Sabbatai Sevi ( 1626 —1676).

4-Në kohën e regjimit Nacional Socialist, pas shpalljes së Doktrinës Naziste, hebrenjtë Ashkënaz, (gjermanikë)<sup>15</sup>).

Burimet historike dëshmojnë se hebrenjtë kanë gjetur në hapësirën shqiptare strehe dhe mbrojtje në periudhat më kritike të rrezikimit të përbashkët të tyre. Megjithatë ne akoma nuk dimë me saktësi, se kur dhe në çfarë rrugësh kanë ardhur për herë të parë hebrenjtë në trojet Ilire, kjo pasi nuk kemi asnjë dokument të që mund të hedhë dritë mbi këtë çështje<sup>16</sup>).

Për shqiptarët fqinji, në rastin tonë Hebre, mbrohet njësoj si pjestarët e familjes. Kanuni deri këtu duket se ka një përputhje me ligjet e Dhiatës së Vjetër edhe se formuluesit e tij të jenë mbështetur aty, te ligji i Talionit, i cili thotë: *“Kur dikush i shkakton një dëmtim fqinjit të vet, ai do të pësojë po atë gjymtim që i ka bërë tjetri, sy për sy, dhëmb për dhëmb”*.

14 Apostol Kotani, *Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj*, Tiranë 2007, fq17.

15 Shaban Sinani, *Hebrenjtë në shqipëri. mbrojtja dhe shpëtimi*, Naimi, Tiranë 2014, fq 172.

16 Edmond Malaj: *Hebrenjtë në trojet shqiptare: Me një përqëndrim në historinë dhe kulturën hebraike*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historise, Tiranë 2012, fq 49.

## KONKLUZION

Ky episod i historisë së shqiptareve, tregon me së miri vlerat e larta të burrërisë dhe mikëpritjes sonë Kombëtare. Eksperienca historike dëshmon një bashkëjetesë pa komplekse dhe të zhveshur nga superioriteti apo inferioriteti mes shqiptarëve dhe hebrenjve për më shumë se 2000 vjet. Nëse e vendosim çështjen në kontekstin e vet historik mund të argumentojmë se nuk ishte vetëm “Besa” si institucion por një sërë institucionesh të tjera, të cilat të marra së bashku, formojnë sjelljen e pashëmbullit të popullit tonë. Hebrenjtë i mbrojtën edhe shqiptarët, përtej faktit nëse njihen dhe cmonte Kanunin apo jo. I mbrojtën konservatori dhe liberali, simpatizuesi i komunizmit dhe simpatizuesi i fashizmit. Emrat më të rëndësishëm të kulturës shqiptare të kohës u përfshinë në këtë histori, shkruan letrat dhe u shprehën në shtyp personalitete si: GJ. Fishta, E Koliqi, L. Poradeci.<sup>17)</sup>

Ahmet Zogu u përkushtuar në mbrojtjen e hebrenjve, vuri disa kushte që lehtësuan hyrjen e tyre në Shqipëri. Jutta Gerechter në kujtimet e veta për Shqipërinë gjatë viteve 1939-1945 shkruante se: “Mbreti Zog pranoi t’u jepte të gjithë emigrantëve hebrenj nënshtetësinë shqiptare, por pushtimi fashist e pengoi të realizonte atë vendim”<sup>18)</sup>. Nuk mjafton vetëm tradita e mikëpritjes apo e besës në këtë sjellje të denjë të shqiptarëve ndaj hebrenjve, apo thjesht statusi i të “huajit”. Shoqëria shqiptare nuk duhet të analizohet vetëm nëpërmjet Kanunit. Analiza e sjelljes kulturore pa raportin me pushtetin, pra, pa marrëdhëniet politike në veprim, do të ishte së pari, e mangët dhe së dyti jo e drejtë. Kjo lloj marrëdhënie kaq unikalë me të huajin në rrezik mbetet një çështje studimi jo vetëm në disiplinën e historisë, drejtësisë por dhe atë etnografike e antropologjike. Shkrimtari francez, Marsel Prusti citon: “Të zbulosh të vërtetën nuk do të thotë të gëshë peisazhe të reja, por të shohësh me sy të ri vlerat identitare”, në mënyrë që të

17 Mehmet Elezi, *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Botimet Fishta, Lezhë 2013, fq 186.

18 A.Kotani, *Shqipëria dhe Hebrejtë në shekuj*. Tiranë, 2007, fq. 49.

lexojmë të shkuarën dhe të projektohem i drejt të ardhmes.

Populli shqiptar i mirëpriti hebrenjtë e ndjekur dhe të përsekutuar, u krijoi atyre kushte për t'u strehuar<sup>19</sup>. Keta dy popuj gjatë historisë së gjatë të bashkëjetesës, nga lashtësia deri në faktet tragjike të viteve 1938-1945, kanë treguar se janë në gjëndje të përballojnë vështirësitë në të cilat u ndodhën. Këto gra, këta burra dhe fëmijë tregojnë se atëherë ishte, ashtu si dhe sot është, e mundur që të veprosh me guxim, ndershmëri e zemërgjerësi edhe në kushtet më të vështira.

Shpresojmë që kujtimet e së kaluarës të n'a ndihmojnë për të ndërtuar një të ardhme më të sigurtë!

---

19 Po aty. 84.

## **BIBLIOGRAFIA**

- Apostol Kotani, Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj, Tiranë 2007
- Edmond Malaj: Hebrenjtë në trojet shqiptare: Me një përqëndrim në historinë dhe kulturën hebraike, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historise, Tiranë 2012.
- Harvey Sarnet, Shpetimi në Shqipëri ,Një qind përqind e hebrenjtëve në Shqipëri të shpëtuar nga Holokausti, Tiranë 1998.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, GEER ,Tiranë, 1999.
- Mehmet Elezi, *Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit*, Botimet Fishta , Lezhë 2013.
- Shaban Sinani, *Hebrenjtë në shqipëri. mbrojtja dhe shpëtimi*, Naimi, Tiranë 2014.
- The Jewish Daily Bulletin“, Nju-Jork, vëllimi XI, nr. 2821, 17 prill 1934
- Xh. Kasteleti, Normat zakonore dhe jeta shoqërore në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Studi Albanesi 3-4, Rome 1933. OMBRA GVG 2012.



**Dr. Ludmilla SHKURTI**

*Departamenti i Ekonomisë, Pedagoge  
Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore  
Kolegji Universitar "Wisdom"  
e-mail: ludmilla.shkurti@wisdom.edu.al*



## **IMPAKTI I KONKURRENCËS MBI PROJEKTIMIN ORGANIZATIV**

## Abstrakt

Globalizimi dhe kriza ekonomike, ka pasur një impakt të konsiderueshëm mbi performancën organizative. Drejtuesit dhe sipërmarrësit kudo në botë përpiqen të gjejnë mënyra se si organizat e tyre të sigurojnë suksesin në një treg kaq kompleks, dinamik dhe kompetitiv. Sigurisht përveç një seri faktorësh që shkenca e menaxhimit evidenton, një projektim organizativ i mirë ka rolin e tij në suksesin e performancës organizative, ashtu sikurse edhe në dështimin e saj kur nuk i kushtohet vëmendje. Me 4803 ndërmarrje aktive të mesme dhe të mëdha ndaj 97436 në total, prej të cilave vetëm 2008 në prodhim, ndaj 15408 total dhe 2295 në shërbime, ndaj 82028 në total,<sup>1)</sup> ndërkohë kur trendi rritës i numrit të tyre duket shpresëdhënës; nga 6752 në vitin 1994 janë 13629 në vitin 2010<sup>2)</sup>, situata duket se është premtuese lidhur me fazën në të cilën ndodhemi dhe impaktin e këtij studimi mbi ndërgjegjësimin për rëndësinë e projektimit organizativ në bizneset shqiptare. Artikulli evidenton disa probleme në procesin e Projektimit Organizativ në kontekstin shqiptar, duke u bazuar në studimin e 200 organizatave që operojnë kryesisht në Vlorë, Tiranë dhe Durrës. Analiza sasiore dhe cilësore dhe kërkimi në terren, bazuar në metodën e pyetësorëve, duke realizuar një analizë faktoriale (faktori principal) evidentoi faktorin më të rëndësishëm, nga i cili impaktohet vendimmarrja në disa nivele menaxheriale për projektimin organizativ. Përmes vërtetimit të hipotezave të ngritura, studimi realizoi objektivin kryesor dhe kuptoi së pari, sa të ndërgjegjësuara janë organizatat shqiptare, për rëndësinë e projektimit organizativ bazuar në faktorët e kontekstit, veçanërisht strategjia dhe ambienti (përveç faktorëve strukturorë). Ai i dha përgjigje pyetjes kërkimore; nëse ishte strategjia, ky faktor kryesor i kontekstit që ka impaktin më të madh mbi këtë proces apo konkurrenca,

---

1 Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë sipas të punësuarve INSTAT- 2018

2 Ndërmarrjet aktive sipas vitit të krijimit dhe aktivitetit ekonomik INSTAT-2018

ky element kritik i mjedisit të biznesit ( si tjetër faktor i kontekstit që e impakton atë) dhe së dyti ofroi një sfond teorik, përmes rishikimit të literaturës më të rëndësishme, mbi projektimin organizativ.

***Fjalë Kyç:** konkurrencë; projektim organizativ; strategji; strukturë; organizatë biznesi; teknologji; faktorë konteksti; faktorë strukturor.*

### **Abstract**

The economic crisis and globalization have had a significant impact on the organizational performance during the last years. The managers and entrepreneurs around the world are trying to find different ways to achieve the organizational success in such a complex, dynamic and competitive market. A good organizational design, say recent studies, along with several factors that the science of management evidences, has its role in the success of organizational performance as well as in its failure. With 4803 active medium and large enterprises compared to the total of 97436 in of which only 2008 in production, against 15408 in total and 2295 in services, toward the total of 82028, while the upward trend in their number seems promising (from 6752 in 1994 to 13629 in the year 2010), the situation seems to be promising as well regarding the stage we are in and the impact of this study on the awareness of the Albanian managers and entrepreneurs, about importance of organizational design in their businesses success or failure. This research, based on 200 organizations operating mainly in Vlora, Tirana and Durrës was tried to highlight some problems in the Albanian organizational design context. A quantitative and qualitative analysis based on the method of questionnaires, and a factorial analysis (the principal factor), have pointed out the most impact context dimensions on decision-making process (on some managerial levels), about the organizational design. Through

the verification of the raised hypotheses the study has fulfilled the main objectives by comparing the findings with the context theoretical dimensions, especially strategy and the environment (apart from structural dimensions) and then has provided a theoretical background through reviewing the most important literature on the issue.

***Key words:** competition, organizational design, strategy, structure, business organization, technology, context factors, structural factors.*

## **HYRJE**

Ky artikull synon të studjojë dhe evidentojë si operojnë organizatat e biznesit në Shqipëri lidhur me projektimin organizativ dhe veçanërisht të zbulojë, nëse është strategjia faktori kryesor i kontekstit ku bazohet vendimmarrja menaxheriale për projektimin organizativ dhe nëse jo, cilët janë ata faktorë apo dimensione të kontekstit që menaxherët apo sipërmarrësit i perceptojnë si të rëndësishme dhe impaktuese për vendimmarrjen e tyre lidhur me të. Bizneset sot ballafaqohen me sfida pa precedentë, duke u përballur me rritjen e konkurrencës, globalizimin, kërkesën për rritje të përgjegjësive sociale, ndryshimet teknologjike, ndryshimin e shijeve dhe egzigjencave konsumatore, të menduarit e ri strategjik etj. Këto sfida duhet të menaxhohen me kujdes për të ndërtuar dhe mbajtur një organizatë me performancë të lartë, për ti bërë ballë konkurrencës së ashpër. Konkurrenca dhe kriza ekonomike i kanë detyruar organizatat të rishikojnë strategjitë e tyre dhe të ndryshojnë mënyrën se si ato operojnë duke u përpjekur shpesh si pasojë të strukturojnë për të mbijetuar dhe për të arritur suksesin. Hulumentimet tregojnë se sipërmarrësve dhe menaxherëve ende u mungon një kuadër praktik dhe sistematik për të drejtuar zgjedhjet e tyre të strukturës organizative. Vihet re se, shumica e strukturimeve janë realizuar në mënyrë të nxituar. Gjetja e një qasje praktike



për projektimin organizativ mund të jetë e vështirë dhe ende nuk kuptohet në mënyrë të drejtë se struktura dhe projektimi organizativ duke diktuar lidhjen e roleve në një organizatë, për pasojë, edhe si funksionojnë njerëzit, ajo mund të jetë shpesh shkaku themelor i problemeve.

### **QASJA METODOLOGJIKE E STUDIMIT**

Në këtë studim u përdor metoda sasiore për realizimin e kërkimit, përmes një qasjeje ontologjike dhe epistemologjike pozitiviste duke ngritur pyetjet për kërkimin dhe u prezantuan hipotezat e tij dhe më tej, duke përdorur teknikën e pyetsorëve për mbledhjen e të dhënave, u bë i mundur zbulimi, evidentimi dhe matja e rëndësisë së faktorëve të strukturimit dhe projektimit organizativ, përmes perceptimeve, qëndrimeve dhe opinionëve të të anketuarve. Ky model qasje është motivuar nga literatura empirike e cila ka identifikuar disa nga këta faktorë si dimensione të rëndësishëm të strukturimit organizativ. Për mbledhjen e të dhënave u shpërndanë pyetsorë pranë disa bizneseve që operojnë në qytetet Tiranë, Vlorë, Fier, Lushnje dhe Durrës. Shpërndarja e 250 pyetsorëve pranë këtyre bizneseve u realizua nëpërmjet kontakteve personale në biznese dhe duke përdorur postën elektronike. Numri i pyetsorëve të mbledhur ishte 220, por të mundshëm për t'i futur në analize, rezultuan vetëm 200. Analiza e tyre u realizua përmes metodave statistikore dhe ekonometrike si; mesatarja, medianja, devijimi standart, dhe analiza e vaiacionit dhe ajo bivariale me anë të tabulatave.

### **RISHIKIMI I LITERATURËS MBI STRUKTURËN DHE PROJEKTIMIN ORGANIZATIV**

Rishikimi i literaturës ka objektivat e veta ku më kryesori është të sjellë kontributin e studjueses në hulumtimin e fushës së studimit duke eksploruar kërkime e studime të ndryshme mbi strukturën dhe projektimin organizativ dhe dimensionet

e tyre, modele e tipologji për të krijuar një kuadër teorik të dobishëm dhe konturuar bazat mbi të cilat mund të ndërtohet një model i propozuar që mund të ndiqet edhe në praktikën e bizneseve shqiptare. **Projektimi organizativ** sipas disa autorëve është procesi i ndërtimit dhe i përshtatjes së strukturës së një organizate, për të arritur qëllimet e saj (Leybourn, 2013), (Galbraith, Downey & Kates 2001). Sipas tyre, projektimi organizativ është procesi, që synon konfigurimin e strukturave, proceseve, sistemeve të shpërblimit, si dhe praktikatat dhe politikat e njerëzve për të krijuar një organizatë të aftë dhe efektive në arritjen e strategjisë së biznesit (Galbraith, Downey & Kates 2001). Projektimi organizatës është proces i qëllimshëm i konfigurimit të strukturave, proceseve, sistemeve të shpërblimit dhe praktikatat e njerëzve për të krijuar një organizatë efektive të aftë për të arritur strategjinë e biznesit. (Kates & Galbraith, 2007). Projektimi organizativ është konsideruar, një lloj menaxhimi dinamik i ciklit të jetës organizative (March 1980). Ai mund të shihet si koncept eksplorimi dhe shfrytëzimi dhe së fundi, projektimi është të mësuarit organizativ: ai është një proces i vazhduar përvojë, gabimi dhe përsosmërie. Projektimi organizativ nuk është detyrë e thjeshtë; nga pesë klasat e strukturës së Mintzberg-ut, Mintzberg (1979), mund të gjenerojnë mbi një- milion e alternativa projektimi. Projektimi organizativ si disiplinë është një shkencë normative, që ka qëllim të tregojë si duhet të strukturohet një organizatë, me qëllim që të funksionojë në mënyrë efektive dhe efçente (Barton & Obel 2004). Dimensionet strukturorë të trajtuara në artikullin tim paraardhës (Shkurti, 2016) mbi dimensionet strukturorë janë të ndërvarura me dimensionet kontekstuale. Po çfarë përfaqësojnë dimensionet kontekstuale? Variablat apo dimensionet kontekstuale sipas studjuesve të ndryshëm janë një grup karakteristikash që ndikojnë gjithashtu në procesin e projektimit të organizatës dhe përfshijnë madhësinë, teknologjinë, mjedisin, strategjinë dhe qëllimet. (Daft R. L., & Armstrong A. (2012). Për shembull, një organizatë e madhe,

një teknologji rutinë dhe një mjedis i qëndrueshëm, sëbashku kanë tendencë për të krijuar një organizatë që ka formalizim, specializim dhe centralizim të lartë. Këto dimensione sigurojnë një bazë të mirë për matjen dhe analizimin e karakteristikave që nuk mund të shihen nga vëzhguesit rastësor, dhe ato zbulojnë informacion të rëndësishëm në lidhje me një organizatë. Pra dimensionet kontekstuale sëbashku me ato strukturore mund të na tregojnë më shumë rreth një organizate dhe rreth dallimeve midis organizatave. Teoria e kontingjencës është një prej lenteve më të mëdha teorike e përdorur për të parë organizatat. (Donaldson 2001). Esenca e paradigmës së kësaj teorie është që efektiviteti organizativ rezulton nga përputhja e disa tipareve të organizatave si p.sh. struktura e saj me të papriturat (kontingjencat) (Donaldson 2001), që reflektojnë situatën e organizatës si psh strategjia (Burns & Stalker 1961) apo teknologjia (Woodward, 1965) apo ambienti (Lawrence & Lorsch, 1967). Kjo perspektivë (Morton, N.A., & Hu, Q.2008), është e njohur si "teoria e kontingjencës" dhe pamë se ishte në kontrast me perspektivën e teoricienëve klasike si Weber, Taylor, Fayol, etj., të cilët mendonin se ndoshta kishte një mënyrë më të mirë për ti strukturuar organizatat. Gjithsesi shumica e studjuesve i grupojnë varibalat e kontekstit në katër, duke i konsideruar pikërisht ato si më të rëndësishmit. Referuar Aquinas, p.sh.(Aquinas,2009), dallojmë këto faktorë kontekstualë të një strukture: Qëllimet dhe strategjia, ambienti, madhësia e organizatës, kultura e saj dhe teknologjia.

Autorë të tjerë (Daft R. L. Armstrong A.,(2012) listojnë; qëllimet dhe strategjinë, ambientin, madhësinë, kulturën dhe teknologjinë. Gjithsesi premisa kryesore në teorinë strukturore të kontingjencës është, se nuk ka një strukturë më të mirë organizative, por struktura e përshtatshme organizative, varet nga të papriturat (kontingjencat ), me të cilat përballet organizata (Burns & Stalker,1961; Chandler, 1962;Child,1973; Galbraith, 1973; Woodward, 1965). Në kontrast me shkencëtarët klasikë edhe sot shumica teoricienëve, besojnë se nuk ka një mënyrë më të mirë për të strukturuar organizatat. E

rëndësishme është që të ketë një përshtatje ndërmjet strukturës së organizatës dhe strategjisë së saj, ashtu si edhe madhësisë, teknologjisë, pra variablave apo dimensioneve kontekstuale që konsiderohen edhe si më të të rëndësishmit dhe kërkesave të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm organizativ (Burns & Stalker, 1961; Chandler, 1962; Child, 1973; Galbraith, 1973; Woodward, 1965).

### **DIMESIONI KONTEKSTUAL - STRATEGJIA**

Strategjia është themeli i procesit të projektimit organizatës. Nëse strategjia nuk është e qartë, ose nuk është rënë dakord për të, nga ana e ekipit të udhëheqjes, nuk ka kritere mbi të cilat do të bazohen vendimet e tjera të projektimit. Pa strategji, pa ditur objektivat e synimet, është e pamundur që menaxherët apo sipërmarrësit të bëjnë zgjedhje racionale gjatë rrugës. Pra strategjia përcakton drejtimin e organizatës. Termi është përdorur gjerësisht nga studjes të dryshëm këtu për të përfshirë vizionin e kompanisë dhe misionit si dhe afatshkurtra dhe afatgjata qëllimet e saj. (Galbraith, Downey & Kates 2001). Strategjia përcakton se cilat produkte dhe tregjet kompania do të ndjekë dhe po aq e rëndësishme, se cilat nga ato nuk do të ndjekë. Strategjia përcakton burimin e përparësisë konkurruese për organizatën dhe mënyrën se si kompania do të dallojnë veten në treg (Galbraith, Downey & Kates 2001). Projektimi organizativ, duhet të mbështesë strategjinë e biznesit; nëse organizata ka për qëllim të jetë innovative, një strukturë hierarkike nuk do të funksiononte siç duhet. Nëse përkundrazi, strategjia është bazuar në koston (e ulët) dhe ofrimin e në vëllimi të lartë (produkt/shërbim), atëherë një strukturë e ngurtë e me kontroll të rreptë mund të jetë projektimi më i mirë. (Daft. L.R, 2012).

### **ANALIZA E FAKTORËVE TË KONTEKSTIT**

Për arritjen e objektivit të studimit pra si e bëjnë projektimin

organizativ organizatat e biznesit në Shqipëri, do të bazohemi tek analiza faktoriale (faktori principal) duke synuar të zbulojmë, se cili/cilët faktorë ka/kanë impakt më të rëndësishëm tek vendimmarrja për zgjedhjen dhe e ndryshimin e strukturës në organizatat e biznesit të marra në shqyrtim.

Kjo zgjedhje për faktin se Analiza faktoriale është teknikë e cila zbatohet në një bashkësi të përbërë nga p-ndryshore dhe nga një numër të madh të dhënash (në analizën statistikore shumëpërmase). Kjo teknikë synon të zvogëlojë numrin e ndryshoreve fillestare duke llogaritur një numër më të vogël ndryshoresh të reja të cilat quhen faktorë.

Së pari ndërtohet matrica e korrelacioneve për të parë se secili variabël ka ndikim të rëndësishëm mbi të tjerët, pra për të përcaktuar komponentin kryesor. Në qoftë se nuk vërehet ndonjë faktor i tillë, atëherë duhet të analizojmë rëndësinë e secilit prej faktorëve. Për këtë, ndërtohet grafiku me shirita i mesatareve dhe i intervaleve të besimit, 95% dhe shihet cili faktor është më i rëndësishëm. Prandaj me anë të kësaj teknike në analizën tonë do të zbulojmë rëndësisë e faktorëve kontekstualë me ndikim tek projektimi organizativ, përmes vërtetimit të dy hipotezave:


#### Hipoteza H01:

Faktori kryesor, apo *dimensioni kryesor i kontekstit*, që ndikon vendimmarrjen e organizatave të biznesit në Shqipëri për zgjedhjen dhe ndryshimin e strukturës është *strategjia*.

#### Hipoteza H02:

Faktori kryesor që ndikon vendimmarrjen e organizatave të biznesit në Shqipëri për zgjedhjen dhe ndryshimin e strukturës *nuk është strategjia*, por faktorë të tjerë diktuar nga sfidat që përballin aktualisht organizatat e biznesit në Shqipëri. Nga pyetja 19: "*Listoni faktorët më të rëndësishëm nga të cilat jeni nisur për zgjedhjen (14) dhe ndryshimin (19) e strukturës dhe më tej jepni mendimin tuaj për rëndësinë e secilit prej faktorëve të listuar në lidhje me ndikimin e tij në ndryshimet*

*në strukturë (vlerësimi më i lartë 10 dhe më i ulët 1).” U arrit të identifikoheshin faktorët e raportuar nga të anketuarit,u krahasuan nëse identifikoheshin me dimensionet teorike të kontekstit dhe më tej të dhënat e përfuara u përdorën për të bërë një analizë të faktorëve duke evidentuar faktorin kryesor duke përdorur Metodën Statistike të Analizës Faktoriale (faktori principal)për të parë, nëse na çon në vërtetimin ose jo të hipotezave H01dhe H02. Nga matrica e korrelacioneve- (Tabela 1), duket se asnjëri prej variablave nuk ka ndikim të rëndësishëm mbi të tjerët, prandaj duhet të analizojmë rëndësinë e secilit prej faktorëve. Për këtë, ndërtojmë së pari grafikun me shirita të mesatareve dhe intervaleve të besimit, 95% dhe shohim cili është më i rëndësishëm (Grafiku - Fig.1). Nga grafiku duket se variabli që ndikon dukshëm më tepër se të tjerët është Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës (P\_19\_6), dhe pastaj vjen Strategjia por sëbashku Modelin e biznesit, prandaj kërkojnë një analizë më të hollësishme të tyre.*



**Fig.1 Grafiku me shirita i mesatareve dhe intervaleve të besimit për faktorët e kontekstit**

Për këtë kryejmë krahasimin e mesatareve të tyre me anë të Paired-Samples t Test.

Nga Tabela e parë vëmë re se ato kanë mesataret përkatësisht 8.70 dhe 8.21 dhe shmangien standarde përkatësisht 1.611 dhe 1.542 me gabim standard mesatar përkatësisht 0.114 dhe 0.109.

Nga Tabela e dytë vëmë re se ato kanë korrelacionin -0.09 dhe sinjifikancën 0.198 që do të thotë se nuk janë të lidhura (korreluara).

Nga Tabela e tretë vëmë re se Mesatarja/Mean = 0.485,  $t = 2.944$  dhe  $p = 0.004 < 0.005$ .

Probabiliteti i dyanshëm për vlerësimin e Konkurrencës (P\_19\_6) është shumë i ulët ( $p = .027$ ) dhe në të vërtetë ai na tregon se ka vetëm 0.4% shanse që një vlerë e  $t$  të mund të jetë e madhe nëse është e vërtetë hipoteza zero, prandaj, kjo  $t$  është e rëndësishme sepse është më e vogël se .05. Fakti që vlera  $t$  është numër pozitiv na tregon se kushti i parë (Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës (P\_19\_6)) e ka mesataren më të madhe se e dyta (Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë (P\_19\_1)) dhe kështu P\_19\_6 na bind për vlerësim më të lartë se P\_19\_1.

Prandaj, mund të nxjerrim përfundimi se pyetja mbi rëndësinë e Konkurrencës (P\_19\_6) jep një vlerësim me sinjifikancë më të madhe se sa ajo mbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1),  $t = 2.944$  dhe  $p = 0.004 < 0.005$ . Ky rezultat u parashikua nga grafiku me shirita për gabimin.

**Tabela 1 - Matrica e Korrelacioneve**

		P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	P_19_3 Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (kompjuterit /internetit)	P_19_4 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve ambientit (biznesit)	P_19_5 Perceptimi mbi impaktin e Globalizmit	P_19_6 Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës	P_19_7 Perceptimi mbi impaktin e Modelit të biznesit (krijimi i vlerës)	P_19_8 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimit të kërkesës konsumatore
P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	1 .263 200	.080 .263 200	-.255** .000 200	.342** .000 200	.163* .021 200	-.091 .198 200	.215** .002 200	-.304** .000 200
P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.080 .263 200	1 .263 200	-.303** .000 200	.002 .980 200	.176* .012 200	-.044 .532 200	.575** .000 200	-.265** .000 200
P_19_3 Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (kompjuterit /internetit)	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	-.255** .000 200	-.303** .000 200	1 .000 200	-.170* .016 200	-.061 .393 200	-.061 .392 200	-.284** .000 200	.114 .108 200
P_19_4 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve ambientit (biznesit)	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.342** .000 200	.002 .980 200	-.170* .016 200	1 .041 200	.145* .041 200	-.187** .008 200	.076 .282 200	-.142* .045 200
P_19_5 Perceptimi mbi impaktin e Globalizmit	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.163* .021 200	.176* .012 200	-.061 .393 200	.145* .041 200	1 .508 200	.047 .508 200	.154* .030 200	-.122 .084 200
P_19_6 Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	-.091 .198 200	-.044 .532 200	-.061 .392 200	-.187** .008 200	.047 .508 200	1 .508 200	.136 .055 200	-.254** .000 200

\*\* . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

\* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

**Paired Samples Statistics**

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pair 1 P_19_6 Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës	8.70	200	1.611	.114
P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	8.21	200	1.542	.109

**Paired Samples Correlations**

	N	Correlation	Sig.
Pair 1 P_19_6 Perceptimi mbi impaktin e Konkurrencës & P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	200	-.091	.198



### Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 P_19_6 Perceptimi mbi impaktin e Konkurencës - P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	.485	2.330	.165	.160	.810	2.944	199	.004

### Paired Samples Statistics

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pair 1 P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	8.21	200	1.542	.109
P_19_7 Perceptimi mbi impaktin e Modelit të biznesit (krijimi i vlerës)	8.00	200	1.888	.133

### Paired Samples Correlations

	N	Correlation	Sig.
Pair 1 P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë & P_19_7 Perceptimi mbi impaktin e Modelit të biznesit (krijimi i vlerës)	200	.215	.002

### Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë - P_19_7 Perceptimi mbi impaktin e Modelit të biznesit (krijimi i vlerës)	.205	2.165	.153	-.097	.507	1.339	199	.182

Kryejmë krahasimin e mesatareve të vlerësimit i mendimit mbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1) dhe mendimit mbi rëndësinë e Teknologjisë (P\_19\_2) me anë të Paired-Samples t Test.

Nga Tabela e parë vëmë re se ato kanë mesataret përkatësisht 8.21 dhe 8.00 dhe shmangien standarde përkatësisht 1.542 dhe 1.888 me gabim standard mesatar përkatësisht 0.109 dhe 0.133.

Nga Tabela e dytë vëmë re se ato kanë korrelacionin 0.215 dhe sinjifikancën 0.002 që do të thotë se nuk janë të lidhura (korreluara).

Nga tabela e Tretë vëmë re se Mesatarja/Mean = 0.205,  $t = 1.339$  dhe  $p = 0.182 > 0.005$ .

Probabiliteti i dyanshëm për vlerësimin e Strategjisë (P\_19\_1) është i lartë ( $p = .182$ ) dhe në të vërtetë ai na tregon se ka vetëm 18.2% shanse që një vlerë e t të mund të jetë e madhe nëse është e vërtetë hipoteza zero, prandaj, kjo t nuk është e rëndësishme sepse është më e madhe se .05. Fakti që vlera t është numër pozitiv na tregon se kushti i parë (mendimitmbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1)) e ka mesataren më të madhe se e dyta (Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë (P\_19\_2)), megjithatë P\_19\_1 nuk na bind për vlerësim më të lartë se P\_19\_2. Prandaj, mund të nxjerrim përfundimi se të dyja pyetjet mbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1) dhe të Teknologjisës (P\_19\_2) japin një vlerësim me sinjifikancë të njëjtë,  $t = 1.339$  dhe  $p = 0.182 > 0.005$ .

Ky rezultat u parashikuar nga grafiku me shirita për gabimin.

### Paired Samples Statistics

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pair 1 P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë	8.21	200	1.542	.109
P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	7.44	200	1.906	.135

### Paired Samples Correlations

	N	Correlation	Sig.
Pair 1 P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë & P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	200	.080	.263

### Paired Samples Test

		Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
		Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
					Lower	Upper			
Pair 1	P_19_1 Perceptimi mbi impaktin e Strategjisë - P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	.770	2.355	.167	.442	1.098	4.624	199	.000

Kryejmë krahasimin e mesatareve të rëndësisë së Teknologjisë (P\_19\_2) dhe rëndësisë së Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4) me anë të Paired-Samples t Test.

Nga Tabela e parë vëmë re se ato kanë mesataret përkatësisht 7.44 dhe 6.78 dhe shmangien standarde përkatësisht 1.906 dhe 1.993 me gabim standard mesatar përkatësisht 0.135 dhe 0.141.

Nga Tabela e dytë vëmë re se ato kanë korrelacionin 0.002 dhe sinjifikancën 0.98 që do të thotë se nuk janë të lidhura (korreluara).

Nga Tabela e tretë vëmë re se Mesatarja/Mean = 0.660,  $t = 3.387$  dhe  $p = 0.001 < 0.005$ .

Probabiliteti i dyanshëm për vlerësimin e Teknologjisë (P\_19\_2) është shumë i ulët ( $p = .001$ ) dhe në të vërtetë ai na tregon se ka vetëm 0.1% shanse që një vlerë e t të mund të jetë e madhe nëse është e vërtetë hipoteza zero, prandaj, kjo t është e rëndësishme sepse është më e vogël se .05. Fakti që vlera t është numër pozitiv na tregon se kushti i parë (Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë (P\_19\_2)) e ka mesataren më të madhe se e dyta (Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4)) dhe kështu P\_19\_2 na bind për vlerësim më të lartë se P\_19\_4. Prandaj, mund të nxjerrim përfundimi se pyetja mbi rëndësinë e Teknologjisë (P\_19\_2) jep një vlerësim me sinjifikancë më të madhe se sa ajo mbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1),  $t = 3.387$  dhe  $p = 0.001 < 0.005$ .

Ky rezultat u parashikua nga grafiku me shirita për gabimin.

**Paired Samples Statistics**

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pair 1 P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë	7.44	200	1.906	.135
P_19_4 rëndësinë e Ndryshimeve ambientit	6.78	200	1.993	.141

**Paired Samples Correlations**

	N	Correlation	Sig.
Pair 1 P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë & P_19_4 rëndësinë e Ndryshimeve ambientit	200	.002	.980

**Paired Samples Test**

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 P_19_2 Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë- P_19_4 rëndësinë e Ndryshimeve ambientit	.660	2.755	.195	.276	1.044	3.387	199	.001

Kryejmë krahasimin e mesatareve të vlerësimi i mendimit mbi rëndësinë e Dixhitalizimit (P\_19\_3) dhe mendimit mbi rëndësinë e Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4) me anë të Paired-Samples t Test.

Nga Tabela e parë vëmë re se ato kanë mesataret përkatësisht 6.69 dhe 6.78 dhe shmangien standarde përkatësisht 1.789 dhe 1.993 me gabim standard mesatar përkatësisht 0.126 dhe 0.141.

Nga Tabela e dytë vëmë re se ato kanë korrelacionin -0.170 dhe sinjifikancën 0.016 që do të thotë se nuk janë të lidhura (korreluara).

Nga Tabela e tretë vëmë re se Mesatarja/Mean = -0.090, t = -0.440 dhe p = 0.661 > 0.005.

Probabiliteti i dyanshëm për vlerësimin e Dixhitalizimit (P\_19\_3) është i lartë ( $p = .661$ ) dhe në të vërtetë ai na tregon se ka 66.12% shanse që një vlerë e t të mund të jetë e madhe nëse është e vërtetë hipoteza zero, prandaj, kjo t nuk është e rëndësishme sepse është më e madhe se .05. Fakti që vlera t është numër negativ na tregon se kushti i parë (Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (P\_19\_3)) e ka mesataren më të vogël se e dyta (Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4)), megjithatë P\_19\_4 nuk na bind për vlerësim më të lartë se P\_19\_3. Prandaj, mund të nxjerrim përfundimi se të dyja pyetjet mbi rëndësinë e Dixhitalizimit (P\_19\_3) dhe të Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4) japin një vlerësim me sinjifikancë të njëjtë,  $t = -0.440$  dhe  $p = 0.661 > 0.005$ .

Ky rezultat u parashikuar nga grafiku me shirita për gabimin.

#### Paired Samples Statistics

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
Pair 1 P_19_3 Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (kompjuterit /internetit)	6.69	200	1.789	.126
P_19_4 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve ambientit (biznesit)	6.78	200	1.993	.141

#### Paired Samples Correlations

	N	Correlation	Sig.
Pair 1 P_19_3 Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (kompjuterit /internetit) & P_19_4 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve ambientit (biznesit)	200	-.170	.016

### Paired Samples Test

	Paired Differences					t	df	Sig. (2-tailed)
	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean	95% Confidence Interval of the Difference				
				Lower	Upper			
Pair 1 P_19_3 Perceptimi mbi impaktin e Dixhitalizimit (kompjuterit /internetit) - P_19_4 Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve ambientit (biznesit)	-.090	2.895	.205	-.494	.314	-.440	199	.661

Kryejmë krahasimin e mesatareve të rëndësisë së Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4) dhe rëndësisë së Ndryshimeve të kërkesës konsumatore (P\_19\_8) me anë të Paired-Samples t Test.

Nga Tabela e parë vëmë re se ato kanë mesataret përkatësisht 7.44 dhe 6.78 dhe shmangien standarde përkatësisht 1.906 dhe 1.993 me gabim standard mesatar përkatësisht 0.135 dhe 0.141.

Nga Tabela e dytë vëmë re se ato kanë korrelacionin 0.002 dhe sinjifikancën 0.98 që do të thotë se nuk janë të lidhura (korreluara).

Nga Tabela e tretë vëmë re se Mesatarja/Mean = 0.660,  $t = 3.387$  dhe  $p = 0.001 < 0.005$ .

Probabiliteti i dyanshëm për vlerësimin e Teknologjisë (P\_19\_2) është shumë i ulët ( $p = .001$ ) dhe në të vërtetë ai na tregon se ka vetëm 0.1% shanse që një vlerë e  $t$  të mund të jetë e madhe nëse është e vërtetë hipoteza zero, prandaj, kjo t është e rëndësishme sepse është më e vogël se .05. Fakti që vlera  $t$  është numër pozitiv na tregon se kushti i parë (Perceptimi mbi impaktin e Teknologjisë (P\_19\_2)) e ka mesataren më të madhe se e dyta (Perceptimi mbi impaktin e Ndryshimeve të ambientit (P\_19\_4)) dhe kështu P\_19\_2 na bind për vlerësim më të lartë se P\_19\_4. Prandaj, mund të nxjerrim përfundimi se pyetja mbi rëndësinë e Teknologjisë (P\_19\_2) jep një vlerësim me sinjifikancë më të madhe se sa ajo mbi rëndësinë e Strategjisë (P\_19\_1),  $t = 3.387$  dhe  $p = 0.001 < 0.005$ .

Ky rezultat u parashikuar nga grafiku me shirita për gabimin.

Kjo analizë faktoriale (faktori principal) përmes krahasimit

hap pas hapi të mesatareve për rëndësinë e secilit dimension të listuar nga pyetësoret, hedh poshtë hipotezën H01 dhe vërteton hipotezën H02, duke treguar se faktori kryesor që ndikon vendimmarrjen e organizatave të biznesit në Shqipëri për zgjedhjen dhe ndryshimin e strukturës *nuk është strategjia*, por faktorë të tjerë si psh konkurrenca dhe të tjerë kryesisht të lidhur me ambientin e biznesit.

## KONKLUZIONE

Disa konkluzione me interes që dalin nga studimi pasi ju dha përgjigje pyetjeve kërkimore dhe u vërteuan hipotezat e tij do ishin:

**Përfundim 1.** Organizatat e biznesit në Shqipëri udhëhiqen pak, ose në mënyrë të moderuar nga kontributet teorike shkencore, në projektimin organizativ dhe ndryshimin e strukturës. Niveli i moderuar i njohurive dhe i ndërgjegjësimit të klasës menaxhere dhe sipërmarrësve shqiptarë, për rëndësinë e strukturimit organizativ bazuar tek njohuritë shkencore, bën që organizatat e biznesit në Shqipëri të mos konsiderojnë tërësisht dhe racionalisht dimensionet kontekstuale dhe konkretisht strategjinë, në vendimmarrjen e tyre për projektimin organizativ dhe ndryshimin e strukturës.

**Përfundim 2.** Duke qenë se dimensionet kontekstuale i udhëheqin fare pak organizatat e biznesit në Shqipëri në vendimmarrjen e tyre në projektimin organizativ dhe ndryshimin e strukturës, faktorët kryesorë që ndikojnë vendimmarrjen e tyre për zgjedhjen dhe ndryshimin e strukturës, lidhen më tepër me sfidat që ata përballin sesa bazohen shkencërisht në teoritë organizative.

**Përfundim 3.** Studimi dhe analiza faktoriale ku ai u bazua, tregoi se faktori kryesor që ndikon vendimmarrjen e organizatave të biznesit në Shqipëri për zgjedhjen dhe ndryshimin e strukturës nuk është strategjia, por faktorë të tjerë sidomos, ata të lidhur me ambientin e biznesit.

Konkretisht studimi tregon se konkurrenca si element i ambientit impakton më shumë dhe kjo diktohet nga sfidat që

përballin aktualisht organizatat e biznesit në Shqipëri, por impaktojnë edhe elementët e tjerë të ambientit të biznesit si psh. teknologjia apo dixhitalizimi.

**Përfundim 4.** Një fakt interesant që evidenton studimi është se modelet e biznesit, një element relativisht i ri në teorinë dhe praktikën menaxheriale, është prezent në mentalitetin e biznesit shqiptar duke dale në pah si faktor impaktues për projektimin organizativ.

Ndërgjegjësimi i klasës menaxheriale dhe sipërmarrëse për ndikimin e tij në suksesin e biznesit, tregon një evolucion të mendimit menaxherial edhe në vendin tonë.

**Përfundim 5.** Një nga sfidat e strukturimit të organizatave të biznesit në Shqipëri është edhe kultura menaxheriale dhe sipërmarrëse në lidhje me konceptin e strategjisë.

**Sugjerim 1.** Ka shumë rëndësi të kuptohet nga të gjithë se mënyra se si kompanitë bëjnë biznes, shpesh ka më shumë rëndësi, se sa ajo çfarë ato bëjnë, sepse kjo do të ketë impakt më të madh tek sukcesi i tyre, duke i diferencuar nga të tjerët dhe nëse strukturimi i bën ato të ndryshme, ka gjasa të çojë edhe drejt suksesit. Modeli i biznesit është shumë i rëndësishëm, sepse mund të përbëjë avantazhin e tyre konkurrues.

**Sugjerim 2.** Rinovimi i modelit të biznesit, duke ruajtur avantazhin konkurrues në mënyrë të qëndrueshme, mund t'i ndihmojë kompanitë të jenë më përpara në lojën konkurruese dhe të jenë gjithmonë të sukseshme.

**Sugjerim 2.** Krijimi bërthamave të ekspertëve që ofrojnë një support të tillë, do ishte me interes për universitetet dhe bizneset.

### **Rekomandime për Studjuesit**

Me interes do të ishte të studjoheshin dimensionet strukturore më prezentë në organizatat me performancë të lartë apo në ato me performancë të ulët, ose edhe në sektorë të veçantë të ekonomisë, për të kuptuar më mirë ndikimin e tyre në performancën e organizatës.



**BIBLIOGRAFIA**

- Richard M. Burton, Børge Obel, and Gerardine DeSanctis Organizational Design: A Step-by-Step Approach, Cambridge University Press ,2011
- Robbins, Stephen P., Organization Theory: Structure, Design and Applications, Prentice Hall International Editions, Neë Jersey, 1990.
- Robbins, Stephen P., Organization Theory: Structure, Design, And Applications, 3/E Organization Theory: Structure, Design, And Applications, 3/E Pearson Education (2009)
- Alvin Toffler, The Third Wave, New York: Bantam Books, 1981
- Zachry, M. & Thralls, C. (Eds.), Communicative practices in workplaces and the professions: Cultural perspectives on the regulation of discourse and organizations. Amityville, NY: Baywood Publishing, 2007.
- Jay Galbraith Diane, Downey Amy & Kates Designing Dynamic Organizations: A Hands-on Guide for Leaders at All Levels 2001
- Evan Leybourn, Directing the Agile Organization: A Lean Approach to Business Management It Governance publishing UK 2013
- Designing your organization: using the star model to solve 5 critical design challenges/Amy Kates, Jay R. Galbraith, John Wiley & Sons, Inc 2007
- A Kates and J R. Galbraith , Robin Smith, Chemical Process: Design and Integration, John Wiley & Sons, Inc, 2000-2015
- Huber G.P. Use of the theory on organizational design. 2009 USA Springer
- Teece, D. J. (2007), Explicating dynamic capabilities: the nature and microfoundations of (sustainable) enterprise performance. Strat. Mgmt. J., 28: 1319–1350.
- The Conflict Between Contingency And Institutional Theories Of Organizational Design Lex Donaldson "Designing Organizations 21st Century Approaches" fq 4.

- Richard L. Darf & Ann Armstrong Organizational theory design: Nelson 2012
- Tiessen, P. and J. H. Waterhouse. Towards a descriptive theory of management accounting. Accounting, Organizations and Society 1983 .fq 251-267.
- P.G Aquinas, Organization Structure and Design: Applications & Challenges
- Ann. L. Cunliffe and Teta Luhman, Key Concepts in Organization Theory. SAGE Publications Ltd 2012
- Richard S. Blackburn The Academy of Management Review Vol. 7, No. 1 (Jan., 1982), fq. 59-66
- Tobias Weigl: Strategy, Structure and Performance in a Transition Economy: An Institutional Perspective on Configurations in Russia, Verlag 2008.



*Autor i parë: Dr. Arjana LLANO*  
*Lektore në Departamentin e Drejtësisë*  
*Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë*  
e- mail: ariana-llano@live.com



*Autor i dytë: Dr. Stela MEÇAJ*  
*Lektore në Departamentin e Drejtësisë*  
*Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë*  
e- mail: stela.mecaj@yahoo.com

## QEVERISJA VENDORE NË PËRQASJE ME STANDARDET EVROPIANE

## **Abstract**

Underlying the Albanian legislation for local government, the standards achieved by the international community were established, which had initiated a series of initiatives, crowned with the adoption of the European Charter of Local Autonomy. The European Charter of Local Autonomy represents the main act in which the components of the European concept of local government are affirmed. Decentralization is a process where the authority and responsibility for certain functions is transferred from the central government to the local government units. The principle of subsidiarity is based on the principle of decentralization, according to which “the exercise of public responsibilities should, in general, belong to the closest authorities of the citizens”. Decentralization and self-government, in themselves, are not enough to guarantee a greater democracy. But democracy needs decentralization and self-governance. Local Self-Government “is the right and the ability of local self-government units established under the Constitution and this law and within its limits to regulate and administer an essential part of public affairs under their responsibility and in the interest of the community”. The autonomy of local government units is not just an administrative autonomy. It is presented as a political, normative and financial autonomy. The municipality consists of several administrative units, according to traditional, historical, economic and social ties. Administrative units in the territory of a municipality, their territorial extension and name are determined by law. The county consists of several basic units of local government with traditional economic and social ties and common interests. It is the unit where regional policies are built and implemented and where they are aligned with state policy.

**Key words:** *Local Governance, Decentralization, Local Autonomy, Municipality, County, etc.,*

## Hyrje

Qeverisja vendore në Shqipëri ka filluar në shekullin e kaluar. Fillimet e institucionit të bashkisë së Shkodrës i gjejmë në vitin 1865, kur Porta e Lartë po përpiquej të realizonte disa reforma. Beledija siç quhej në atë kohë intitucioni i bashkisë kishte kompetenca minimale dhe personel të kufizuar. Ajo merrej me ruajtjen e rendit dhe të pastërtisë së qytetit, kontrollin mbi çmimet e artikujve që tregtoheshin dhe vjeljen e taksave. Pas mbarimit të luftës së I-rë botërore mori emrin "Perlimtare". Para viteve '90, ajo ishte një qeverisje e dekoncentruar me organe të kufizuara vetë-qeveritëse (Këshillat popullore).

Demokratizimi e racionalizimi i qeverisjes vendore, afirmimi i parimit të vetëqeverisjes lokale u shndërrua në çështjet më themelore të shtetit shqiptar gjatë gjithë periudhës së tranzicionit demokratik. Në themel të legjislacionit shqiptar u vendosën standardet e arritura nga Bahkësia ndërkombëtare, e cila kishte ndërmarrë një varg nismash, të kurorëzuara me adoptimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale.<sup>1)</sup> Parimet kryesore të kartës i detyrojnë shtetet të respektojnë autonominë e pavarësinë e pushtetit vendor. Karta Evropiane e Autonomisë Lokale përfaqëon aktin kryesor, në të cilën afirmohen përbërësit e konceptit evropian të qeverisjes vendore. Preambula e kartës së bashkësitë lokale konsiderohet, si një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik.<sup>2)</sup> Kjo pasohet nga fryma e të gjithë Kartës sipas të cilës qeverisja vendore dhe autonomia e saj janë të lidhura ngushtë me të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në administrimin e çështjeve publike.

Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale, që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Karta Evropiane e

1 L. Omari, A. Anastasi, E drejta Kushtetuese, Tiranë 20017, f. 327.

2 Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg shkurt 1991.

Autonomisë Lokale, përfaqëson aktin kryesor në të cilën afirmohen përbërësit e konceptit evropian të qeverisjes vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetë-qeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik.

### ***Decentralizimi i qeverisjes vendore.***

Decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit "ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve". Decentralizimi ka përmasat e veta, politike, administrative dhe financiare, të cilat ndërveprojnë midis tyre dhe përfaqësojnë në thelb tre komponentët e pushtetit. Decentralizimi është politik dhe përfshin transferimin e autoritetit politik në nivelin vendor nëpërmjet një sistemi përfaqësimi të bazuar në zgjedhjet politike vendore. Nëpërmjet decentralizimit administrativ transferohet përgjegjësia për çështjet e administrimit të disa funksioneve publike qendrore të njësitë vendore<sup>3</sup>, Kushtetuta ka parimet e organizimit dhe funksionimit demokratik të qeverisjes vendore. Në nenin 13 është vendosur parimi i decentralizimit dhe i autonomisë vendore<sup>4</sup>.

Qeverisja Vendore duhet të konsiderohet, si pjesë e të gjithë sistemit qeverisës dhe është e rëndësishme për një qeverisje të mirë, më shumë demokraci, besim dhe përgjegjshmëri në kryerjen e funksioneve shtetërore. Pushteti qendror duhet t'a konsiderojë decentralizimin, si një opsion/mundësi në fusha të ndryshme të politikave shtetërore dhe

---

3 O. Muçollari Politikat dhe instrumentat e zhvillimit lokal.

4 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 13 Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

shpërndarja e përgjegjësive dhe pushteteve ndërmjet niveleve të ndryshme qeverisëse duhet të jetë e përshtatshme për nevojat funksionale për aq kohë sa qëllimi i qeverisë është t’i shërbejë shoqërisë civile dhe qytetarëve. Këto nevoja funksionale mund të ndryshojnë, jo vetëm nga shteti në shtet por gjithashtu edhe brenda të njëjtit shtet, nga rajoni në rajon në bazë të politikave shtetërore dhe periudhave kohore. Duke bërë këtë, pushteti qëndror duhet t’i kushtojë vëmendje kuadrit ligjor dhe komuniteteve ekzistuese. Decentralizimi dhe vetëqeverisja, në vetvete, nuk janë të mjaftueshëm për të garantuar një demokraci më të madhe. Por demokracia ka nevojë për decentralizim dhe vetëqeverisje.

Zhvillimi, progresi në demokraci varet nga institucionet dhe sjellja politike. Kjo e fundit është më e vështirë për t’u arritur dhe kërkon kohë. Institucionet me ndërgjegje duhet të mbështesin zhvillimin e demokracisë. Strategjia e Decentralizimit dhe e Autonomisë Vendore erdhi në një moment të rëndësishëm, pasi deri në ato momente gjendja e qeverisjes vendore paraqitej shumë delikate dhe me shumë probleme: nuk kishte përkufizime të qarta për përgjegjësitë dhe funksionet, por përkundrazi ato ishin shumë të përgjithshme dhe ishte e vështirë të hiqje një vijë ndarëse midis përgjegjësive të qeverisjes vendore dhe asaj qëndrore; kishte mbivendosje të dukshme funksionesh/përgjegjësish në shumë fusha; gjithashtu mospërputhja e përgjegjësive me autoritetin për të vepruar sidomos si rezultat i pamundësive financiare.<sup>5)</sup>

### *Autonomia Vendore*

Në nenin 113 të Kushtetutës parashikohet:

#### **1- Bashkia dhe qarku**

- Rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridksionit të tyre.

---

5 “Strategjia kombëtare e decentralizimit dhe e autonomisë lokale”.

- Ushetrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyre të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike.
- Kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.
- Kanë të drejtë të vendosin, në përputhje me ligjin taksa vendore, si dhe nivelin e tyre.
- Caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në përputhje me ligjin.
- Krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendor të nderit.
- Ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

## **2- Organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra.<sup>6)</sup>**

“Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.<sup>7)</sup>

Autonomia e njësive të qeverisjes vendore nuk është vetëm një autonomi administrative. Ajo paraqitet si një autonomi politike, normative e financiare. Kjo del si analizë e nenit 113. Autonomia u njihet në mënyrë të barabartë të gjitha njësive vendore, natyrisht sipas niveleve të tyre. Nga pikpamja politiko-administrative njësitë e qeverisjes vendore janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Ato nuk kanë kurrfarë varësie me organet e tjera shtetërore. Autonomia normative shprehet në faktin se organet e të gjitha njësive të qeverisjes vendore nxjerrin vendime, urdhra, urdhëresa. Të drejtat dhe funksionet e tyre janë të rregulluara më hollësisht me ligj. Karakteri territorial përbën dhe aspektin më thelbësor

---

6 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 113.

7 Ligji 139\2015 Për vetqeverisjen vendore, neni 2.



të tyre. Kjo kërkon që aktet e tyre të kenë fuqi detyruese për të gjitha subjektet, që jetojnë e veprojnë brenda njësisë territoriale, që përfaqëson organi përkatës. Këtu përfshihen aktet vendore:

- urdhëresat dhe vendimet, që nxjerr Këshilli i Qarkut
- rregulloret e organizimit dhe të funksionimit, që nxjerrin Këshillat bashkiakë
- urdhrat, urdhëresat dhe vendime, që nxjerrin njësitë e qeverisjes vendore.

Përveç faktit, që zbatohen në një territor të kufizuar, karakteristik e tyre është se mbi atë territor kanë forcën e ligjit, në të njëjtën kohë këto akte kanë detyrim të jenë në pajtim të plotë me ligjet.

Autonomia financiare është një nga aspektet më të rëndësishme të autonomisë vendore. Ajo përbën një garanci, jo vetëm për realizimin e asaj vetë, por edhe për arritjet e autonomisë politike, normative dhe administrative. Kushtetuta përcakton, se njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë buxhet të pavarur.<sup>8)</sup>

Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj. 2. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj. 3. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla, që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.<sup>9)</sup>

**Bashkitë** krijojnë të ardhura nga: a) taksat vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet

8 L. Omari, A. Anastasi, E drejta Kushtetuese, Tiranë 20017, f. 333.

9 Ligji 139\2015 Për vetqeverisjen vendore, neni 6.

e kryera me to; b) taksat vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; c) taksat vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksat vendore mbi të ardhurat vetjake, të krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; d) të ardhura nga donacionet dhe dhuratat; dh) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj. 2. Bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara në ligjin përkatës.

**Qarku** përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale ekonomike dhe sociale dhe interesave të përbashkëta.<sup>10)</sup> Eshtë njësia ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore. Organet përfaqësuese të njësive vendore janë këshillat e tyre. Bashkitë delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjestim me popullsinë e tyre dhe kryetarët e bashkive janë gjithnjë anëtarë të këshillit të qarkut. Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese për qarkun. Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark, kompetencat e tij përcaktohen me ligj. Këshilli i Ministrave mund të shpërndajë apo shkarkojë organet e zgjedhura të njësive të qeverisjes vendore për shkelje të rënda të kushtetutës apo të ligjeve. Organi i shpërnadarë apo i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministarve pezullohet.

Në rast se Gjykata Kushtetuese le në fuqi vendimin e Këshillit të Ministrave, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve të parakohshme. Kushtetuta ka sansionuar Gjykatën Kushtetuese si organ të vetëm që gjykon lidhur me pajtueshmërinë e akteve normative të qeverisjes vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo vendos

10 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 110.

gjithashtu për mosmarrveshjet e kompetencës midis pushtetit qëndror dhe qeverisjes vendore, neni 131 i kushtetutës.<sup>11)</sup>

Sidoqoftë kompetenca e prefektit ndaj akteve të miratuara nga organet e pushtetit vendor shtrihet deri në pezullimin e përkohshëm të akteve, nëse kostaton paligjshmëri. Kjo nuk është kosideruar antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Sidoqoftë vetëm gjykata mbetet organi kompetent që mund të shfuqizoj një akt të dalë nga pushteti vendor. Në lidhje me faktin se Këshilli i Ministrave autorizohet nga Kushtetuta, që të shpërndajë ose shkarkojë një organ të zgjedhur drejtpërdrejtë të njësisë vendore nuk e prek pavarësinë politike të tyre.

Kushtetuta në këtë rast ka parashikuar dy garanci të rëndësishme. Në radhë të parë, ajo ka vendosur shprehimisht se shpërndarja ose shkarkimi i organit vendor mund të ndodhë vetëm kur ka shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve nga këto organe.<sup>12)</sup> Në radhë të dytë Kushtetuta ka parashikuar Gjykatën Kushtetuese si organ garantues, që kontrollon kushtetueshmërinë e shkarkimit ose të shpërndarjes të organit vendor. Ajo i jep mundësinë organit të shpërndarë ose të shkarkuar të ankohet pranë kësaj gjykate brenda 15 ditëve. Paraqitja e ankimit pezullon automatikisht vendimin e Këshillit të Ministrave. Kushtetuta ka parashikuar, se në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së ankimit brenda afatit të caktuar në Kushtetutë, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse neni 115\3.<sup>13)</sup>

11 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 131 Gjykata Kushtetuese vendos papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qëndrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndarjen e pushtetit qëndror dhe qeverisjes vendore.

12 L. Omari, A. Anastasi, E drejta Kushtetuese, Tiranë 20017, f. 332.

13 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 115 Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

### ***Parimet themeloretë vetëqeverisjes vendore***

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore
2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë. 4. Çdo bashki dhe qark është njësi vetëqeverisëse me vazhdimësi.<sup>14)</sup>

Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre. Struktura, procedura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe natyra e çështjeve për konsultim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### ***Konkluzionet***

Fillimet e institucionit të bashkisë së Shkodrës i gjejmë në vitin 1865 kur Porta e Lartë po përpiqej të realizonte disa reforma. Beledija siç quhej në atë kohë intitucioni i bashkisë kishte kompetenca minimale dhe personel të kufizuar. Ajo merrej me ruajtjen e rendit dhe të pastërtisë së qytetit, kontrollin mbi çmimet e artikujve që trëgtoheshin dhe vjeljen e taksave.

Kartës Evropiane e Autonomisë Lokale përfaqëon aktin

14 Ligji 139\2015 Për vetqeverisjen vendore neni 4.

kryesor në të cilën afirmohen përbërësit e konceptit evropian të qeverisjes vendore. Në preambulën e kartës bashkësitë lokale konsiderohen, si një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik.

Parimi i decentralizmit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizmit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit "ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve".

"Autonomi vendore" është e drejta dhe aftësia e njësite të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë. Autonomia e njësite të qeverisjes vendore nuk është vetëm një autonomi administrative. Ajo paraqitet si një autonomi politike, normative e financiare.

Autonomia normative shprehet në faktin, se organet e të gjitha njësite të qeverisjes vendore nxjerrin vendime, urdhra, urdhëresa. Të drejtat dhe funksionet e tyre janë të rregulluara më hollësisht me ligj. Karakteri territorial përbën dhe aspektin më thelbësor të tyre. Kjo kërkon që aktet e tyre të kenë fuqi detyruese për të gjitha subjektet, që jetojnë e veprojnë brenda njësisë territoriale, që përfaqëson organi përkatës.

Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.

Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale ekonomike dhe sociale dhe interesave të përbashkëta është njësia ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes

vendore për politikat, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësisve.

### ***BIBLIOGRAFIA***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, e ndryshuar.
- Karta Evropiane e Autonomisë Lokale Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg shkurt 1991.
- Ligji 139\2015 Për vetqeverisjen vendore.
- O. Muçollari Politikat dhe instrumentat e zhvillimit lokal.
- L. Omari, A. Anastasi, E drejta Kushtetuese, Tiranë 20017.
- Strategjia kombëtare e decentralizimit dhe e autonomisë lokale.
- Stability Pact Conference, Fiscal Decentralization in SEE Countries, Case of Albania, 30 September 2006.
- Ligji Nr. 8548, datë 11/11/1999 “Për Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.
- L. Schroeder, L Fiscal Decentralization Policy Studies, The Institute for Public Administration, May 2004.
- Migena Leskoviku, “Strategjia dhe reformat për decentralizimin e pushtetit dhe qeverisjen vendore”, qershor 2005.
- Kval-Mellbye Politika dhe Demokracia, Tiranë 2006.



*PhD.Cand. Gerta GJETA*  
*Fakulteti i Drejtësisë, Pedagoge*  
*Kolegji Universitar "Wisdom"*  
e-mail: gjeta\_gerta@yahoo.com



## **KOSTOT DHE PËRFITIMET E SHQIPËRISË ME ANËTARËSIMIN NË NATO**

## Abstrakt

Në këtë punim bëhen përpjekje për të hedhë dritë mbi kostot, që paguan vendi ynë për anëtarësimin në NATO, por edhe përfitimet që vijnë shtetit tone nga anëtarësimi. Çështja e kostos së anëtarësimit në NATO është një çështje pak e diskutuar, kryesisht në sferat e larta të shtetit dhe në rrethin e ngushtë të specialistëve. Ndërkohë që mediat i kushtojnë më shumë vëmendje problemeve politike, çështjeve apo aspekteve të tjera që kanë të bëjnë me përpjekjet për integrimin në NATO dhe ceshtjet e sigurisë. Si rrjedhojë, publikut të gjerë i mungon një informacion i plotë jo vetëm në lidhje me kostot por edhe për përfitimet 020.që priten me anëtarësimin e vendit tone në NATO. Anëtarësimi në këtë organizatë solli pervec përfitimeve edhe plotësimin e kushteve dhe detyrimeve të nevojshme. Republika e Shqipërisë para anëtarësimit me të drejta të plota, plotësoi një numër standardesh në disa fusha, përfshirë edhe standardet politike si; reforma elektorale, sundimi i ligjit, forcimi i institucioneve etj. Pikërisht këtë qëllim ka edhe kjo temë: të qartësojë sa të jetë e mundur, kostot financiare që paguajmë si anëtar të Aleancës, të matshme në vlera apo ato të pamatshme numerikisht, si ato politike, legjislativë, ushtarake etj. Nga ana tjetër, ky anëtarësim sjell mbi të gjitha përfitime për sigurinë dhe stabilitetin e qytetarëve të vendit. Këto përfitime nuk janë vetëm ushtarake e në fushën e sigurisë, por në shumë fusha të tjera të jetës së vendit. Problemi i llogaritjes së kostos dhe përfitimit nuk është i thjeshtë, por është mjaft kompleks, pasi ndërthuren shumë faktorë të matshëm dhe të pamatshëm. Gjithashtu, deri tani nuk ka ndonjë udhëzim apo metodë se si të llogaritësh këtë kosto. Mbështetur edhe në analizën që kanë bërë ekspert të huaj, për kostot e anëtarësimit të vendeve të tyre në NATO, kostot që përballohen janë ndarë në kosto direkte ushtarake, dhe kosto indirekte të cilat janë të matshme dhe të evidentuara. Para anëtarësimit, në vendin tonë ishte gjërësisht i përhapur perceptimi i gabuar se përgjegjësia kryesore për integrimin në NATO ishte e Ministrisë së Mbrojtjes. Në fakt detyrimet për



anëtarësimi i përkasin të gjithë segmenteve të Qeverisë dhe spektrit politik në vend, çka kërkon koordinimin e punëve midis të gjithë.

***Fjalë kyçe:** Kosto, përfitim, buxhet, fond i përbashkët, integritim, NATO, etj..*

## **Abstract**

In this paper efforts are made to shed light on the costs, that our country pays for the membership of the NATO, but also the benefits that come to our country from membership. The issue of the cost of NATO membership is a bit controversial, mainly in the high spheres of the country and in the close circle of specialists. Meantime the media pay more attention to political problems, issues or other aspects related to efforts in order to integrate in NATO and security issues. Consequently, the general public lacks the full information not only about the costs but also about the benefits expected with the membership of our country in NATO. Membership in this organization brought benefits and also the fulfilling of the necessary conditions and obligations. The Republic of Albania, before the membership with full rights, met a number of standards in several areas, including political standards such as: electoral reform, rule of law, strengthening of institutions, etc. This subject has this purpose: to clarify, as much as possible, the financial costs we pay as members of the Alliance, measurable in value or those immeasurable numerically, such as political, legislative, military, etc. On the other hand, above all this membership brings benefits to the safety and stability of the country's citizens. These benefits are not only military in the field of security, but also in many other areas of the country's life. The problem of calculating the cost and benefit is not simple, but is quite complicated, as many measurable and immeasurable factors are intertwined. Also, until now, there is no guidance or method of how to

calculate this cost. Based on the analysis made by foreign experts, on the costs of the membership of their countries in NATO, the costs that can be afforded, are divided into direct military costs and indirect costs that are measurable and evidenced. Before the membership, in our country a wrong perception was widespread that the main responsibility for NATO integration was the Ministry of Defense. In fact the obligations for membership belong to all segments of the Government and the political spectrum in the country, which requires coordination of work among all.

*Key words: Cost, benefit, budget, common fund, integration, NATO, etc.,*

## **I. Kostoja e anëtarësimit si kontribut për buxhetin e përbashkët të NATO-s**

### ***1. Buxheti dhe fondi i përbashkët i NATO-s***

NATO është një organizatë ndërqeveritare dhe vendet anëtare në të japin një kontribut të drejtpërdrejtë në buxhetet që administrohet nga strukturat e saj, në përputhje me një formulë të miratuar të ndarjes së shpenzimeve, të përlogaritur saktësisht me aftësinë e tyre paguese. Këto fonde përfaqësojnë një përqindje të vogël të buxhetit të përgjithshëm të secilit prej vendeve anëtare dhe, si rregull i përgjithshëm, mbulojnë shpenzimet e atyre pjesëve të strukturës së NATO-s në të cilat marrin pjesë ata vetë. Për këto fonde, të dhëna në kuadrin e NATO-s, shpesh ndiqet parimi i financimeve të përbashkëta. Projekte mund të financohen edhe në mënyrë të bashkuar, çka nënkupton që vendet pjesëmarrëse mund të përcaktojnë kërkesat, përparësitë dhe rregullsitë për fondet, por është NATO që ruan mbikëqyrjen politike e financiare të tyre. Pjesa më e madhe e burimeve janë të karakterit kombëtar. Kur lind nevoja për shpenzime, zhvillohen diskutime midis vendeve të

afta kontribuese për të përcaktuar nëse do të zbatohet parimi i fondeve të përbashkëta.

Fondet e NATO-s nuk mbulojnë prokurimin e forcave ushtarake ose të mjeteve fizike ushtarake të tilla, si anijet, nëndetëset, aeroplanët, tanket, artilerinë apo sistemet e armëve. Përjashtim nga ky rregull bënë Forca e Zbulimit të Largët dhe e Drejtimit me Patrullim Ajror e NATO-s, një flotë me aeroplanë radarë kënddrejtimgjetës. Kjo sigurohet, zotërohet dhe mirëmbahet, por edhe drejtohet bashkërisht nga vendet anëtare dhe është në vartësinë operative komanduese e drejtuese të një Komandanti të Forcave të NATO-s, që përgjigjet para Komandantëve Strategjikë të NATO-s. NATO, gjithashtu, financon investimet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me kërkesat e përbashkëta, të tilla si mbrojtja ajrore, sistemet e komandimit e të drejtimit ose sistemet e ndërlidhjes së largët të Aleancës. Sigurimi i tyre nuk mund të jetë nën përgjegjësinë e një vendi të vetëm anëtar. Invenstime të këtij lloji kërkojnë mirëmbajtje, ripërtëritje dhe zëvendësim, në përshtatje me ndryshimin e kërkesave dhe të zhvillimeve teknologjike. Mbulimi i këtyre shpenzimeve përfaqëson një pjesë të ndjeshme të fondeve të NATO-s<sup>1</sup>).

Sigurimi i fondeve të përbashkëta i përmbahet disa kriterëve që janë nën një mbikëqyrje të vazhdueshme. Ndryshimet mund të parashtrohen si rrjedhojë e rasteve të reja të jashtëzakonshme, për shembull, nga nevoja për të përcaktuar me përkufizime të qarta ato zëra të shpenzimeve të NATO-s për kundërveprimin ndaj krizave që duhet të mbulohen nga buxhetet ndërkombëtare dhe për të tjerë, që duhet të financohen nga buxhetet kombëtare. Ndryshime mund të vijnë nga zhvillimet organizative ose teknologjike, apo thjesht nga nevoja për të kontrolluar shpenzimet, me qëllim që të plotësohen kërkesat brenda kufizimeve të përcaktuara të fondeve. Përballë këtyre sfidave, parimi i fondeve të përbashkëta mbi bazën e konsensusit mbetet thelbësor në punët e Aleancës. Në organizmat e fondeve të

---

1 NATO Handbook. NATO Public Diplomacy Division, Brussels, 2006, faqe 58.

përbashkëta hyjnë buxhetet civile dhe ushtarake të NATO-s, si dhe Programi i Investimit për Sigurinë i NATO-s. Këto janë të vetmet fonde ku autoritetet e NATO-s vlerësojnë kërkesat dhe përcaktojnë përparësitë në përputhje me objektivat dhe përparësitë gjithëpërfshirëse të Aleancës.

#### ***A. Buxheti civil***

Buxheti civil është formuar mbi një strukturë të bazuar mbi objektiva, që parashtrajnë lidhje të qarta ndërmjet Objektivave Strategjike të NATO-s dhe burimeve të nevojshme për arritjen e tyre. Ai synon të sigurojë fondet për shpenzimet e personelit, shpenzimet operative, investimet kapitale dhe të zbatimit të programeve të kërkuara për realizimin e katër objektivave parësorë dhe të objektivave mbështetës. *Si objektiva paresore do përfshihen:* sigurimi i politikës së planifikimit dhe burimeve, në mbështetje të operacioneve të NATO-s në zonën Euro-Atlantike e më gjerë; drejtimin e politikës për të nxitur e mbështetur përmirësimin e aftësive të Aleancës; mbështetja e këshillimit dhe e veprimtarive bashkëvepruese me partnerët për të forcuar sigurinë dhe për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërcënimeve të reja në zonën Euro-Atlantike; mbështetja për operacionet dhe rolin e NATO-s në forcimin e sigurisë me anë të diplomacisë publike<sup>2</sup>). *Si objektivat e mbështetjes përfshihen:* sigurimi i shërbimeve profesionale dhe mbështetëse për Këshillin e Atlantikut të Veriut, komitetet vartëse dhe Shtabin Ndërkombëtar; funksionimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe vendndodhjes së Shtabit të NATO-s; garantimi i politikës së sigurisë të NATO-s në shkallë të gjerë dhe të një mjedisi të mbrojtur e të parrezikuar për personelin dhe veprimtarinë luftarake të të gjitha shtabeve.

Buxheti civil i NATO-s mbështet stafin civil ndërkombëtar të Aleancës me seli në Bruksel, i cili është përgjegjës për planifikimin e politikave të operacioneve dhe të aftësive, ndërlidhjen me vendet jo partnere të Aleancës, që

---

2 NATO Handbook. NATO Public Diplomacy Division. Brussels. 2006, faqe 59.

synon ndërtimin e mbështetjes ndërkombëtare nëpërmjet diplomacisë publike.<sup>3)</sup> Buxheti civil, gjithashtu ka financuar aspektet e strukturave jo-ushtarake që lidhen me zgjerimin, duke përfshirë programin e Partneritetit për Paqe (PfP) dhe Euro-Atlantik (EAPC), aktivitetet lidhur me Dialogun Mesdhetar, NATO-Rusi, NATO-Ukrainë, si dhe marrëdhëniet me Bashkimin Evropian. Mjetet monetare të buxhetit civil sigurohen kryesisht nga ministritë e jashtme të çdo vendi anëtar, mbikëqyren nga Komiteti i Buxhetit Civil dhe vihen në zbatim nga Shtabi Ndërkombëtar i NATO-s.

### ***B. Buxheti ushtarak***

Buxheti ushtarak mbulon shpenzimet operative dhe ato të mirëmbajtjes së strukturës së Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar. Ky përfshin organizma të tillë si Komitetin Ushtarak, Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar, agjencitë ushtarake, dy komandat strategjike dhe komandat shoqëruese, sistemet e informacionit e të drejtimit, agjencitë e kërkimit e të zhvillimit dhe Forcën e Zbulimit të Largët dhe të Drejtimit me Patrullim Ajror të NATO-s. Buxheti ushtarak mbulon gjithashtu shpenzimet operative të strukturave të komandave për operacionet kundërvepruese ndaj krizave dhe për misionet e ndërmarra nga NATO. Mjetet monetare të buxhetit ushtarak sigurohen kryesisht nga ministritë e mbrojtjes të çdo vendi anëtar, mbikëqyren nga Komiteti i Buxhetit Ushtarak dhe vihen në zbatim nga zotërues individualë të buxheteve.

Buxheti ushtarak i NATO-s është më i madhi i tre buxheteve<sup>4)</sup>. Më shumë se gjysma e këtij buxheti përdoret për të paguar shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes së personelit ushtarak ndërkombëtar me selinë në Mons, Belgjikë dhe komandat vartëse të NATO-s. Niveli i buxhetit ushtarak të NATO-s, rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Këshilli i Atlantikut të Veriut.

3 Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012), faqe 2.

4 Po aty, faqe 2.

### ***C. Programi i Investimit për Sigurinë i NATO-s***

Vendet anëtare të NATO-s japin gjithashtu ndihmesë për Programin e Investimit për Sigurinë të NATO-s (PISN). Ky program mbulon investimet e ndërtimeve kryesore të sistemeve të komandimit e të drejtimit, të nevojshme për të mbështetur detyrat e komandave strategjike të NATO-s, por që janë jashtë kërkesave të mbrojtjes kombëtare të vendeve të veçanta anëtare. Si buxheti ushtarak dhe PISN-ja, udhëhiqen nga parimi “veçmas”: “Fondet e përbashkëta do të përqendrohen në sigurimin e kërkesave të cilat janë veçmas atyre, që në mënyrë të arsyeshme mund të pritët që të vihen në dispozicion nga burimet kombëtare”<sup>5</sup>). Mjetet monetare të PISN-së sigurohen nga ministritë e mbrojtjes të çdo vendi anëtar dhe mbikëqyren nga Komiteti i Infrastrukturës. Projektet zbatohen ose nga vende mike të veçanta, ose nga agjenci të ndryshme të NATO-s dhe nga komandat strategjike, sipas fushës së kompetencës së tyre.

Njohur dikur si Fondi i Infrastrukturës të NATO-s, ky program në të kaluarën ishte përgjegjës kryesisht për financimin e instalimeve ushtarake dhe projekteve të ndërtimit. Në maj 1993, funksionet e Programit u ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme për të reflektuar politikën e sigurisë të Aleancës të post-Luftës së Ftohtë duke u njohur që nga dhjetori 1994 si Programi i Investimeve të Sigurisë të NATO-s (PISN)<sup>6</sup>. Sot përfshin financimin e një shumëllojshmërie të gjerë të funksioneve mbështetëse kolektive të NATO-s, duke përfshirë për shembull komandimin, kontrollin, komunikimin, dhe informacionin (hardëare dhe softëare); mbikqyrjes dhe zbulimit të aftësive; aktivitetet logjistike; porte dhe aeroporte; instalimet, trajnimin, transportin; objektet e magazinimit për pajisje, karburant dhe municione. Puna e këtij Programi menaxhohet nga Komiteti i Infrastrukturës të NATO-s,

5 NATO Handbook. NATO Public Diplomacy Division. Brussels 2006, faqe 60.

6 Carl Elk, “NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues” (Washington: Congressional Research Service, 2012), faqe 3.

dhe projektet individuale janë zbatuar nga vendet pritëse, agjencitë apo komandat e NATO-s etj<sup>7)</sup>.

#### ***D. Ndarja e kontributeve për fondet e përbashkëta***

Siç e përmendëm më sipër, tre buxhetet e përbashkëta të NATO-s financohen nga kontributet e të gjithë vendeve anëtare. Ashtu si të gjitha vendimet e tjera të NATO-s, marrëveshjet e ndarjes së fondeve (burden sharing) bazohen në konsensusin midis anëtarëve<sup>8)</sup>. Në vitin 1955, Aleanca ka përcaktuar se në të ardhmen kontributi i secilit vend do të jetë i bazuar në shpenzimet e saj mesatare të fundit për buxhetet civile dhe ushtarake, dhe gjithashtu ato ranë dakord që të mos i rishikojnë kontributet çdo vit. Që atëherë, kontributet relative të vendeve për buxhetin civil, kanë mbetur të pandryshuara.<sup>9)</sup>

Kontributet për Programin e Investimit për Sigurinë të NATO-s janë rishikuar më shpesh. Ndryshimet janë bërë përmes negociatave, por shkaqet e plota për rishikimet e tij, nuk janë bërë publike. Për të arritur një shpërndarje të drejtë të kontributit për këtë Program, vendet e Aleancës kanë marrë në konsideratë disa faktorë: kapacitetin e anëtarëve për të paguar; përfitimet që rrjedhin tek anëtarët individual nga përdorimi i projekteve të PISN; përfitimet ekonomike të ndërtimit të këtyre projekteve në vendet anëtare; kontributet e sigurisë jo-infrastrukturore të bëra nga vendet individuale; faktorë të ndryshëm politikë dhe ekonomikë<sup>10)</sup>. Megjithatë, në fillim të vitit 2004, anëtarët evropianë të Aleancës, ranë dakord të standardizojnë përqindjet, që secili komb pjesëmarrës kontribuon për buxhetin ushtarak dhe PISN.

7 U.S. Department of Defense. Military Construction Program. FY2012 Budget. North Atlantic Treaty Organization Security Investment Program. Justification Data Submitted to Congress, February 2011, faqe 3.

8 North Atlantic Treaty Organization. NATO Office of Information and Press. NATO Handbook. Brussels, Belgium, 2001, faqe 204.

9 Po aty.

10 Po aty.

Kur kontributet e ndarjes së kostove janë negociuar, Aleanca ka marrë në konsideratë 'përgjegjësitë e Shteteve të Bashkuara për sigurinë në mbarë botën'. Për shembull, në vitin 2003 SHBA jepte 23.8% të kontributit për PISN, jo shumë larg me 19.8% të Gjermanisë. Por, në të njëjtin vit, GDP e SHBA ishte 10,3 triliardë \$, ndërkohë që shuma e GDP-së të 18 aleatëve të tjerë të NATO-s ishte 8,9 \$ triliardë \$. Nëse vlerësimi për kontributin e fondeve të përbashkëta të NATO-s, do të ishte bazuar vetëm mbi GDP, pjesa amerikane në vit do të kishte qenë 53.6% dhe ajo e Gjermanisë do të kishte qenë 9.8% <sup>11)</sup>. Përveç kësaj, analistët e politikave kanë argumentuar se pjesëmarrja në Aleanca kursen para. "Për të arritur në një përfundim kuptimplotë" mbi kostot që i përkasin Aleancës, "secili vend anëtar do të duhet të përfshijë të gjithë faktorët në llogaritjen e shpenzimeve me të cilat do të përballesh, me kalimin e kohës, në hartimin e dispozitave për sigurinë e saj kombëtare, i pavarur ose përmes formave alternative të bashkëpunimit ndërkombëtar"<sup>12)</sup>.

Megjithatë, madhësia e përgjithshme dhe kontributet individuale të vendeve anëtare në buxhetet e përbashkëta kanë qenë subjekt i diskutimeve në vitet e fundit. Para zgjerimit të vitit 1999, analistët vlerësuan koston e shtuar të këtij zgjerimi ndërmjet 10 dhe 125 miliard \$, në varësi të skenarëve të kërcënimeve. Disa anëtarë të Kongresit Amerikan, shprehën shqetësimin mbi këto kosto të parashikuara dhe ishin të shqetësuar gjithashtu, se Shtetet e Bashkuara mund të mbanin mbi supë një pjesë të madhe të shpenzimeve. "Ata pyetën nëse marrëveshjet ekzistuese për ndarjen e kostove duhet të vazhdojnë dhe sugjeruan, që aleatët evropianë duhet të inkurajohen për të marrë përsipër një pjesë të madhe të shpenzimeve financiare për sigurimin e kontinentit"<sup>13)</sup>

11 Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012), faqe 6.

12 North Atlantic Treaty Organization. NATO Office of Information and Press. NATO Handbook. Brussels, Belgium, 2001, faqe 202.

13 Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012), faqe 7.



Në përgatitje për samitin e Bukureshtit në prill të vitit 2008, ekspertët e NATO-s përgatitën vlerësimin e përgjithshëm të koston dhe kosto-sharing nga implikimet e një raundi të ri të zgjerimit. Ekspertët arritën në përfundimin dhe Aleatët e pranuan jozyrtarisht, se metodologjitë dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar kostot dhe rregullimet për ndarjen në raundet e mëparshme të zgjerimit ishin ende të vlefshme dhe se shtimi i anëtarëve të rinj në vitin 2009 nuk do të shkaktonte shpenzime të konsiderueshme. Shpenzimet kryesore të ngarkuara drejtpërdrejt në buxhetin e përbashkët ushtarak të aleancës do të jenë kryesisht për përmirësimet e mbrojtjes ajrore, të disa objekteve (kryesisht fushat ajrore për dislokimin), dhe prokurimin e komunikimeve të sigurta ndërmjet selisë së NATO-s në Bruksel dhe Mons dhe kryeqyteteve të vendeve të reja anëtare. ”<sup>14)</sup>

Plani i rishikuar i ndarjes së kostove është prezantuar në janar 2006 dhe po zbatohet gradualisht gjatë një periudhe 10-vjeçare tranzicioni. Pas shqyrtimit shtesë, stafi i NATO-s rekomandoj në mesin e vitit 2006, që ndarja e kostove në të ardhmen të marrë në konsideratë edhe disa faktorë të tjerë përveç të ardhurave mesatare për frymë, duke përfshirë sigurimin e stafeve kombëtare për aktivitetet operationale kritike të NATO-s dhe nivelin e stafit në NATO. Është rekomanduar që çdo dy vjet, NATO të rishikojë kontributin e secilit vend në operationet e NATO-s për katër vitet e shkuara dhe të bëjë rregullimet e nevojshme përfundimtare të ndarjes së kostove, sipas këtij kontributi.<sup>15)</sup> Përveç kësaj, gjatë takimit të tyre në shkurt të vitit 2010, ministrat e mbrojtjes të NATO-s miratuan masat që synonin balancimin

14 NATO Common Funding. New Cost Share Arrangements For Civil Budget, Military Budget and NATO Security Investment Program and Review of Burden Sharing Arrangements. NATO Senior Resource Board. Memorandum. July 22, 2005. Shih: Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012).

15 Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012), faqe 7.

e buxhetit të Aleancës dhe gjithashtu "të përkushtuar për të injektuar burime shtesë në buxhetin e këtij viti, si dhe për të modernizuar buxhetimin e NATO-s e për të parë mundësinë e kursimit ku ajo mundet"<sup>16</sup>).

Gjatë Samitit të nëntorit 2010 në Lisbonë, shtetet anëtare të NATO-s ranë dakord për sigurimin e një kapaciteti të ri: mbrojtjen balistike nga raketat. Sekretari i Përgjithshëm Rasmussen deklaroi se plani i mbrojtjes territoriale nga raketat do të kushtojë rreth 200 milion euro (rreth 270 milion \$) për një periudhë 10 vjeçare. Ky fond është karakterizuar si një shpenzim shtesë për përmirësimin e programit ekzistues të Aleancës-ALTBMD (Active Layered Teatri Ballistic Missile Defense) program, i cili pritet të kushtojë rreth 800 milion euro (rreth 1 miliard \$) dhe do të zgjasë mbi 14 vjet<sup>17</sup>. Shpenzimet për të dy programet do të përballohen nga të gjitha shtetet anëtare, dhe do të financohen nga buxheti i përbashkët i NATO-s.

## **II. Kontributi i vendit tonë në buxhetet e Aleancës**

Shqipëria, si gjithë vendet e tjera që kanë hyrë në NATO, është ndeshur me disa probleme në fushën e mbrojtjes në mënyrë që të arrijë standardet e Aleancës, si: kapacitete dhe burime të pamjaftueshme për të ndërvepruar me aleatët, stërvitjeje dhe aftësie reaguese. Kështu që kontributi i saj ushtarak para anëtarësimit, sipas ekspertëve ushtarake do të jetë në nivel minimal, buxhet i kufizuar mbrojtjeje, si pasojë e nivelit ekonomik të vendit, mungesë e kapaciteteve ushtarake për të vepruar në mënyrë të pavarur në misione paqeruajtëse në botë etj. Për të realizuar reformat e nevojshme në fushën e mbrojtjes, duhet që të arrihet një konsensus politik afatgjatë

---

16 Allies Agree Budget Package. February 5, 2010. NATO website. [http://www.nato.int/cps/en/SID-51C82DB3-2C65FB8E/natolive/news\\_61313.htm](http://www.nato.int/cps/en/SID-51C82DB3-2C65FB8E/natolive/news_61313.htm).

17 Sekretari Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen: "NATO Needs a Missile Defense," New York Times, 12 tetor 2010.

midis forcave politike, me qëllim që të merren parasysht kostot relativisht të larta për ekonominë e dobët të vendit. Në të vërtetë, përvoja e përket anëtarësimit në NATO, forcat politike të vendit tonë gjithmonë kanë arritur konsensusin pa ndonjë dallim thelbësor për këtë çështje.

Në kostot direkte ushtarake, përfshihen të gjitha kostot e lidhura direkt me integrimin në Aleancë, së bashku me reformat që do të kryhen në sektorët e mbrojtjes e të tjerë, për të arritur kapacitetet optimale për të ndërvepruar me strukturat e NATO-s dhe për të siguruar kontributin e vendit për detyrën e mbrojtjes kolektive dhe misionet e reja të NATO-s. Këto kosto janë: kostoja e anëtarësimit për buxhetin e përbashkët të NATO-s; kostoja e lidhur me përfaqësimin civilo-ushtarak në strukturat e NATO-s; kostoja e lidhur me angazhimin e trupave tona në operacionet e përbashkëta; kostoja e pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta të NATO-s (stërvitje të përbashkëta, konferenca, seminare etj); kostoja për të realizuar modernizimin dhe ristrukturimin e Forcave të Armatosura në përputhje me standardet e NATO-s; kostoja për zhvillimin dhe përshtatjen e infrastrukturës dhe territorit, si dhe kostoja e lidhur me rregullimet ligjore, proceduriale dhe organizative.

Pavarësisht se për shumicën e vendeve anëtare të NATO-s, kontributi për të tre buxhetet nuk e kalon 0,5% të buxhetit të mbrojtjes të vendit, përveç të ardhurave për frymë të popullsisë, në çdo dy vjet llogaritet edhe kontributi që jep vendi në operacionet e drejtuara nga NATO. Siç dihet, pavarësisht se numri i forcave pjesëmarrëse të vendit tonë është i krahasueshëm me vendet e tjera anëtare, krahasuar me numrin e popullsisë dhe PBB, përsëri forcat tona nuk veprojnë plotësisht të pavarura. Nga ana tjetër, buxheti faktik i mbrojtjes i vendit tonë është shumë i vogël në krahasim me PBB dhe për këtë arsye kontributi financiar i vendit tonë në fondet e përbashkëta të NATO-s, është më i lartë se 0,5 % që paguajnë mesatarisht vendet e tjera anëtare.

Në tabelën e mëposhtme jepet në % sasia e kontributit të vendit tonë në buxhetet e NATO-s. Për arsye të zbatimit të

të njëjtave formula, shihet qartë se ndryshimi i kontributit të vendit tonë në tre buxhetet, për këto tre vite të marra në shqyrtim, është i vogël. Ky ndryshim vjen kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave për frymë të vendit tonë gjatë këtyre viteve dhe frenimit të kësaj rritje në vendet e tjera, për arsye të vazhdimit të krizës financiare globale që po kalojnë të gjitha vendet e zhvilluara.

**Tabela 1.1: Kontributi i vendit tonë në % të totalit për tre buxhetet e NATO-s<sup>18)</sup>.**

Nr.	Viti	Buxheti Civil	Buxheti Ushtarak	Programi Investimit
1	2012	0.0833	0.0652	0.0843
2	2013	0.0903	0.0685	0.0911
3	2014	0.0987	0.0669	0.1015

Gjithashtu, ngritje ka pësuar edhe kontributi në % që paguan vendi ynë në buxhetin civil, për arsye të shtimit të numrit të personelit civil të vendit tonë në strukturat e NATO-s, si dhe Programi i Investimeve të Sigurisë të NATO-s.

## ***II.1 Kosto e trupave tona ushtarake të angazhuara në operacionet e përbashkëta***

Detyrimi kryesor i vendeve anëtare të NATO-s dhe që përbën dhe pjesën kryesore të kostos së anëtarësimin në Aleancë, është pjesëmarrja e trupave në operacionet e përbashkëta të NATO-s jashtë vendit. Mbas vitit 1990, Aleanca përcaktoi një koncept të ri strategjik dhe nisi një veprimtari të dendur partneriteti me vendet e tjera, përfshirë kundërshtarët e mëparshëm dhe hapi dyert për anëtarësimin e vendeve të reja. Për më tepër, për herë të parë, NATO ndërmori detyra paqeruajtëse në zonat e konfliktit jashtë Aleancës,

18 Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2010)

duke hapur shtegun drejt një roli udhëheqës në operacionet shumëkombëshe të administrimit të krizave dhe në zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me organizata të tjera.

Shumica e trupave ushtarake dhe pajisjeve të vendeve anëtare pjesëmarrëse në operacione, janë nën kontrollin e komandave kombëtare, por ato mund të vihen edhe në dispozicion të NATO-s për detyra speciale, që përputhen me objektivat e Aleancës. Por, shpenzimet për mbajtjen e trupave dhe pajisjeve ushtarake, stërvitjen, pagat etj, financohen nga buxhetet e mbrojtjes të çdo shteti anëtar.

*Objektivi i Shqipërisë është që të ketë në dispozicion të NATO-s për misionet e drejtuara nga ajo rreth 40% të trupave të saj tokësore, prej të cilave rreth 8% duhet të jenë jashtë vendit në çdo kohë me mision. FA kanë filluar misionin e parë më 09 Shtator 1996, në Bosnje-Hercegovinë. Që nga ajo periudhë, numri i trupave pjesëmarrëse në operacionet e mbështetjes së paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione. Misionet që kanë përfunduar me sukses deri tani dhe në të cilat ka marrë pjesë vendi ynë janë: Irak, Gjeorgji, Cad Afrike, ISAF-Afganistan, KFOR Kosovë dhe ALTHEA Bosnje-Hercegovinë, si dhe në shtabin e SEEBRIK-ut, Kabul dhe Herat, Kandahar<sup>19</sup>.*

*Për të gjithë trupat tona në mision, vendi ynë paguan aktualisht një kosto vjetore rreth 7,5 milion \$ në vit, një nga shifrat më të larta që ka shpenzuar ndonjëherë vendi ynë për anëtarësimin në Aleancë, që kur kanë filluar misionet nga Forcat tona të Armatosura. Objektivi është që gradualisht të rritim kontributin me trupa tokësore nga 8% dhe të paguhet plotësisht kostoja operacionale e këtyre trupave. Ky objektivi do të realizohet kur forcat tona do të jenë të afta të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur, pra të veprojnë në mënyrë autonome, duke rritur ndërveprimin me njësitë e tjera të NATO-s, si dhe kapacitetet operacionale. Kostoja për*

---

19 Politika e angazhimit dhe pjesëmarrja e FARSH në misione paqeruajtëse <http://www.mod.gov.al/index>

*këtë detyrë parashikohet që në fund të periudhës afat mesme të arrijë në rreth 1.7 miliard lekë në vit.*

Në dokumentin e Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes, miratuar me VKM Nr. 269, datë 03.04.2013 është përcaktuar dhe objektivi për mbështetjen e paqes dhe të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Për përmbushjen e tij, ato përgatiten për të kontribuar me kapacitetet përkatëse në misionet për menaxhimin e krizave dhe ato të mbështetjes së paqes. Po ashtu, ato mund të angazhohen edhe në veprimtari të tjera joluftarake, si ato të asistencës trajnuese dhe këshilluese, ndërtimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes, si dhe programet e bashkëpunimit ushtarak. Nivli i ambicies (NiA) për mbrojtjen e vendit në bashkëpunim me forcat aleate, sipas nenit 5, është deri në një brigadë të përforcuar (brigadë *task force*) ose deri tri grup-batalione të përforcuara. Ndërsa, kontributi i RSH-së për mbrojtjen kolektive të territoreve të aleancës, sipas procesit të NDPP<sup>20)</sup>, është një grupim taktik “grup-batalion i këmbësisë së lehtë të motorizuar”<sup>21)</sup>, me angazhim 6 muaj deri në një vit, pa rotacion të mëtejshëm, të konfiguruar sipas misionit. Niveli i ambicies të FARSH për pjesëmarrje në operacione NA5CRO<sup>22)</sup>, jashtë nenit 5, kryhet mbi bazën e konceptit të “një grupimi të vetëm forcash” për NATO/BE/OKB apo koalicione të mundshme, përtej kufijve kombëtarë dhe aleatë. Ky NiA është jo më shumë se tri kompani njëherësh në operacion, me rotacion disaherësh. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të specializuara “Niche”, grupe të forcave speciale/komando, si dhe ekspertë (civilë dhe ushtarakë) trajnues, këshillues, koordinatorë, vëzhgues etj., sipas sistemit të ponderimit të forcës, të pranuar nga aleanca.

20 Paketa e objektivave të kapaciteteve të “Blue Book” të Republikës së Shqipërisë në NDPP (NATO Defence Planning Process).

21 Ky grup-batalion e ka kodin e kapaciteteve INF-MOT-BN, sipas “NATO Capability Codes and Statements”.

22 NA5CRO - Non-Article 5 Crisis Response Operations - janë operacionet jashtë nenit 5 që kryhen nga aleanca në përgjigje të krizave.

## **II.2 Kostoja për përfaqësimin civil dhe ushtarak në NATO**

Cdo shtet anëtar duhet të ketë një përfaqësi të përhershme diplomatike dhe ushtarake në shtabet e NATO-s me qëllim që të realizohet komunikimi efektiv, konsultimet dhe vendim-marrja e përbashkët midis anëtarëve të NATO-s. Kostoja për këtë personel përfshin shpenzimet për rrogat, përfitime të tjera të krahasueshme me nivelin e vendeve të tjera, kostoja për mirëmbajtjen e delegacionit të vendit, si dhe pritjen e misioneve ushtarake të cilat përbëjnë një detyrim kombëtar. Gjithashtu, vendi ynë paguan çdo vit rreth 70 milion lekë qira për ndërtesat ku punon personeli i Përfaqësive Ushtarake të Republikës së Shqipërisë. Për vitet 2010-2015 paguajmë rreth 42 milion lekë çdo vit, për selinë e re të NATO-s në Bruksel. Të gjitha shpenzimet për përfaqësimin civil dhe ushtarak në NATO për vitet 2010-2015, llogariten mesatarisht në 620 milion lekë në vit.

## **II.3. Kostoja për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta të NATO-s**

Këtu përfshihen kostot që lidhen me pjesëmarrjen e vendit tonë në aktivitete të ndryshme të NATO-s, të llojit IPP, në formën e konferencave, seminareve, stërviçjeve të përbashkëta etj. Këto aktivitete realizohen me pjesëmarrjen në një numër të madh komisionesh dhe komitetesh të NATO-s, me personel të kualifikuar. Para anëtarësimit të vendit tonë në NATO, këto aktivitete janë rimbursuar nga NATO deri në 70-80%. Për aktivitetet me NATO-n dhe stërviçjet me trupa, kostoja totale vjetore llogaritet të jetë mesatarisht rreth 350 milion lekë në vit. Në vitet pas anëtarësimit, numri i këtyre aktiviteteve ka rënë në mënyrë të ndjeshme, njëlloj si në vendet e tjera pas anëtarësimit.

## **II.4. Kostoja për zhvillimin e infrastrukturës dhe kryerja e rolit të vendit pritës**

Infrastruktura dhe territori në vendin tonë, rrugët tokësore dhe detare, portet, aeroportet, sistemet e telekomunikacionit,

qendrat operationale, depot e municionit, poligonet e stërvitjes dhe qitjes, rrjetet e furnizimit me energji elektrike etj, duhet të vihen në dispozicion të Aleancës në rast nevojë për misione të ndryshme. Të gjitha kostot për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimet e tipit "mbështetje nga vendi pritës", të cilat duhet të modelohen në përputhje me standardet e Aleancës, do të kryhen nga vendi ynë, me përjashtim të rasteve kur këto objekte paraqesin interes strategjik për Aleancën dhe këto investohen nga fondi i Programi i Investimit të Sigurisë të NATO-s. PISN mund të financojë mbi bazën e interesit deri në 2/3 të investimit në infrastrukturë, sidomos në vendet e reja anëtare.

Pjesë e veprimeve që Shqipëria ka ndërmarrë në pozitën e vendit pritës, me qëllim që të garantojë një vend të sigurtë për vendosjen e trupave të NATO-s në rast nevojë, është eliminimi gradual i municioneve dhe armatimeve të rënda dhe të vjetra kineze dhe ruse, të cilat për shkak të moshës së vjetër dhe gjendjes jashtë standardeve të pranuar nga Aleanca, përbëjnë rrezik për sigurinë dhe besueshmërinë e Aleancës gjatë operacioneve të saj në vendin tonë. Që në vitin 2008, në vendin tonë u përcaktuan rreth 100 mijë ton municione të vjetra e më rrezikshmëri të cilat duhet të shkatërroheshin.

## **II.5. Kostoja për rregullimet ligjore, proceduriale dhe organizative**

Në këtë grup përfshihen të gjithë shpenzimet që lidhen me masat organizative dhe proceduriale, rregullimet e ndryshme ligjore dhe rregullat që duhet të ndërmerren për të siguruar përputhjen me kërkesat, detyrimet dhe standardet e NATO-s, si:

a. Kostoja për përmirësimet konstante në legjislacionin ushtarak në fushën e mbrojtjes, në përputhje me kërkesat për modernizimin e Aleancës, për t'ju përgjigjur sfidave të reja, krizave emergjente etj.

b. Kostoja e programeve për të përmirësuar kontrollin demokratik mbi mbrojtjen nga Qeveria dhe Parlamenti.



Kjo duhet të shoqërohet me shpërndarjen e anëtarëve të parlamentit në aktivitetet e përbashkëta me NATO-n, me qëllim që të rritet interesi i tyre në fushën e politikbërjes dhe vendimmarrjes ligjore. Në të njëjtën mënyrë, parashikohen kosto për përgatitjen nga pikëpamja rregulluese dhe procedurale për diskutim, mbështetje dhe kontroll të dokumenteve bazë strategjike të mbrojtjes nga Parlamenti, me cilësinë e një organizmi suprem për kontrollin demokratik të FA dhe supervisor ligjor i tyre.

c. Ndërtimi i strukturave funksionale organizative, të marra nga eksperiencia e vendeve të përparuara në rajon dhe modelet e NATO-s për proceset e blerjes, kontrollin përkatës dhe strukturat përgjegjëse. Në mënyrë të veçantë ato duhet të përmirësohen në përputhje me praktikat më të mira, duke përcaktuar rregullat e standardizimit, kodimit, cilësisë, autencitetit, rregullat e transportit, magazinimit dhe asgjësimit të armatimit të vjetër.

d. Kostoja për përgatitjen e rregullave, ligjeve, standardeve, procedurave të punës, prokurimit publik të automjeteve, pajisjeve dhe shërbimet për ndërtimin, zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, furnizimin me karburant për mjetet tokësore, detare dhe ajrore, shërbimet për mirëmbajtjen e automjeteve të tilla, nivelin e inspektimit dhe magazinimit në depot ushtarake, rregullat për planëzimin, qendrat e stërvitjes dhe ndërtesat duke i krahasuar me standardet e BE.

e. Kostoja për përmirësimet dhe botimin e rregullave për liçensimin e kompanive nënkontraktore, kontrollin e eksportit për pajisjet dhe armatimin, sigurimin e çertifikatës së origjinës, përcaktimi i mënyrave të paketimit etj.

Hartimi i një tablele përmbledhëse me kostot faktike që paguan vendi ynë për anëtarësimin në NATO është i vështirë, pasi ato ndryshojnë nga viti në vit, mbi bazën e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto, madhësisë së buxhetit të mbrojtjes, % së përcaktuar për tre buxhetet e NATO-s, sasisë së forcave pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta etj. Megjithatë, në rast se bëjmë përpjekje për llogaritjen e kostove se sa na

ka kushtuar anëtarësimi në Aleancë për 1 vit, në mënyrë të përafërt do të llogarisim rreth 16,5 milion \$ amerikane, ose 8 % e buxhetit të mbrojtjes: 2,55 milion \$ për tre buxhetet e NATO-s, 7,5 milion \$ për trupat tona pjesëmarrëse në operacione, 6.2 milion \$ për përfaqësimin civilo-ushtarak dhe aktivitetet e përbashkëta me NATO-n. Këto shpenzime kanë tendencë të rriten deri në 16% të buxhetit të mbrojtjes në periudhën afatmesme, kur të bëhet mbështetja e plotë e trupave pjesëmarrëse në mision, nga vendi ynë. Megjithatë, në rast se përfshijmë edhe shpenzimet për modernizimin, ku vendin kryesor e zë projekti i blerjes së helikopterëve dhe ndërtimi i anijeve në Pashaliman, këto shpenzime përbejnë 35 % të buxhetit të mbrojtjes. “Padyshim që *“Smart Defence”* (Mbrojtje e Mençur)”. fillon brenda vendit.<sup>23)</sup>

## II.6. Kostot indirekte jo ushtarake

Siç u trajtua më lart, anëtarësimi në NATO nuk është thjesht një vendim politik me kuptim të rëndësishëm vetëm për mbrojtjen. Por ka disa dimensione të tjera të integritit në NATO përveçse ndikimeve të kuptuara dhe të nënkuptuara politike dhe ushtarake, të cilat janë pjesë e detyrimeve për një vend në procesin e integritit. Bashkëpunimi ekonomik është një nga aspektet e shprehura drejtpërdrejt nga Marrëveshja e Uashingtonit. Ka një bashkëveprim të ngushtë midis sigurisë dhe bashkëpunimit ekonomik, i përcaktuar qartë që nga Plani Marshall, i cili kishte për qëllim të krijonte një ambient të sigurtë dhe zhvillim ekonomik.

23 Revista Ushtarake, qershor 2012, “Procesi Strategjik – “Smart Defence”- Fjala e Ministrit të Mbrojtjes në konferencën ndërkombëtare “Mbrojtja e Zgjuar”, 27 Prill 2012, faqe 24

Që nga samiti i Lisbonës së nëntorit 2010 dhe më tej në Konferencën e Sigurisë në Munihi në shkurt 2011, gjithnjë e më shumë po flitet e diskutohet për konceptin e ‘mbrojtjes së mençur’. Ky koncept është diktuar nga nevoja e kursimit të fondeve në kushtet e krizës së rëndë globale financiare. Disa nga fushat ku mund të përfitojë vendi ynë në kuadrin e ‘mbrojtjes së mençur janë; shkurtimi i kapaciteteve paralele me strukturat e tjera të sigurisë e shtetit, heqja dhe eliminimi i kapaciteteve të vjetra e të tepërta, bashkëpunimi në nivel rajonal në fushën e emergjencave civile, arsimimit etj

Integrimi në Aleancë nuk mund të kalohet lehtë nga vendet që sapo pranohen, pasi ato duhet të luftojnë ashpër korrupsionin, praktikat autoritare, mosrespektimin e sundimit të ligjit, abuzimin me vullnetin e lirë të votuesve, deformimet në ekonominë e tregut, mosrespektim të të drejtave të pakicave, lirinë e individit dhe të shtypit etj. Integrimi në Aleancë kërkon nga shtetet anëtare vullnet politik dhe kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar reformat, që përkthehen në kosto të shumëfishta, përveçse atyre ushtarake.

### *a. Kostoja politike*

Ka shumë argumente dhe polemika në lidhje me reduktimin e sovranitetit të vendit që bëhet subjekt i vendimeve kolektive për sigurinë dhe që merren nga Aleanca. Megjithatë, ne akoma mendojmë se në rastin e Shqipërisë ky argument llogaritet jo në terrenin e përshtatshëm, pasi sot në kushtet e rreziqeve të shumëfishta për një vend të vogël me burime shumë të kufizuara financiare, për pasojë dhe ushtarake, është e pamundur që të garantohet siguria e vendit duke u mbështetur vetëm në asetet e veta. Një kosto tjetër do të ishte mungesa e mbështetjes publike për partinë në fuqi, si pasojë e angazhimit të trupave tona në zona të rrezikshme të botës, në përbërje të operacioneve të NATO-s. Këto kosto bëhen më të ndjeshme, tepër të rënda dhe të dukshme në rast të vrasjes së ndonjë ushtaraku në operacionet jashtë vendit.

Shqipëria është konsideruar nga organizatat ndërkombëtare si një vend me probleme ligjore dhe institucionale të cilat shpesh derivojnë në luftë të ashpër midis partive në arenën politike të vendit. Plotësimi i standardeve të NATO-s dhe BE për procesin elektoral dhe reformën gjyqësore përbën një kosto shtesë të vendosur nga anëtarësimi në NATO, megjithëse kjo i shërben disa qëllimeve. Reformat e thella në sistemin gjyqësor për të rritur efikasitetin, zbatimin e ligjit, eliminimin e ndërhyrjeve politike dhe rritja e transparencës në sistemin legjislativ përbëjnë kosto të tjera në këtë proces.

### ***b. Kostoja ekonomike***

Pavarësisht sukseseve makroekonomike të një vendi ku një pjesë e popullsisë jeton poshtë nivelit të varfërisë, me disproporcion të thellë në shpërndarjen e pasurisë, me një deficit të lartë të llogarive aktuale që kushtëzohet së tepërmi nga paratë e dërguara nga emigrantët, nuk është e lehtë për Shqipërinë që të angazhojë burimet e saj të kufizuara financiare për sigurinë, për implementimin dhe zbatimin e standardeve të NATO-s. Kosto të tjera mund të jenë ato të lidhura me kryerjen e reformave në përgjithësi, jo vetëm për NATO-n, por edhe për BE. Mund të përmendim koston për ristrukturimin dhe liberalizimin e mëtejshëm të ekonomisë, nxitjen e biznesit, sanksionimi i të drejtës së pronës, privatizimin e ekonomisë, përmirësimet në sistemin e sigurisë shoqërore, reformat në shëndetësi dhe sektorin e arsimit etj. Si pasojë e ushtrimit të kontrollit të rreptë në kufijtë tokësorë dhe detare, do të vazhdojë të reduktohet ekonomia informale (që zë 40-50% të ekonomisë), të ardhurat nga tregëtia ilegale, narkotikët etj, pasi rruga e trafikimit dhe kontrabandës do të pritët. Në realitet, vendi do të humbë një burim të fshehtë të rritjes ekonomike, por do të fitojë një rezultat të rëndësishëm, besimin dhe sigurinë e investitorëve të huaj, integrimin në NATO, bashkëpunimin rajonal dhe anëtarësimin në BE. Për pasojë, kostoja që paguajmë kapërcehet nga një numër i madh përfitimesh të pritshme.

### ***c. Kostoja shoqërore***

Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, trafikimit të armëve, narkotikëve dhe qenieve njerëzore është konsideruar si sfida më e madhe për çdo qeveri shqiptare, pasi përbën një nga problemet më të mëdha shoqërore për vendin. Përkundrejt programeve të mira të qeverive dhe përmirësimeve tepër të ndjeshme, përsëri ajo ka qënë dhe mbetet një betejë e vështirë. Reforma në sektorin e mbrojtjes do të çojë në reduktimin e forcave të armatosura. Në buxhet do të shtohen kosto për pensionet e parakohshme e sigurimet shoqërore për këtë kategori, programe shtesë për riintegrimin e tyre në punë etj.

#### ***d. Kostoja për infrastrukturën***

Siç u përmend më lart, integrimi në strukturat Euro-Atlantike kërkon vendosjen e kushteve të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me vendet e Aleancës në vendin tonë. Përmirësimet në infrastrukturën rrugore, energji, telekomunikacion etj. kërkojnë kosto shtesë. Është e rëndësishme të nënvizohet se të gjitha kostot e pasqyruara më lart, si ato të lidhura me gjyqësorin, zgjedhjet, reformat ekonomike etj. duhet të kryhen nga vendi ynë në mënyrë të pavarur nga kërkesat e NATO-s. Çdo reformë e shprehur në terma monetare shërben gjithashtu për qëllimin e përbashkët për integrimin e shpejtë edhe në BE, për stabilitetin ekonomik të vendit dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. E vetmja gjë e ndryshme është shpejtësia për të realizuar këto ndryshime, prandaj, ne i kemi përcaktuar ato si kosto indirekte për integrimin në NATO.

#### ***Perfundime***

Si konkluzion, mund të theksojmë se anëtarësimi në një organizatë nuk kërkon vetëm përbushjen e kushteve për t'u bërë pjesë e saj, apo vetëm gëzimin e përfitimeve që rrjedhin nga ky anëtarësim, por duhet ndarë edhe përgjegjësia e kontributit për fondet e përbashkëta. Në organizmat e fondeve të përbashkëta hyjnë buxhetet civile dhe ushtarake të NATO-s, si dhe Programi i Investimit për Sigurinë i NATO-s. Këto janë të vetmet fonde ku autoritetet e NATO-s vlerësojnë kërkesat dhe përcaktojnë përparësitë në përputhje me objektivat dhe përparësitë gjithëpërfshirëse të Aleancës.

Përfitimi nga investimet për reformat e NATO-s është i shumëfishtë nëse llogaritim kontributet për stabilitetin në institucione, tërheqjen e investitorëve të huaj, rritjen në sigurinë e vendit dhe rritjen në performancën makroekonomike. Për më tepër ato krijojnë mundësi për përafrim më të madh me BE, pasi shumë kritere dhe parime për integrimin, veçanërisht në fushën politike janë të përbashkëta

dhe plotësojnë njëra-tjetrën duke krijuar sinergji. Kjo është vërtetuar gjerësisht nga eksperiencia e vendeve të tjera, që janë pranuar në NATO dhe në BE gjatë dekadës së fundit, por edhe nga zhvillimet në vendin tonë në këto vite pas anëtarësimit.

Anëtarësimi në NATO sjell përfitime të shumfishta në disa drejtime; në fushën e sigurisë së vendit, pasi krijohet siguri për qytetarët e Shqipërisë, duke qenë pjesë e Aleancës më të fuqishme të globit; praktika ka treguar që anëtarësimi në NATO nuk është domosdoshmërisht garanci për anëtarësimin në BE, ndërsa mungesa e anëtarësimit në NATO, në mënyrë të sigurt nënkupton se nuk mund të bëhesh pjesë e BE; reformat e kryera para dhe pas anëtarësimit në NATO kanë shërbyer si katalizator për ndërmarrjen e reformave politike, ekonomike, institucionale etj. duke i paraprirë, lehtësuar e përshpejtuar procesin e integritimit në BE dhe përparimit të vendit.

NATO është një partner i pazëvendësueshëm dhe një projekt strategjik për të gjitha vendet e rajonit, përjashtuar Serbinë që akoma është e pavendosur. Vendet më të fituara nga anëtarësimi në Aleancë janë vendet e vogla dhe të mesme, sepse vendet e mëdha mund ta garantojnë mbrojtjen dhe sigurinë e tyre më vete, ndërsa vendet e vogla e kanë më të vështirë. Megjithëse në periudhën afatshkurtër, anëtarësimi në Aleancë shoqërohet me rritje të kostos financiare, në terma afatgjatë edhe thjesht në aspektin ekonomik, përfitimet janë shumë më të mëdha, dhe i mbulojnë disa herë shpenzimet e drejtpërdrejta që paguhen për anëtarësimin.

**BIBLIOGRAFIA**

- Allies Agree Budget Package. February 5, 2010. NATO website. [http://www.nato.int/cps/en/SID51C82DB32C65FB8E/natolive/news\\_61313.htm](http://www.nato.int/cps/en/SID51C82DB32C65FB8E/natolive/news_61313.htm).
- Anders Fogh Rasmussen: "NATO Needs a Missile Defense," New York Times, 12 tetor 2010.
- Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2012).
- Center for American Progress What's Next for NATO? Defining a New Role for the Alliance in a Post-Cold War World Lawrence Korb and Max Hoffman May 2012.
- Carl Elk, "NATO Common Funds Burdensharing: Background and Current Issues" (Washington: Congressional Research Service, 2011)
- Fjala e Sekretarit Rasmussen në Asamblene Parlamentare të NATO-s në Pragë. [http://www.mod.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=2108:fjala-e-mbajtur-nga-sekretari-i-pergjithshem-i-nato-s-anders-fogh-rasmussen-ne-asamblene-parlamentare-te-nato-s-ne-prage](http://www.mod.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=2108:fjala-e-mbajtur-nga-sekretari-i-pergjithshem-i-nato-s-anders-fogh-rasmussen-ne-asamblene-parlamentare-te-nato-s-ne-prage)
- Lonard DEMI, Perikli KOLIÇI, "Smart Defense"- gjetje e mençur për rajonin e Ballkanit, Revista Ushtarake, dhjetor 2011.
- "Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë", prill 2013, miratuar me VKM Nr. 269, datë 03.04.2013.
- Oltjana ZOTO, Investimet e huaja direkte në Shqipëri analizë e efekteve, politikave dhe lidhja me rritjen ekonomike, Tiranë 2012.
- North Atlantic Treaty Organization. NATO Office of Information and Press. NATO Handbook. Brussels, Belgium, 2001.
- NATO Handbook. NATO Public Diplomacy Division, Brussels, 2006.
- NATO Common Funding. New Cost Share Arrangements For Civil Budget, Military Budget and NATO Security Investment Program and Review of Burden Sharing Arrangements. NATO

Senior Resource Board. Memorandum. July 22, 2005.

- Sekretari Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen: “NATO Needs a Missile Defense,” New York Times, 12 tetor 2010.
- Rustemi Ruzhdi, Revista Ushtarake Nr. 3/2009, “Për një planëzim realist të kostos të integritit në NATO! Të përgatitemi për një skemë realiste të kontributeve financiare në periudhën afatmesme”.
- Revista Ushtarake, qershor 2012, “Procesi Strategjik – “Smart Defence”- Fjala e Ministrit të Mbrojtjes në konferencën ndërkombëtare “Mbrojtja e Zgjuar”, 27 Prill 2012.
- <http://www.sipri.org/research/armaments/milex/resultoutput/trends>
- U.S. Department of Defense. Military Construction Program. FY2012 Budget. North Atlantic Treaty Organization Security Investment Program. Justification Data Submitted to Congress. February 2011
- United Nations-Albania, “Raporti i investimve të Huaja Direkte, Shqipëri 2011.





**Dr. Jetmira FEKOLLI**

*Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, Pedagoge  
Kolegji Universitar “Wisdom”*

e-mail: [jetmira.fekolli@wisdom.edu.al](mailto:jetmira.fekolli@wisdom.edu.al)



**MA. Diana FEKOLLI**

*Universiteti “Fan S. Noli”, Korce  
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjise*

e-mail: [dianafekolli@gmail.com](mailto:dianafekolli@gmail.com)

## **BURIMËSITË ETIKE TË TË MENDUARIT PSIKOLOGJIK**

## Abstrakt

Në këtë artikull do të trajtojmë historinë e psikologjisë si një formë e të menduarit metodik. Vetëm lidhja e drejtpërdrejtë me etikën është ajo çka si jep psikologjisë të kohëve tona një kuptim thelbësor, ndërkohë që, nga ana tjetër, është po kjo lidhje e etikës me psikologjinë me që na bën të mundur të kuptojmë të menduarit psikologjiktë së shkuarës. Ndërkaq, ky burim na shfaqet i llojeve të ndryshme. Më së pari, ndjesia e habisë shpie në lindjen e pyetjeve dhe në formimin e ideve dhe pikëpamjeve të ndryshme; ndjesia e pasigurisë dhe dyshimi që njeriu ushqen në lidhje me shkallën dhe vërtetësinë e njohurive që ka arritur të përftojë shpije në lindjen e analizës kritike dhe procesit të vërtetimit; frika dhe ndjesia e të qenit i veçantë e shpije njeriun drejt sipërmarrjes për të njohur vetveten. Është e rëndësishme që të përpiqemi ti shikojmë dhe studojmë më nga afër këto tre burime. Për të kuptuar të gjithë këtë, duhet t'i mësojmë fort faktit se komunikimi është qëllimi më thelbësor dhe më parësor i të menduarit psikologjik, dhe se tek komunikimi gjallojnë të gjitha rrënjët e qëllimeve dhe kahjeve të tjera të psikologjisë, të tilla si: ndërgjegjësimi në lidhje me qenien si e tillë, shmangia e ankthit, ndriçimi i shpirtit dhe i ekzistencës njerëzore përmes dashurisë, apo arritja e qetësisë dhe paqes shpirtërore.

***Fjalë kyçe:** Etika, komunikimi, njohja e vetvetes, burimësitë etike.*

## Abstract

In this article we will treat the history of psychology as a form of methodical thinking. Only the direct link to ethics is what gives our psychology an essential meaning, while, on the other hand, it is this link of ethics with psychology that makes it possible to understand the psychological thinking

of the past. Meanwhile, this source appears to us of different kinds. First of all, the sense of astonishment leads to the emergence of questions and the formation of different ideas and views; the sense of insecurity and the suspicion that man feeds about the degree and the truthfulness of the knowledge he has achieved leads to the emergence of critical analysis and authentication process; the fear and the sensation of being special leads the man to entrepreneurship to know himself. It is important to try to look at and study these three sources more closely. To understand all of this, we must stress the fact that communication is the most essential and primordial goal of psychological thinking, and that communicating alive all the roots of the goals and other paths of psychology, such as: awareness about the being as such, the disruption of anxiety, the enlightenment of the soul and of human existence through love, or the attainment of tranquility and spiritual peace.

**Key words:** *Ethics, communication, self-knowledge, ethical resources.*

## **HYRJE**

Zanafilla e mendimit psikologjik gjendet në zhvillimin e hershëm të filozofisë dhe të shkencave të tjera të natyrës. Elementet e para autentike, ku vihen re shpjegimet me natyrë psikologjike hasen që në vëllimet e verpave që u përkasin libra të perandorive arsiane. Brenda e ketyre librave sjell informacion mbi kuptimin e elementeve të tilla si ndjekja,urvejimi, ankthi, stresi, perceptimi dhe element të tjerë konjitiv apo edhe procesi i ëndërrimit të gjumë. Fundi i shekullit të 19-të dhe fillimi i shek të 20-të perkojnë me zhvillimin e psikologjisë si një shkencë e pavarur nga Filozofia dhe shkencat e tjera me të cilat bashkejetoj deri në ato kohë.

Në fakt qenia njerëzore ka lindur me ego e pasijur edhe me etike pasi ajo lind bashkë me instiktin e mbijetesës

dhe të reagimit instiktiv ndaj çdo rreziku të mundshëm të perceptueshëm në moshë të vogël, ndaj çdo mosplotësimi nevoje. Me kalimin e viteve niveli i egos ndryshon në raport me gjendjen kulturore dhe emocionale. Por në persona që kanë inteligjencë pak më të lartë se mesatarja, egoja shërben si një motor shtytës për arritjen e objektivave që i kanë vënë vetes, e në këtë rast egoja është pozitive.

Parë në këtë këndvështrim mund të themi se rëndësia për të studiuar këtë temë është shumë e madhe për të kuptuar se cilët janë kufijtë e njeriut si individ në raport me të tjerët dhe cilat janë burimësitë, objektivat apo qëllimet e pranueshme të moralit në ditët e sotme. Shoqëria moderne duket se çdo ditë e më shumë po përshkrohet nga fryma apo sëmundja e egos. Ego si koncept nënkupton procesin e të reaguarit, pra mund të themi se njëriu është krijuar në këtë botë për të qenë gjithmonë në bashkëveprim me të tjerët, sepse jashtë marrëdhënieve me të tjerët ai e ka të vështirë të jetojë, kështu që humanizmi i tij është pasojë e të jetuarit mes njerëzve. E dimë se bota e marrëdhënieve me të tjerët është kusht për ekzistencën e individit. Sepse njeriu rritet, zhvillohet, edukohet dhe formon personalitetin e tij në marrëdhënie me të tjerët. Psikologu i famshëm Adler thotë: *individit që nuk interesohet për të tjerët has në jetë vështirësi të mëdha dhe është ai që dështon më shpesh në qëllimet e tij.*

Në shoqërinë e ditëve të sotme ekziston një pabarazi që të çon në rënie të etikës dhe në moskuptimin e burimësive të etikës. Duke u nisur nga kjo lindin debate të forta mbi ndjenjat e inferioritetit apo superioritetit që japin efekte tepër të forta psikologjike dhe sociale. Kjo mund të shkojë në çift me respektin apo mosrespektin në momentin që njerëzit shikohen nga lart. Prandaj edhe dhuna është më e pranishme dhe familjare në shoqëritë me më pak barazi sociale. Dhuna shpërthen më tepër tek njerëzit që ndihen të demoralizuar dhe të parespektuar. Sa më shumë rritet pabarazia aq më shumë shohim të rriten edhe fenomenet negative sociale si krimi, dhuna, sëmundjet mendore etj. Sot njihet gjithnjë e

më shumë se stresi kronik ka një influencë përcaktuese në shëndetin tonë, çfarë të bën të shkosh tek ajo që është edhe më e rëndësishme, se cili është burimi i këtij stresi. Kjo është cilësia e marrëdhënieve sociale. Dhe, nëse ka një faktor që ul këtë cilësi është pikërisht shtresëzimi socioekonomik i shoqërisë. Shkenca na mëson që pavarësisht nga pasuria materiale, stresi lidhur me jetën në një shoqëri të shtresëzuar çon drejt problemeve të shëndetit fizik dhe psikologjik. Në fakt, politikat socioekonomike dhe mungesa e njohurive për etiken dhe moralin në shoqërinë tonë duket sikur janë prodhuesi më i madh i dhunës, krimit, luftës, varfërisë, shkatërruesi më i madh i mjedisit apo i ekosistemit, prodhuesi më i madh i mbeturinave, i shpërdorimit dhe i ndotjes, i keqtrajtimit të kafshëve dhe humbjes së humanizmit, krijuesi më i madh i sëmundjeve mendore, depressionit, ankthit, stresit personal, pa harruar burimin më të madh të paralizimit social që na ndalon të avancojmë drejt teknologjive dhe metodave të reja për shëndetin personal, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë sonë.

Mbi gjithë këtë arsyetim ajo çka mendoj se ka shumë rëndësi të studiohet lidhur me këtë femomen është edhe evoluimi i mendimit psikologjik mbi etikën lidhur me egon si sjellje e natyrës njerëzore. Historia e shoqërisë njerëzore na tregon se struktura dhe funksionimi i pjesëve përbërëse të saj kanë pasur një evolucion që padyshim ka influencuar në mënyrë direkte te egoizmi si sjellje e njeriut në raport me veten dhe mjedisin që e rrethon. Ajo cka është e rëndësishme është të theksohet se komunikimi duhet të shërbejë sio njuë urë lidhese qartësie midis etikës dhe evoluimit të mendimit psikologjik mbi influencën të individit.

### ***1. Burimësitë dhe parimet morale në ditët e sotme***

Zakonisht, të gjithë e pranojnë, që peruidha në të cilën po jetojmë është e përfshirë nga një krizë etike dhe morale e gjithanshme, që prek marrëdhëniet e individit me grupet, komunitetet dhe institucionet, por edhe marrëdhëniet e

komuniteteve mes tyre. Njerëzit s'e kanë për gjë të pranojnë se ajo çfarë i motivon në jetën e përditshme është egoja vetem në përfitim të interesit të tyre personal; dëshira për t'u pasuruar dhe për të dominuar; gatishmëria për të shkelur ligjin nëse kjo mund të bëhet duke i shpëtuar dënimit; gatishmëria për të përvetësuar pasurinë dhe pronën e të tjerëve, duke përfshirë shtetin dhe institucionet. Rusoi dhe Motenskje u morën shumë me shpjegimin e kuptimit të termit moral, pasion. Ajo çka nënkuptohet është fakti që Rusoi e lidh dhembshurinë me pasionin dhe moralin. Njerëzit e diteve të sotme shpeshherë mendojnë se nëse ndihmojmë ata që nuk janë edhe aq mirë ekonomikisht, në një mënyrë të drejtpërdrejtë duhet të nderohemi për atë që kemi bërë ndaj atyre që s'kanë shumë mundësi ekonomike. Për më tepër, ne mund t'i admirojmë ata që ndihmojnë të tjerët, ata që sakrifikojnë diçka nga vetja për të ndihmuar të tjerët (një nder ky që në fund të fundit i bën ata që ndihmojnë të ndihen mirë). Adleri nga ana tjetër jep te njejtin argument te cilën e përkrah dhembshurinë ndaj të tjerëve për shkak të efekteve që ka, por edhe për atë se sa na ndihmon neve që të ndihemi mirë, pra ne nuk korruptojmë asgjë dhe sërish ndihemi mirë. *Arsyeja se pse kujdesi ndaj të tjerëve është një ndjenjë që e pëlqejmë nuk është sepse na detyron parimi ynë moral të veprojmë në atë mënyrë, por sepse na fal një kënaqësi të madhe neve si individë kur kujdesemi për të tjerët.* Arsyeja pse ne ndiejmë kënaqësi vjen nga fakti se ne vetë nuk vuajmë në atë mënyrë sa disa persona që nuk kanë fatin tonë mund të vuajnë, dhe ndihemi të fuqishëm kur shkojmë në ndihmë të tyre një lloj kënaqësie në vetvete. Duke parë se nuk vuan nga asgjë, individit në mënyrë indirekte. Sipas psikologjise edhe pse fillimisht ndiejmë keqardhje kur një qenie tjetër vuan, ne sërish ndiejmë fillon edhe ndihet mirë për veten e tij<sup>1</sup>). Kurse Emile i shijon si ndjenjën e keqardhjes ashtu edhe

1 *Emile: or On Education (Includes Emile and Sophie, or the Solitaries)*. Translated by Christopher Kelly and Allan Bloom. Lebanon, NH: Dartmouth College Press, 2009. Fq 382.

atë të kënaqësisë kur përballet me raste të ngjashme. Ai e shijon pozitën e tij dhe nuk do të donte kurrsesi të ndërronte vendet me një persosn më të dobët i cili vuan, edhe pse ndjen kënaqësi kur shkon në ndihmë të tyre. Megjithatë, duke ndihmuar të tjerët, ne dalim jashtë kornizave tona. Siç edhe e kemi parë, ky fenomen, që gjendet vetëm në shoqëri në prani të njerëzve të tjerë, mund të ketë pasoja shkatërruese. Për shembull, shfaqja e *amour-propre* (dashurisë ndaj vetes) mund të na çojë drejt formave negative të egos.

## **2. Këndvështrimi i Ayn Rand për etiken dhe burimet e saj në raport me egon e njeriut.**

Mendimi im , në thelb, është koncepti i njeriut si qenie heroike, lumturia si qëllim moral i jetës dhe aktiviteti i tij produktiv i arsyes absolute.“ thekson - Ayn Rand<sup>2)</sup>. Shfaqja e tematikave të forta të Rand-it (si kundër besimit dhe trillit), vetëinteresit (si kundër vetësakrificës), individualizmit dhe të drejtave individuale (si kundër kolektivizmit dhe “të drejtave të grupit”) dhe kapitalizmit (si kundër të gjitha formave të statizmit) e bëjnë atë një ndër psikologet më të diskutueshme dhe më të rëndësishme të shekullit të 20-të.

Ayn Rand ishte një mendimtare e njohur e shekullit të 20-të. Fillimisht nga Rusia, Rand u bë një qytetare amerikan dhe u përfshi aktivisht në politikë në jetën e saj të mëvonshme. Ajo ishte një mbështetëse e fortë e egoizmit etik. Ajo deklaroi se individët kanë të drejtën morale për të bërë atë që u sjell dobi. Ajo gjithashtu mbrojti egon racionale dhe deklaroi se është racionale që një individ të veprojë për interesin e vet. Rand gjithashtu mbrojti praktikën e mendimin se etika gjendet në të gjitha sferat e jetës. Ajo tregoi se etika në raport me egon mund të zbatohet, sepse ajo kërkon shikimin e fakteve rreth jetës. Njerëzit janë të pajisur me aftësinë për të marrë vendime të duhura për të ndërmarrë veprimet më të mira. <sup>3)</sup>.

2 <https://www.aynrand.org/>

3 Shaver, R. (2009). Rational egoism. Cambridge University Press

Etika për Rand është një grup vlerash që udhëheqin njeriun në zgjedhjet që ai bën dhe veprimet që ai ndërmerr. Në arenën politike, Rand përkrah kapitalizmin *laissez faire* kur e sheh atë si moral. Nevoja për politikë në jetën e njeriut është e pashmangshme, njeriu natyrisht është grup social dhe ka një tendencë për të siguruar që ekziston një lloj organizimi që shërben si udhërrëfyes për menaxhimin e shoqërisë. Ndërveprimi social mund të jetë i dobishëm për njeriun, por nuk është një garanci se gjithë ndërveprimi do të sjellë përfitime<sup>4)</sup>. Për shembull ndërveprimi për qëllime të tregtisë është i dobishëm, por bashkëveprimi shoqëror për grabitje ose vrasje nuk është i dobishëm.

Rand thotë se qeniet njerëzore natyrisht kanë nevojë për një lloj politike në shoqërinë e tyre. Sistemi politik do të veprojë si një përcaktues i ndërveprimit social që është i dobishëm për njeriun. Përmes politikës kushtet e jetesës së njeriut sigurohen të jenë më të dobishme sesa të dëmshme. Morali i njeriut bazohet në mendimin, veprimet dhe jetën e një individi. Thelbi i politikës në shoqëri duhet të përcaktojë kushtet që janë të dobishme për njeriun nga ato që janë të dëmshme<sup>5)</sup>.

### - ***Shpjegimi i altruizmit sipas Ayn Rand***

Ajo kundërshtoi fuqishëm altruizmin etik sipas të cilit filozofia mbështet individët që të vendosnin detyrimin e tyre për të shërbyer dhe ndihmuar të tjerët. Sipas saj, parimet e altruizmit lidhen me kuptimin se njeriu nuk duhet të ekzistojë vetëm për të mirën e vet, por për të mirën e të tjerëve. Ai duhet, pra, të përpiqet t'u shërbejë të tjerëve dhe ky duhet të qëndrojë si i vetmi justifikim për ekzistencën e tij ose të saj. Filozofët e altruizmit sipas Rand thonë se, njeriu nuk ka të drejtë të ekzistojë nëse ai nuk është në gjendje t'i ndihmojë

---

4 Petman, J. (2008). Egoism and altruism? The politics of the great balancing act. Retrieved from <http://www.helsinki.fi/nofo/NoFo5Petman.pdf>

5 Rabate, J. (2001). James Joyce and the politics of egoism. Cambridge University Press



të tjerët. Rand kundërshton filozofinë e altruizmit sepse beson se kjo çon në shkatërrim dhe duke e lënë individin me një ndjenjë të ndërtuar pa përmbushur ideologjitë e tij . Në politikë altruizmi çon në statizëm kolektivist. Kjo është ajo ku shoqëria këshillohet të përqëndrohet në atë rol që do të çojë në të mirën e përgjithshme të shoqërisë, në vend që të përfitojë personalisht.

Megjithatë, egoizmi etik ndalon një nga angazhimet në veprime morale që mund të çojnë në dëm të interesit dhe mirëqenies së individëve të tjerë në shoqëri. Egoisti etik mund të jetë egoist në përmbushjen e nevojave të tij individuale, por nuk mund të kryejë akte që do të çojnë në vuajtjen e të tjerëve.

- *Nevojat personale kundrejt nevojave të shoqërisë*

Debati mbi një vendim për të ndjekur interesin e vet, për të ndjekur interesin që do të përfitojë nga nevojat e përgjithshme të shoqërisë më të madhe është i diskutueshme. Nëse shoqëria lejohet të jetë individualiste dhe kështu të përqëndrohet në interesin e vet, do të ketë pabarazi në rritje sepse të pasurit do të ishin më dominues në mjedisin ekonomik dhe social sesa klasa e mesme dhe të varfërit. Format e tilla të pabarazisë në shoqëri do të ishin të dëmshme për zhvillimin e një shoqërie <sup>6)</sup>. Nga ana tjetër, nëse një shoqëri vendos të përqëndrohet në të mirën publike dhe barazinë dhe të injorojë interesin individual të njerëzve, do mund të çojë në ndjenjën e sakrifices. Njeriu jeton në mënyrë të pandërprerë në projekte dëshirash mbi të cilat ka njohuri dhe është i ndërgjegjshëm se anon dhe vihet plotësisht drejt arritjes së tyre. Tërheqja pas dëshirës shkakton ndjenjën e nxitjes e të luhatshmërisë në vrapin pas kënaqjes së saj. Njeriu vuan nga frustracionet e veta që lindin nga etja për të arritur aty ku dëshirat plotësohen e më pas lind nevoja për dëshira të tjera që ofrohen në hapësirën shpirtërore e

---

6 Rabate, J. (2001). James Joyce and the politics of egoism. Cambridge University Press

fizike. *Mendimi Rand* nxit individët që të përpiqen të kënaqin interesat e tyre. *Megjithatë, ata theksojnë se kënaqësia e interesit të një personi nuk duhet të jetë në kurriz të të tjerëve.*

### ***3 Elementi komunikim në raport me kuptimin e burimesive të etikës sipas mendimit psikologjik.***

Liria pa kufi e të folurit në rrethana të ndryshme shoqërore e ka të domosdoshme etikën. Vetë komunikimi nuk mund të konceptohet pa elementin e etikës. Ajo është e ndërlydhur, madje tejte e pazëvendësueshme ne komunikim. Sjellja harbute, gënjeshtre, mashtrimi, mungesa e mirënjohjes dhe dashakeqësia janë elemente të mungesës së etikës në komunikim. Si reduktuese e stresit në marrëdhënie të tensionuara dhe parandaluese e komunikimit të porealizuar, etika në komunikim nuk bën gjë tjetër veçse ruan dhe përmirëson marrëdhënien mes njerëzimit. Etika në komunikim kërkon që të dy bashkëbiseduesit të jenë bashkëpunues dhe bashkëpërgjegjës për gjithçka thuhet apo realizohet në një përmbajtje komunikimi.

Sa etikë jemi në komunikim? Kjo gjë varet nga interesi individual për komunikimin që duam të realizojmë. Ndonjëherë, fitimi dhe përfitimi me çdo kusht si dhe nënvlerësimi apo injorimi i suksesit të tjetrit e mënjanojnë etikën dhe bëhet thuajse e pamundur të kuptohet se kush është në të mirë të komunikimit. Është disi e vështirë të përcaktosh se kur quhesh individ me etikë në komunikim, pasi pikë së pari, arritja e ekuilibrave në situata të ndryshme mbetet në varësi të mënyrës së të thënit të gjërave. Së dyti, jo të gjithë kanë durimin dhe dëshirën për të shmangur situata të pakëndshme. Dhe së treti, pavarësisht situatës, asnjëherë nuk jemi të sigurt se kë kemi përballë. Edhe individët që janë më pranë rrethit tonë shoqëror, në ditë të ndryshme kanë humor të ndryshëm. Shumë sjellje apo akte të të folurit brenda etikës individuale apo etikës përgjithësuese përcaktojnë stadin dhe zhvillimin e komunikimit.

Nuk ka asgjë të keqe nëse dikush shpalos vlerat dhe

parimet individuale në një zonë më komforte për të gjatë një komunikimi mes familjarësh, miqsh apo të afërmish. Deri këtu jemi në zonën e etikës së kufizuar personale, ku çdokush në nerv e sipër, në mllef, inat apo xhundosje mund të sillet dhe flasë me terma etikisht të ngushtë, klanorë, miqësorë, apo familjarë. Në situata të tjera, përtej këtij konteksti social, çdo përzgjedhje fjalori dhe sjelljeje kërkon më kujdes në menaxhimin e komunikimit, pasi gjithçka që u përmend më sipër mund të bëhet absolutisht e papranueshme dhe jashtë kontureve të etikës jo më individuale, por të asaj që quhet etika e përgjithësuar. Kjo e fundit është e rrënjosur në përgjegjësinë publike të gjithsecilit nga ne që komunikojmë. Duam apo s' duam ta pranojmë, nuk kemi të njëjtën etikë komunikimi me staturë të ndryshëm individësh në jetën e përditshme tonën. Suksesi në komunikim arrihet kur etika në të folur e ka kryer efektivitetin, vërtetësinë dhe besueshmërinë e mesazhit që përçohet dhe nëse ndihet kjo mund të themi që kuptimin etikës bëhet më i qartë.

Për të kuptuar të gjithë burimësitë e etikës, duhet t'i mëshojmë fort faktit se komunikimi është qëllimi më thelbësor dhe më parësor i të menduarit psikologjik, dhe se tek komunikimi gjallojnë të gjitha rrënjët e qëllimeve dhe kahjeve të tjera të psikologjisë, të tilla si: ndërgjegjësimi në lidhje me qenien si e tillë, shmagja e ankthit, ndriçimi i shpirtit dhe i ekzistencës njerëzore përmes dashurisë, apo arritja e qetësisë dhe paqes shpirtërore.

***BIBLIOGRAFIA:***

- Batson, C. D., 2011, Altruism in Humans, Oxford: Oxford University Press, part II.
- E. Dragoti, Psikologji sociale, Viti 2004.
- Emile: or On Education (Includes Emile and Sophie, or the Solitaires). Translated by Christopher Kelly and Allan Bloom. Lebanon, NH: Dartmouth College Press, 2009.
- Erikson, E. (1997). The Life Cycle Completed. New York: Norton
- <https://www.aynrand.org/>
- Petman. J. (2008). Egoism and altruism? The politics of the great balancing act. Retrieved
- <http://www.helsinki.fi/nofo/NoFo5Petman.pdf>
- Rabate, J. (2001). James Joyce and the politics of egoism. Cambridge University Press
- Shaver, R. (2009). Rational egoism. Cambridge University Press



